



Komuna e Hanit të Elezit

**VLESRËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR
I PLANIT ZHVILLIMOR KOMUNAL I
HANIT TË ELEZIT
2024 - 2032**

Mars, 2024

Vendim

Komuna Hani i Elezit për përpilimin e Raportit: Vlerësimi Strategjik Mjedisor për Planin Zhvillimor Komunal të Hanit të Elezit me numër identifikues 659-23-2320-2-3-6 dhe numër të brendshëm KKHE-23-005-2-3-6, ka lidhë Kontratë me Ndërrmarrjen Projektuese N.SH."Geo – Miningu" nga Prishtina


Autoriteti Kontraktues: Komuna Hani i Elezit

Menaxheri i Kontratës:

Durim Dernjani

Hartues i Raportit: Kompania N.SH."Geo – Miningu"


Pronar: Prof.Dr. Islam Fejza







Personat e licencuar për hartimin e Raportit të VNM-së

1. Prof.Dr. Islam Fejza
2. Dr.Sc. Nexhmi Krasniqi
3. Vehbi Ejupi, Prof.i kimisë







Përmbajtja

Historiku i Zhvillimit	10
KORNIZA LIGJORE DHE INSTITUCIONALE	11
Direktiva VSM e BE-së	11
Direktivat tjera të BE-së	11
Strategjia 2020 e BE-së.....	11
Objektivat Zhvillimore të Mijëvjeçarit të KB dhe Objektiva për Zhvillim të	12
Qëndrueshëm (OZHQ)	12
Konventa Århus, Konventa Espoo dhe Protokolli i Kievit	13
Konventa Århus	13
Konventa Espoo dhe Protokolli i Kievit	13
Historiku legjislativ, organet administrative përgjegjëse	14
Ligji i Kosovës për Planifikim Hapësinor	14
Ligji i Kosovës për Vlerësimin Strategjik të Mjedisit.....	14
Planet dhe programet e tjera të rëndësishme.....	15
PROCESI DHE METODOLOGJIA E VSM-së	15
POZITA GJEOGRAFIKE	18
KUSHTET FIZIKO-GJEOGRAFIKE	20
Hipsometria dhe topografia.....	20
Karakteristikat gjeologjike	21
Rreshpet kristalore (Pz)	21
Shkëmbinj të ultrabazikë -Serpentinitet (J ₂₋₃)	21
Sedimentet e kretakut të sipërm (K ₂ ²⁻³).....	21
Sedimentet e neogjenit (M ₂₋₃)	21
Shtresat e pliocen-pleistocenit (Pl-Pl ₃).....	22
Aluvionet e kuaternarit (Q)	22
Kushtet klimatike.....	22
Hidrografia	22
Flora dhe fauna	23
Zonat e mbrojtura	24
Rreziqet natyrore	25
Shkalla e erozionit	28
KUSHTET SOCIO-EKONOMIKE	30
Ndarja administrative.....	30
Popullsia.....	30
Shfrytëzimi i tokës.....	33

Pyjet	36
Trashëgimia kulturore	36
Trashëgimia arkitekturale.....	37
Trashëgimia arkeologjike.....	37
Trashëgimia shpirtërore	38
Industria	38
Resurse tjera natyrore të pashfrytëzuara në Han të Elezit janë edhe argjila e vërtetuar me mbi 26 milion ton, guri dekorativ, kromi, hekuri dhe uji mineral.	39
Turizmi.....	39
Transporti	39
Rrugët e nivelit qendror	40
Rrugët e nivelit lokal	40
Transporti	42
Infrastruktura e energjisë elektrike.....	44
Infrastruktura e ujësjellësit	46
Infrastruktura e Ujërave të Zeza.....	48
Infrastruktura e varrezave	49
Analiza SWOT	52
Zonat me Probleme Mjedisore	52
Zonat që kanë nevojë për Mbrojtje Mjedisore	52
PEIZAZHET.....	52
Argumente të Analizës SWOT	53
Pikat e forta	53
Pikat e dobëta	53
Mundësitë	53
Kërcnimet	54
Analiza SWOT	55
VIZIONI DHE SKENARËT E ZHVILLIMIT.....	57
Vizioni i Komunës së Hanit të Elezit	57
Koncepti i Zhvillimit Hapësinor i Hanit të Elezit	58
Koncepte t e Zhvillimit Hapësinor	58
Skenarët e propozuar hapësinor	59
Koncepti i zhvillimit hapësinor të Komunës së Hanit të Elezit	60
Zhvillimi sipas sektorëve	61
Mjedisi dhe trashëgimia natyrore dhe kulturore	61
Zhvillimi ekonomik	66

Infrastruktura teknike.....	70
Infrastruktura e transportit	77
Zhvillimi social	80
Vendbanimet, banimi dhe trajtimi i vendbanimeve joformale.....	86
PARIME, OBJEKTIVA E KRITERE MJEDISORE QË KUFIZOJNE ZHVILLIMIN KOMUNAL	91
Parimet e Përgjithshme për Planifikim Hapësinor	91
Objektiva Strategjike	91
Veprime Operacionale në Mbështetje të Objektivave Strategjike	93
Kriteret Mjedisore që Kufizojnë Zhvillimin Komunal.....	93
Kritere të Forta Mjedisore-Shëndetësore	93
Kritere të Trashëgimisë Kulturore	94
Kritere Peizazhike	95
Kritere Inxhinierike dhe të Infrastrukturës.....	95
Plani Zhvillimor Komunal i Hanit të Elezit dhe Zgjidhjet e Parashikuara për Problemet e Mjedisit.....	97
Trajtimi i Çështjeve Mjedisore në Hartimin e Planit Zhvillimor Komunal	97
Analiza e Vlerësimit Strategjik Mjedisor të PZHK-së	98
Masat e Nevojshme në PZHK për Mbrojtjen e Mjedisit.....	103
Konceptet Urbane të Përdorimit të Tokës, përfshirë Zhvillimin e Qendrave	103
Ndikimi në e klimë	103
Mbrojtja e Pyjeve, Zonave të Gjelbra Ekzistuese dhe Zhvillimi i Zonave të Reja	103
Cilësia e Ajrit	104
Menaxhimi i Mbetjeve të Ngurta	104
Propozimet për Rrugë	104
Efektet kumulative	105
Probleme të Mjedisit në Hani i Elezit dhe Përgjigjia që Jepet përmes PZHK-së.....	106
MONITORIMI.....	116
PËRFUNDIME	121
Rekomandimet që dalin nga VSM-ja janë:	123
LITERATURA.....	124

LISTA E SHKURTIMEVE

AMMK Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës

BE Bashkimi Evropian

dBA Decibel

GIS Sistemit i Informacionit Gjeografik

GNP Grimcat e Ngurta Pezull

HZK Harta Zonale Komunale

MMPHI – Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës

IHMK Instituti Hidrometeorologjikë i Kosovës

NOQ Ndotës Organike të Qëndrueshëm

OBSH Organizata Botërore e Shëndetësisë

OJQ Organizata Jo Qeveritare

OZHM Objektivat e Zhvillimit të Mijëvjeçarit

PRRH Plani Rregullues i Hollësishëm

PZHK Plani Zhvillimor Komunal i Hanit të Elezit

TeR Termat e Referencës

UNDP Programi i Zhvillimit i Kombeve të Bashkuara

UNEP Programi i Mjedisit i Kombeve të Bashkuara

VNM Vlerësim i Ndikimit në Mjedis

VSM Vlerësim Strategjik Mjedisor

ZVM Zona të Veçanta të Mbrojtura

Lista e Figurave

Figura 1. Pozita Gjeografike e komunës së Hanit të Elezit.....	17
Fig. 2. Harta –Hipsometria.....	18
Fig. 3. Harta hidrologjike.....	21
Fig. 2. Shkalla e erozionit në ha dhe përqindje	27
Fig.5 Harta - Përshtatshmëria e tokës.....	32
Fig. 6 Harta - Trashëgimia kulturore.....	35
Fig 7.Harta - Infrastruktura rrugore/ hekurudhore dhe transporti.....	38
Fig. 8. Harta Stacionet bazë te energjisë elektrike.....	43
Fig.9 Harta - Shpërndarja e rrjetit të ujësjellësit.....	45
Fig. 10 Harta – Varrezat.....	48
Fig 11. Harta - Ndotja e mjedisit.....	60
Fig. 12 Harta - Plani i mbrojtjes së trashëgimisë kulturore dhe natyrore.....	63
Fig. 13 Harta - Plani i mbrojtjes nga rreziqet natyrore.....	64
Fig.15 Harta - Plani i zhvillimit ekonomik.....	65
Fig. 16 Harta- Plani i ujësjellësit dhe kanalizimit.....	70
Fig. 17 Harta - Plani i ujitjes dhe drenazhimit.....	71
Fig. 18 Harta - Plani i menaxhimit të mbeturinave.....	72
Fig. 19 Harta - Plani i energjisë elektrike dhe termike.....	74
Fig. 20 Harta - Plani i telekomunikacionit dhe instalimeve të ngjashme.....	75
Fig. 21 Harta - Plani i infrastrukturës së transportit.....	76
Fig. 22 Harta - Plani i transportit lokal.....	78
Fig. 23 Harta - Plani i zhvillimit publik dhe social.....	80
Fig. 24 Harta - Plani i hapësirave sportive.....	81
Fig. 25 Harta - Plani i hapësirave publike dhe të gjelbra.....	83
Fig. 26 Harta - Plani i menaxhimit të varrezave.....	84
Fig. 27 Harta - Zhvillimi Hapësinor i Planifikuar.....	85
Fig. 28 Harta - Shfrytëzimi i planifikuar i tokës.....	87

Lista e Tabelave

Tabela 1. Shkalla e erozionit.....	30
Tabela 2.Numri i popullsisë gjatë viteve	31
Tabela 3. Sipërfaqja e tokës bujqësore	34
Tabela 4. Sipërfaqja e kultivuar bujqësore.....	35
Tabela 5.Numri i krerëve të kafshëve blegtorale.....	36
Tabela 6.Lista e trashëgimisë kulturore në mbrojtje të përkohshme (2021) – trashëgimia arkitekturale, nënkategoria: monument/ ansambël; MKRS, 2021	37
Tabela 7. Lista e trashëgimisë kulturore në mbrojtje të përkohshme (2021) – trashëgimia arkeologjike, nënkategoria: lokalitet arkeologjik/ rezervat; MKRS, 2021.....	38
Tabela 8.Gjatësia e rrugëve lokale dhe gjendja e tyre	41
Tabela 9. Sasia e ujit dhe numri i klientëve të shërbyer.....	48
Tabela 10.Sistemi dhe klientët shërbyer	49
Tabela 11.Lokacionet dhe sipërfaqja e varrezave	50

Tabela 12. Konsiderata Mjedisore dhe Shëndetësore të PZHK-së	98
Tabela 13. Matrica e përmbledhjeve të efekteve kumulative të të gjitha elementeve të PZHK-së në komponentët mjedisore.....	105
Tabela 14. Përmbledhje e Problemeve Mjedisore dhe përgjigja sipas PZHK-së	107
Tabela 15. Monitorimi.....	117

Lista e Fotove

Foto 1 Qyteza e Hanit të Elezit me industri.....	16
Foto 2. Natyra unike e Maleve të Sharrit, Komuna e Hanit të Elezit.....	23
Foto 3. Vërshimet në Lagjen e Re.....	25
Foto 4 Vërshimet në infrastrukturë dhe toka bujqësore kualitative.....	26

HYRJE

Historiku i Zhvillimit

Plani Zhvillimor Komunal i Hanit të Elezit do të jetë një instrumenti kryesor për zhvillimin hapësinor të Komunës së Hanit të Elezit. Ky dokument do të ndjekë gjurmët e dokumenteve të më hershme të planifikimit sidomos Planit Zhvillimor Komunal 2010-2025, poashtu edhe dokumentet tjera të planifikimit të cilat kanë rregulluar njësi të vogla të hapësirës por edhe komplet komunën.

Plani Zhvillimor Komunal i Hanit të Elezit i cili ka karakter strategjik për zhvillimin e hapësirës dhe do të shërbej si bazë për Hartën Zonale Komunale si dhe për planet tjera sektoriale dhe Planet Rregulluese të Hollësishme.

Komuna e Hanit të Elezit ka një përvojë të më hershme në Vlerësimin Strategjik Mjedisor të Planit Zhvillimor Komunal i cili do të shërbej edhe në Vlerësimin Strategjik Mjedisor të këtij Plani. Vlerësimi Strategjik Mjedisor (më tutje VSM-ja) është një proces që synon integrimin e konsideratave mjedisore në përgatitjen dhe miratimin e planeve, programeve dhe politikave. Vlerësimi Strategjik Mjedisor për Planin Zhvillimin Komunal të Komunës së Hanit të Elezit (më tutje PZHK) është detyrim ligjor, i cili parashihet në nenin 23 të Ligjit të Planifikimit Hapësinor nr. 04/L-174.

Qëllimi i raportit të VSM-së për Planin Zhvillimin Komunal të Komunës së Hanit të Elezit është që të bëjë identifikimin, përshkrimin dhe vlerësimin e ndikimeve të mundshme që mund të rezultojnë nga zbatimi i projekteve strategjike nga PZHK-së, si edhe të japë alternativën më të favorshme për zhvillimin e tij nga pikëpamja hapësinore dhe mjedisore. Në raportin e VSM-së janë të përfshira edhe propozimi i masave për mënjanimin dhe zbutjen e ndikimeve të dëmshme që dalin nga projektet strategjike nga PZHK.

Metodologjia e cila është përdorur në këtë VSM është në përputhje me Direktivën e BE: 2001/42/EC „Mbi Vlerësimin e Efekteve të disa Planeve dhe Programeve në Mjedis“ dhe ligjin për Vlerësimin Strategjik Mjedisor, i cili është transpozimi i direktivës së BE 2001/42/EC.

KORNIZA LIGJORE DHE INSTITUCIONALE

Direktiva VSM e BE-së

Direktiva e BE-së 2001/42/EC mbi vlerësimin e efekteve të planeve dhe të programeve të caktuara në mjedis u aprovua më 27.06.2001. Kjo direktivë vlen për një varg të gjerë të planeve dhe të programeve publike (p.sh. mbi shfrytëzimin e tokës, transportin, energjinë, mbeturinat, bujqësinë, etj.). Kjo direktivë nuk ju referohet politikave. Direktiva (Parlamenti Evropian..., 2001) thotë që planet dhe programet në kuptim të Direktivës së VSM-së duhet të përgatiten dhe të aprovohen nga një autoritet (në nivel kombëtar, rajonal apo lokal) dhe të urdhërohen nga dispozitat legislative, rregulluese ose administrative.

Një VSM është i obligueshëm për planet/programet si vijon:

- Përgatiten për bujqësi, pylltari, peshkim, energjetikë, industri, transport, menaxhim të mbeturinave/ ujët, telekomunikim, turizëm, planifikimin të qytetit & vendit ose shfrytëzim të tokës dhe të cilat vendosin kornizën për miratimin e zhvillimit të ardhshëm të projekteve të shënuara në listën e Direktivës për Vlerësimin e Ndikimit Mjedisor (VNM);
- Janë përcaktuar për të kërkuar një vlerësim sipas Direktivës së Vendbanimeve¹. Gjerësisht, për planet/programet që nuk janë të përfshira më lart, shtetet anëtare duhet ta kryejnë një procedurë të shoshitjes për ta përcaktuar nëse planet/programet ka mundësi të kenë efekte domethënëse mjedisore. Nëse ka në efekte domethënëse nevojitet një VSM. Procedura e shoshitjes bazohet në kriteret e përcaktuara në Shtojcën II të Direktivës.

Procedura VSM mund të përmblihet si vijon: raporti VSM përgatitet dhe në të identifikohen efektet domethënëse të mundshme në mjedis dhe alternativa të arsyeshme të planit ose të programit të propozuar. Autoritetet publike dhe mjedisore informohen dhe konsultohen lidhur me projektin e planit ose të programit dhe përgatitet raporti VSM-së. Raporti VSM-së dhe rezultatet e konsultimeve merren parasysh para aprovimit. Kur të aprovohet plani ose programi, informohen autoritetet mjedisore dhe opinioni dhe informatat përkatëse vihen në dispozicion të tyre. Në mënyrë që të identifikohen efektet paparashikueshme të pafavorshme në një fazë të hershme, efektet domethënëse mjedisore të planit ose të programit duhet të monitorohen.

Direktivat tjera të BE-së

Ekzistojnë shumë direktiva të tjera të BE-së me të cilat Direktiva VSM ka lidhje të qarta dhe të cilat janë të rëndësishme nëse janë duke u shqyrtuar çështjet mjedisore. Sipas Marsden (2008) VSM-ja ka lidhje të ngushta procedurale me Direktivën VNM-së, në veçanti me që vlerësimi i mjedisit për sektorët e shënuar nën këtë të fundit duhet ta vendosë kornizën për projektet e shënuara nën këtë të parën. Po ashtu, ka lidhje të ngushta procedurale me Direktivën për Vendbanimet, e cila përmendet qartë në direktivën VSM-së. Direktiva Kornizë për Ujërat bashkërisht me Direktivën për Vendbanimet përmban kërkesat e veta jo vetëm për paraqitjen e planeve (dhe të programeve) poashtu edhe të vlerësimit, duke nxitur nevojën për procedurë të bashkërenduara ndërmjet ligjeve të ndryshme¹.

Strategjia 2020 e BE-së

Përveç dokumenteve të sipërpërmendura legislative të BE-së, strategjia 2020 e BE-së me prioritetet, objektivat dhe nismat më të mëdha¹ është dokument i rëndësishëm i politikave si për vetë BE-në

¹http://ec.europa.eu/europe2020/index_en.htm

ashtu edhe për rajonet fqinje, në veçanti Ballkanin Perëndimor meqë bashkëpunimi rajonal me këtë rajon është identifikuar si njëri prej prioriteteve të politikave për BE-në. Në kuadër të strategjisë 2020 të BE-së (Komisioni Evropian, 2010) zgjerimi i mundshëm i BE-së me vendet e Ballkanit Perëndimor është identifikuar si mjet i jashtëm i politikave për zhvillim dhe vende pune. Prioritetet e strategjisë janë “zhvillimi i shpejtë, i qëndrueshëm gjithëpërfshirës”. Janë shtatë nisma të mëdha, prej të cilave *Evropa efikase sa ju përket burimeve dhe Një politikë industriale për epokën e globalizimit* janë drejtpërdrejt të lidhur me çështje të qëndrueshmërisë, por nisma të tjera si *Agjenda digjitale për Evropën, Unioni i përtëritjeve, Rinianë lëvizje, Një agjendë për shkathtësi dhe vende të reja pune dhe Platforma evropiane kundër varfërisë* do të mundeshin poashtu të kontribuonin në parimin e zhvillimit të qëndrueshëm po të zbatoheshin në mënyrë efikase. Në strategji poashtu përfshihen objektivat e matshëm që duhet të arrihen gjatë periudhës së zbatimit, nuk ka dyshim që është plotësisht e dobishme si për shtetet anëtare aktuale ashtu edhe për ato të ardhshmet që të bashkëpunojnë në mënyrë që t’i arrijnë objektivat mjedisore të strategjisë siç është zvogëlimi prej 20% i emetimeve të gazrave të serrave, 20% rritje të shkallës së energjisë nga gjërat e ripërtëritshme dhe nga efikasiteti i energjisë. Prandaj është e arsyeshme që drejtimi i këtyre objektiveve të integrohet në strategjitë dhe në planet e veprimit mjedisore kombëtare, rajonale dhe lokale, përfshirë procedurat për vlerësimin strategjik të mjedisit.

Objektivat Zhvillimore të Mijëvjeçarit të KB dhe Objektiva për Zhvillim të

Qëndrueshëm (OZHQ)

Kombet e Bashkuara-KB kanë një rol aktiv në zhvillimin shteteve të ndryshme në botë. Edhe pse Kosova nuk është anëtare e Kombeve të Bashkuara, KB-ja aktualisht vepron në Kosovë nën mandatin e misionit UNMIK, në mënyrë që t’i sigurojë kushtet për jetë të qetë dhe normale për të gjithë banorët e Kosovës dhe për avancimin e stabilitetit rajonal në Ballkanin Perëndimor. Objektivat strategjike të KB janë aprovuar në vitin 2000, kur udhëheqësit botërorë u mbledhën në Nju Jork për të marrë pjesë në Samitin e Mijëvjeçarit, pjesëmarrësit aprovuan Deklaratën e Mijëvjeçarit të KB (Asambleja e Përgjithshme e KB, 2000) me qëllimin kryesor të përgjithshëm për ta zvogëluar varfërinë me afatin e fundit kohor vitin 2015. Kjo ishte bërë e njohur si Objektivat Zhvillimore të Mijëvjeçarit². Të cilat ishin 8 objektiva ndërsa, një prej objektiveve i kushtohej qëndrueshmërisë mjedisore, në mënyrë që të sigurohet vendosje e qëllimeve në vijim:

- Integrimi i parimeve të zhvillimit të qëndrueshëm në politikat dhe programet e vendit dhe kthim i mbrapsht i humbjes së burimeve mjedisore;
- Zvogëlimi i humbjeve të biodiversitetit duke arritur deri më 2010 një zvogëlim domethënës të shkallës së humbjes;
- Përgjysmimi i përqindjes së popullsisë pa qasje të qëndrueshme tek uji i sigurt i pijshëm dhe higjiena publike themelore deri në vitin 2015;
- Deri më 2020 të arrihet një përmirësim i rëndësishëm në jetët e sëpaku 100 banorëve të lagjeve të varfra.

Edhe pse në këto 15 vitet e fundit u bë një progres i dukshëm në arritjen e OZHM-ve, shumë objektiva nuk u arritën. Për të përshpejtuar progresin dhe avancuar zhvillimin përtej vitit 2015, Asambleja e Përgjithshme e OKB-së, më 25 shtator 2015 miratoi agjendën e zhvillimit të post 2015, duke vendosur objektivat dhe pikësynimet e reja për 15 vitet e ardhshme. Agjenda e re përcakton shtatëmbëdhjetë Objektiva për Zhvillim të Qëndrueshëm (OZHQ) ose Sustainable Development Goals (SDG), të cilat kanë si afat vitin 2030 dhe kërkojnë të ndërtojnë e plotësojnë atë që OZHM nuk

²http://ec.europa.eu/europe2020/index_en.htm

e arritën. Në këtë agjendë të re të zhvillimit, mjedisi konsiderohet të kenë rol kyç në të gjitha dimensionet e zhvillimit të qëndrueshëm, për sa çështjet mjedisore kanë lidhje me disa probleme kryesore globale dhe kanë ndikim në të gjitha aktivitetet njerëzore dhe në cilësinë e jetës së njeriut. Kjo është arsyeja pse mjedisit i janë dhënë objektiva të posaçme (OZHQ nr. 11, 13 dhe 15) por edhe objektiva tjera substancialisht përmbajnë çështjet mjedisore. Këto objektiva janë të rëndësishme që të kenë një qasje gjithëpërfshirëse në trajtimin dhe adresimin e problemeve globale të mjedisit.

Konventa Århus, Konventa Espoo dhe Protokollin e Kievit

Konventa Århus

Kjo Konventë (Konventa për qasje në informata, pjesëmarrje publike në vendimmarrje dhe qasje në drejtësi për çështjet mjedisore) është aprovuar më 25 qershor 1998 në qytetin danez të Aarhus (Århus) në Konferencën e Katërt Ministrore si pjesë e procesit "Mjedisi për Evropën". Ajo hyri në fuqi më 30 tetor 2001.

Konventa Århus vendosë një numër të të drejtave të opinionit në lidhje me mjedisin. Sipas konventës (Konventa UNECE mbi Qasjen...,1998) Nga palët në këtë Konventë kërkohet t'i hartojnë dispozitat e nevojshme ashtu që autoritetet publike (në nivel kombëtar, rajonal apo lokal) do të kontribuojnë që këto të drejta të bëhen efektive. Konventa parashikon:

- Të drejtën e secilit që të marrë informata për mjedisin të cilat i mbajnë autoritetet publike. Këtu mund të përfshihen informatat lidhur me gjendjen e mjedisit, por po ashtu edhe politikat ose masat e ndërmarra. Kërkuesit kanë të drejtë t'i marrin këto informata brenda një muaj i pas bërjes së kërkesës dhe pa treguar arsyen pse ju nevojiten ato. Përveç kësaj, sipas Konventës autoritetet publike janë të obliguara që në mënyrë aktive t'i shpërndajnë informatat për mjedisin të cilat i posedojnë;
- Të drejtën për të marrë pjesë në vendimmarrjen për mjedisin. Autoritetet publike duhet t'i bëjnë përgatitjet që t'ia mundësojnë opinion të influencuar dhe organizatave joqeveritare për mjedisin që të bëjnë komente, për shembull, lidhur me propozimet për projektet të cilat ndikojnë në mjedis, ose për planet dhe programet që kanë të bëjnë me mjedisin, që këto komente të merren parasysh në vendimmarrje dhe informatat të ofrohen në vendimet përfundimtare dhe në arsyet për atë vendim;
- të drejtën për rishikimin e procedurave për kundërshtimin e vendimeve publike të cilat janë marrë pa i respektuar dy të drejtat e sipërpërmendura ose të drejtën mjedisore në përgjithësi.'

Konventa Espoo dhe Protokollin e Kievit

Konventa Espoo (EIA) (Konventa UNECE mbi.....Mjedisor,1991) përcakton obligimet e palëve për ta vlerësuar ndikimin në mjedis të aktivitetëve të caktuara në një fazë të hershme të planifikimit'. Poashtu i formulon obligimet e përgjithshme të shteteve për ta njoftuar njëra tjetrën dhe për t'u këshilluar me njëra tjetrën lidhur me të gjitha projektet e mëdha që janë në shqyrtim dhe që ka gjasa të kenë ndikim të rëndësishëm të pa favorshëm në mjedis përtej kufijve'. Konventa u aprovua më 1991 dhe hyri në fuqi më 10 shtator 1997.

Siç thekson Marsden (2008), Protokollin e Kievit është i rëndësishëm për t'u përmendur në kontekst të vlerësimit strategjik të mjedisit, me që do të mund të konsiderohej si njëri prej instrumenteve më të rëndësishme ndërkombëtare që parashtron kushte për vlerësimin e propozimeve strategjike (Marsden, 2008). Protokollin është aprovuar në një takim të jashtëzakonshëm të Palëve pjesëmarrëse në Konventën Espoo, të mbajtur më 21 maj 2003 dhe kërkon nga Palët e saj që t'i vlerësojnë pasojat mjedisore të projekteve të planeve dhe të programeve të tyre zyrtare. Vlerësimi strategjik i mjedisit (VSM) ndërmerret shumë më herët në procesin vendimmarrës se sa vlerësimi i ndikimit mjedisor të projektit (VNP) dhe prandaj konsiderohet si mjet kryesor për zhvillimin e qëndrueshëm. Protokollin poashtu parashikon pjesëmarrje të gjerë publike në vendimmarrjen qeveritare në shumë sektorë të

zhvillimit. Protokollin kërkon që vlerësimi strategjik i mjedisit të kryhet për planet dhe programet të cilat përgatiten për bujqësi, pylltari, peshkim, energjetikë, industri përfshirë minierat, transport, zhvillim rajonal, menaxhim të mbeturinave, menaxhim të ujërave, telekomunikim, turizëm, planifikimi të qytetit ose të fshatit ose shfrytëzimit të tokës, dhe të cilat vendosin kornizën për miratimin e zhvillimit të ardhshëm për projektet. Sugjerimet për promovimin e pjesëmarrjes publike dhe përfshirja e aktorëve po ashtu janë në përputhje me protokollin.

Historiku legjislativ, organet administrative përgjegjëse

Ligji i Kosovës për Planifikim Hapësinor

Ligji për Planifikimin Hapësinor është aprovuar në shtator 2003 dhe është ndryshuar në nëntor 2008 (Ndryshimi i Ligjit për Planifikim Hapësinor, Ligji nr. 03/L-106) duke pasur si qëllim kryesor:

- Rregullimin e të gjitha çështjeve që kanë të bëjnë me planifikimin hapësinor dhe urban;
- Duhet t'i respektojë parimet e mbrojtjes së burimeve natyrore dhe ta përkrahë zhvillimin e qëndrueshëm;
- Duhet t'i përkrahë proceset gjithëpërfshirës edhe pjesëmarrëse dhe duhet t'i përfshijë të gjitha palët e interesuara dhe komunitetet.
- Përkrahja e zhvillimeve hapësinore evropiane që janë duke ndodhur etj.

Ligji 03/L-106 parashihte që ekspertiza profesionale të integrohet në sistemin e planifikimit duke e themeluar Këshillin e Ekspertëve të Planifikimit në nivel nacional dhe lokal. Sipas këtij ligjit ekzistojnë 2 nivele të planifikimit (qendrorë dhe lokale). Llojet e Planeve të nivelit qendrorë janë: Plani Hapësinor i Kosovës, Planet Hapësinore për Zona të Veçanta. Ndërsa planet e nivelit lokal janë: Planet Zhvillimore Komunale (PZHK), Plani Zhvillimor Urban dhe Planet Rregulluese Urbane. Për të gjitha ato lloje të planeve ka qenë e obligueshme rishikimi dhe mundësitë për pjesëmarrje të opinionit. PZHK si lloji më i rëndësishëm për detyrë aktuale është plani multi-sektorial për gjithë territorin e komunës që i përcakton objektivat afatgjata për zhvillimin ekonomik, shoqëror dhe hapësinor. Ai duhet ta përfshijë periudhën prej së paku 5 vjetëve dhe ta përfshijë një plan për zhvillimin e hapësirave urbane dhe fshatrave brenda komunës. Te gjitha nivelet e planeve duhet të përfshijnë zhvillimin e qëndrueshëm si dhe për secilin plan obligohet përgatitja e raportit të VSM paralelisht me planin.

Sipas Ligji nr. 04/ 1-174 të Planifikimit Hapësinor, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH) është përgjegjëse për bashkërendimin e planifikimit hapësinor në Kosovë dhe për propozimin për politikën për zhvillim hapësinor në fushën e planifikimit hapësinor, si dhe për hartimin e dokumenteve dhe të raporteve përkatëse për planifikimin hapësinor, shqyrtimin dhe monitorimin e të gjitha dokumenteve planifikuese në mbarë territorin e Kosovës, ndërsa autoritetet lokale janë përgjegjës për zbatimin zhvillimet urbane të nivelit lokal të cilat duhet të jenë në harmoni me politikën dhe programet nacionale si dhe duke respektuar përgjegjësitë që dalin nga Ligji nr. 04/L-174. Sipas këtij ligjit po ashtu ekzistojnë 2 nivele të planifikimit (qendrorë dhe lokale). Llojet e Planeve të nivelit qendrorë janë: Plani Hapësinor i Kosovës, Harta Zonale e Kosovës, Planet Hapësinore për Zona të Veçanta. Ndërsa planet e nivelit lokal janë: Planet Zhvillimore Komunale (PZHK), Harta Zonale Komunale dhe Planet Rregulluese të Hollësishme.

Ligji i Kosovës për Vlerësimin Strategjik të Mjedisit

Ky ligj nënvizon rëndësinë e integritetit të parimeve për mbrojtjen e mjedisit gjatë përgatitjes, aprovimit dhe realizimit të planeve dhe të programeve përkatëse nëse është e qartë që këto të fundit kanë ndikime domethënëse në mjedis. Lista e planeve dhe e programeve të obligueshme është e përcaktuar në kuadër të ligjit. Ato plane nuk mund të aprovohen ose t'i dorëzohen organit legjislativ për aprovim pa raportin VSM. Nëse mendohet që VSM nuk nevojitet vendimi përkatës duhet të jetë

në formë të shkruar dhe duhet t'i përfshijë arsyet tij. Raport i VSM identifikon, përshkruan dhe vlerëson ndikime të mundshme të rëndësishme në mjedis nga zbatimi i planit ose programit dhe vlerëson alternativat e arsyeshme. Kërkesat përcaktohen në ligj në mënyrë që t'i u ofrojnë qasje në dokumentet VSM organeve këshilluese dhe opinionit të përgjithshëm. Projekti i dokumenteve VSM është një objekt për diskutim publik. Në kuadër të ligjit përcaktohet kërkesa të posaçme për rastet e këshillimeve ndërkuftare. Para se të aprovohet raporti VSM, ministria duhet ta shqyrtojë atë dhe të pajtohet me të. Poashtu janë përcaktuar procedurat për informimin lidhur me aprovimin e vendimeve, për monitorimin dhe mbikëqyrjen. Shtojcat e ligjit përmbajnë kritere të caktuara për përcaktimin e rëndësisë së mundshme të ndikimeve në mjedis dhe informatat e nevojshme që duhet të ofrohen në raportet VSM si edhe kriteret për vlerësimin e raporteve VSM.

Planet dhe programet e tjera të rëndësishme

Përveç legjislacionit raporti i VSM-së duhet të merr parasysh edhe Planin Hapësinorë të Kosovës 2010-2020+, Strategjinë për mjedisin dhe Planin e veprimit në Mjedis, si dhe disa plane, programe dhe dokumente të ndryshme të politikave të përgatitura dhe të lëshuara rishtazi nga autoritetet nacionale dhe institucionet e tjera relevante për të vazhduar më tutje me zbatimin e objektivave strategjike dhe të kërkesave ligjore.

PROCESI DHE METODOLOGJIA E VSM-së

Hartimi i raportit të VSM-së për programe, plane zhvillimore dhe projekte të mëdha është detyrim ligjor. Qëllimi i raportit të VSM-së për Planin Zhvillimor Komunal të Hanit të Elezit është që të bëjë identifikimin, përshkrimin dhe vlerësimin e ndikimeve të rëndësishme që mund të rezultojnë nga zbatimi i Planit Zhvillimor Komunal, si edhe të japë alternativën më të favorshme për zhvillimin e tij nga pikëpamja mjedisore. Në raportin e VSM-së duhet të përfshihen edhe propozimi i masave për mënjanimin dhe zbutjen e ndikimeve të dëmshme që dalin nga propozimet e Planit Zhvillimor Komunal.

Metodologjia e ndjekur është në përputhje me Direktiven e BE: 2001/42/EC „Mbi Vlerësimin e Efteve të disa Planeve dhe Programeve në Mjedis“ dhe ligjin për Vlerësimin Strategjik Mjedisorë, i cili është transpozimi i direktivës së BE 2001/42/EC.

Mbështetur në si mësipërm VSM-ja duhet të përfshijë pikat e mëposhtme:

- Një përmbledhje të informacionit bazë për vlerësimin mjedisor;
- Përshkrim të Vizionit, prioritet dhe objektivave kryesore të Planit Zhvillimor Komunal dhe marrëdhëniet e tij me politikën, planet dhe programet e tjera që kanë lidhje me të;
- Përshkrim të aspekteve të gjendjes aktuale të mjedisit si edhe zhvillimin e pritur të tij në rast se nuk zbatohet plani;
- Përshkrim të karakteristikave mjedisore të zonave që ka të ngjarë të ndikohen në mënyrë të konsiderueshme nga plani;
- Përshkrim të problemeve ekzistuese mjedisore të cilat kanë lidhje me planin;
- Përshkrim të objektivave për mbrojtjen e mjedisit të përcaktuara në nivel kombëtar ose ndërkombëtar, të cilat kanë të bëjnë me planin dhe programin si dhe mënyrat në të cilat këto objektiva janë marrë parasysh gjatë përgatitjes së raportit;
- Përshkrim të ndikimeve të mundshme dhe të konsiderueshme në mjedis duke përfshirë shëndetin publik, florën, faunën, biodiversitetin, tokën, klimën, ajrin, ujin, peizazhin, zonat natyrore, vlerat materiale, trashëgiminë kulturore si dhe ndërveprimin ndërmjet këtyre faktorëve.;
- Përshkrim të masave të parashikuara për të parandaluar, reduktuar ose lehtësuar ndikimet negative në mjedis, të cilat mund të rezultojnë nga zbatimi i planit.

- Një përmbledhje për përzgjedhjen e alternativave të shqyrtuara, duke përfshirë vështirësitë e ndryshme ose mungesën e të dhënave që hasen gjatë përpilimit të raportit.
- Përshkrimin e masave të parashikuara për monitorimin e ndikimeve.

Plani Zhvillimor Komunal për numrin e madh dhe diversitetin e gjere te problematikes qe trajton, kërkon konsultimin e një game te konsiderueshme dokumentacioni. Behet fjale për plane, raporte, projekte, studime dhe literature teknike nga sektorë te ndryshëm ekonomik dhe social. Ky dokumentacion përveç materialeve që dispononte vete grupi hartues i VSM-s, u sigurua nga komuna e Hanit të Elezit, institucione të tjera publike dhe kërkimet në internet.

ANALIZA E GJENDJES EKZISTUESE

POZITA GJEOGRAFIKE

Qyteza e Hanit të Elezit ndodhet në pjesën juglindore të Kosovës afër kufirit me Maqedoninë. Shtrihet në luginën e Lumit Lepenc në mes të Bjeshkëve të Sharrit në perëndim dhe Bjeshkëve të Karadakut në lindje. Si Komunë, Hani i Elezit ka edhe dhjetë fshatra të shpërndara në të dy anët e qytezës duke formuar një model të zgjatur veriperëndim-juglindje i cili është rreth 6.5km i gjatë me një sipërfaqe prej 83.16km² ose 8315.68.67ha (0,77% të territorit të Kosovës). Pjesa më veriore e territorit është Laçi, kurse duke vazhduar në jug arrijnë në kepin e Fangjit në Maqedoni. Territori është në përgjithësi malor dhe karakterizohet nga bimësia e drunjtë kryesisht me origjinë nga malet me bimësi ahu dhe bungu, si dhe nga vegetacioni barishtor që është më i lartë dhe më i shpeshtë në fusha dhe më i paktë në sasi në male.

Vendbanimi i Hanit të Elezit është në një vend i përshtatshëm gjeografik pasi që prek autostradën R6 "Arbën Gjaferi" (Prishtinë-Hani i Elezit), rrugën nacionale Prishtinë-Shkup N2 dhe vijën kryesore hekurudhore të Kosovës Fushë Kosovë-Shkup. Përtej kësaj, rruga që lidh dy pikat kufitare (Hani i Elezit dhe Gllaboçicë) gjithashtu kalon përmes territorit. Rruga është 13km e gjatë dhe mund të përdoret në situata emergjente duke qenë më e përshtatshme sesa rruga që kalon nëpër malet e Sharrit nga veriu, e cila është 52km më e gjatë. Është gjithashtu vend kufitar pasi që në pjesën jugore gjendet pika kufitare që lidh territorin e Kosovës me Maqedoninë. Kjo është një pikë kyçe për rajonin dhe Kosovën dhe shumica e mallrave eksportohen/importohen nëpër aty. Industria e materialeve ndërtimore (çimentos) është shumë e zhvilluar dhe e njohur jo vetëm në Kosovë por edhe jashtë saj.

Qyteti ka lidhje të mira rrugore me fshatrat Pustenic, Seçishtë, Krivenik, Gorancë dhe Rezhancë që shtrihen brenda Maleve të Sharrit në perëndim; dhe me fshatrat Paldenicë, Dimcë, Dërmjak dhe Neqafc që i përkasin Maleve të Karadakut në lindje. Përjashtim në këtë rast bën vetëm fshati Vërtomicë i cili nuk ka lidhje të mirë rrugore me Qytetin. Ky fshat së bashku me Neqafcin janë shpopulluar tashmë, kurse Dërmjaku dhe Pusteniku kanë numër shumë të vogël të banorëve. Komuna është një territor i organizuar në mënyrë qendrore me një total prej njëmbëdhjetë vendbanimeve që janë të organizuara në mënyrë strukturore në njëmbëdhjetë zonat kadastrale.



Foto 1 Qyteza e Hanit të Elezit me industri



Figura 3. Pozita Gjeografike e komunës së Hanit të Elezit

KUSHTET FIZIKO-GJEOGRAFIKE

Hipsometria dhe topografia

Relievi të territorit të Hanit të Elezit është rezultat i bashkëveprimit të fuqive të brendshme dhe atyre të jashtme të cilat kanë modeluar atë. Pikënisjen e bazamentit strukturor të territorit të Hanit të Elezit lidhët me ngritjet periferike të shprehura të maleve të Sharrit dhe Jezercit në perëndim dhe jugperëndim dhe dhe atij të maleve të Karadakut në anën lindore dhe verilindore. Kjo tektonikë është shoqëruar edhe me shkëputje të rëndësishme gjatësore (shkëputja e Lepencit) e tërthore mjaft aktive gjatë këtij evolucioni.

Shpatet e maleve të Sharrit të cilat shtrihen në territorin e Hanit të Elezit karakterizohen me pjerrtësi relativisht të madhe dhe me vlera të shpejtëve vertikale dhe horizontale mesatare të relievit. Këto vlera mesatare të thellësisë së shpejtëve ekonike, lidhen me rrjedhjet ujore (përroi i Seçishtes, Rezhancës, Laçit/ Kotlinës, etj,) duke i shfrytëzuar kryesisht edhe shkëputjet tërthore.

Në pjesën lindore e territorit të Hanit të Elezit shtrihet mali i Karadakut. Kryesisht karakterizohet si tërësi morfologjike kodrinoro-malore dhe malore me lartësi ma të madhe brenda territorit të Hanit të Elezit. Relievi karakterizohet me vlera deri mesatare të shpejtëve vertikale dhe horizontale të cilat i kanë kushtëzuar rrjedhat lumore (përroi Dimca, përroi i Konopit, etj).

Territori i komunës së Hanit të Elezit karakterizohet kryesisht me terren kodrinor-malor, si dhe me pjesë fushore përgjatë rrjedhave ujore. Përshkruhet nga pellgu i lumit Lepenc i cili përfshin edhe përrenj dhe reke.




Fig. 2. Harta - Hipsometria

Karakteristikat gjeologjike

Rajoni i Hanit të Elezi është i ndërtuar nga shkëmbinjtë kristalorë të serisë së Velesit të moshes Paleozoike, shkëmbinjtë ultrabazike të moshes Jurasike, sedimenteve të kretakut të sipërm (K_3), shtresave të pliocenit-pleistocenit(P-Pl) dhe aluvioneve të kuaternarit(al.Q).

Rreshpet kristalore (Pz)

Janë zbuluar në hapësirë të gjerë. Ndahen në dy facije: shkëmbinj të gjelbërt të cilët janë të ndërtuar nga amfibolitet, rreshpet amfibolitike tremolit-aktinolite dhe rreshpeve epidot-kloritike.

Facija e rreshpeve kuarc- mikore të cilat përbëhen nga mikashistet, gnajset kokërrimët, rreshpeve sericitike-kloritike dhe kuarciteve, në mbërthimin e kësaj facije lajmërohen edhe mermerët në formë thjerrze të cilët nga lëvizjet tektonike janë të coptuar dhe të plasaritur.

Vjetërsia e kësaj serie nuk është definuar nga aspekti i faunës. Në bazë të superpozicionit të shtresave parashifet se janë të periudhës së paleozoikut, pa definim të rregullt.

Shkëmbinjtë ultrabazikë -Serpentinitet (J₂₋₃)

Përciellin shtrirjen e zonës ofiolitike VVP-JLL.

Shkëmbinjtë ultrabazike janë të serpentinizuara intenzivisht: kryesisht janë të tipit harzburgit. Rreth fshatit Ivajë dhe Seçishtë janë të mineralizuara me krom dhe azbest. Në këtë pjesë të terrenit zakonisht janë në kontakt tektonik me rrethinën e njësisë litostratigrafike. Sipas të dhënave më të reja parashihet se i takojnë vjetërsisë së jurasikut (J).

Sedimentet e kretakut të sipërm (K₂₋₃)

Janë të zhvilluara në hapësirë të gjërë, kryesisht bëhet fjalë për gëlqeroret dhe formacionet flishore. Gëlqeroret në lokalitetin e Seqishtës janë zbuluar në një zonë me gjatësi nga 600-800 m dhe gjërësi 100-150 m në një sipërfaqe prej rreth 50 hektar (ha).

Këta janë kryesisht gëlqerorë masiv në të cilët vende - vende mund të gjenden edhe rudiste. Në bazë të mikrofaunës rudiste të hasur është vërtetuar se me gjasë i takojnë katit santonian dhe kampanian. Sedimentet flishore stratigrafikisht ndodhen mbi gëlqerorë. Kjo pako e shkëmbinjve është e ndërtuar nga argjila, zhavorri, mergelet në kombinim me gëlqeroret shtresë hollë.

Shkëmbinjtë e përmendur ndryshojnë në mënyrë ritmike. Thuhet se sedimentet flishore në rajonin e grykës së Kaçanikut përbëjnë përqindjen më të madhe të substancave karbonatike në krahasim me flishorët në pjesën lindore të Karadakut të Shkupit.

Vjetërsia kampanian-mastritian e sedimenteve flishore është përcaktuar në bazë të mikrofaunës së pasur.

Sedimentet e neogjenit (M₂₋₃)

Sipas pozicionit përfaqësojnë pjesën e fundit të sedimenteve të miocenit në veri të luginës së Shkupit. Në tërë territorin nga Kriva Reka, përmes Hanit të Elezit deri në Bllac të Ulët, lajmërohen në formë të pjesëve të izoluar me sipërfaqe prej 0.3 deri 1.0 km².

Kjo ndarje e paraqitjes së shtresave të miocenit ka lindur për shkak të shkarjeve të shumë herëshme në këtë rajon. Në të vërtetë krijimi i tashëm paraqet lëshime të blloqeve të paeroduara të shtresave të miocenit.

Në pakon e sedimenteve vërehen dy facije: facija tavanore e cila është ndërtuar nga konglomeratet dhe zhavorret dhe facija e brendshme nga sedimentet e mergeleve dhe argjilave. Në këto sedimente mergelet kanë rolin dominant.

Këta, janë shkëmbinj me ngjyrë hiri, hiri të mbyllur dhe ngjyrë të gjelbërt hiri, karakterizohen me thyerje të mire guackore. Në bazë të faunës së gjetur, mikrofaunës dhe florës, këtyre sedimenteve i është vërtetuar plotësisht vjetërsia e miocenit.

Shtresat e pliocen-pleistocenit (Pl-Pl₃)

Paraqesin bazën direkte të serisë së mergeleve. Këto janë argjilat mergelore me përfshirje të materialit detritik i cili në përgjithësi përbëhet nga gëlqeroret kristalin, kuarcitet, rreshpet, zhavorret dhe shkëmbinjët tjerë.

Shtresat lajmërohen në formë të gjepave të thellë me trashësi prej disa metrave deri në 100 m.

Ekzistimi i këtij materiali përfaqësohet nga procese neotektonike pas miocenit, kur është paraqitur faza kontinentale me erozion intenziv.

Më vonë në rrethimin e basenit materiali terigjen është plotësisht i formuar në olluqe dhe lugina në fazën kontinentale.

Vjetërsia e këtyre sadimenteve nuk është e zërthyer prandaj e radhisim në periudhën nga plioceni deri në pleistocen.

Aluvionet e kuaternarit (Q)

Takohen përgjatë rrjedhjes së lumit Lepenc dhe përrrenjve tjerë. Këto janë shtresa aluviale bashkëkohore të cilat përbëhen nga rëra, zhavorri dhe llymi. Shtresat më të mëdha janë të deponuara përgjatë lumit Lepenc dhe në jug të Hanit të Elezit, kemi depozitime të rërës dhe zhavorrit të cilat shfrytëzohen për qëllime të ndryshme.

Kushtet klimatike

Klima është e ndryshueshme mesdhetare, me dimër të ashpër dhe temperatura minimale nga -10°C deri 5°C, dhe verë të nxehtë me temperatura maksimale që arrijnë 40°C. Ka një ndikim të fuqishëm nga lugina e Vardarit (klima e butë me ndikim të fortë gjatë dimrit që pasohet nga sasi të vogla të reshurave të borës) dhe Gryka e Kaçanikut (klime tipike kontinentale me ndikim të fuqishëm gjatë verës). Zona është e karakterizuar nga reshje të dobëta. Ata janë matur me rreth 500ml/m². Lagështia mesatare është rreth 65% (minimumi 51% dhe maksimumi 87%). Drejtimi kryesor i erës është veri - jug.

Hidrografia

Të dhënat e sakta hidro-geologjike për territorin e Hanit të Elezit janë shumë të kufizuara për shkak të mungesës së studimeve. Territori i komunës së Hanit të Elezit ka rrjet hidrografik i cili i drenon ujërat në drejtim të pellgut të Detit Egje. Nëpër këtë komunë kalon lumi i rëndësishëm jo vetëm për Komunën e Hanit të Elezit por për tërë Kosovën, Lepenci. Buron në shpatiet veriore të malit Sharr te Oshlaku me lartësi mbidetare 2212m. Lepenci ka luginë interesante kompozite e ndërtuar nga pjesët e gjëra dhe ngushticat. Me rëndësi është se lumi i Lepencit për shkak të burimit në lartësitë e mëdha mbidetare që mbulohen me borë i sigurojnë ushqim stabil me ujë. Bora qëndron deri në fillim të qershorit. Ushqimi i tij është nivalo-pluvial (bora dhe shiu). Sipërfaqja e pellgut është e mbuluar me pyje ndërsa në viset e larta me kullota malore. Ky lum është i tipit të hapur me një rrjedhje në drejtim të jug-lindjes, dhe formon pellgun e saj ujqor në rajon, që përfshin Hanin e Elezit, Kaçanikut, Shtërpçën dhe një pjesë të Ferizajit. Ajo mbulon zonën prej 800 km² dhe ka prurje mesatare prej 8 m³/sek. Pellgu ujqor i Lepencit është pellgu i tretë me radhë ujqor për nga madhësia në krahasim me të tjerat në Kosovë, dhe mbulon 7.2% të sipërfaqes totale.

Territori komunal është gjithashtu plot me përrrenj që kalojnë në dy anët perëndimore dhe lindore të lugine të lumit Lepenc. Tre përrrenjtë kryesore janë ai i Laçit/ Kotlines, Rezhances dhe Dimcës. Te tre përrrenjtë derdhen në lumin Lepenc. Ka edhe përrrenj të vegjël në gjithë territorin. Përroi i Konopit shtrihet në kufi, përroi i kishës, përroi i mullirit dhe përroi i kallugjeres në Gorance, përroi i

Krivenikut, etj. Ka një burim te ujit i tharte ne vendin e ashtuquajtur Uji i Tharte, afër rrugës nacionale N2. Sipas raporteve nga Instituti Hidrometeorologjik i Kosovës, burimet e këtij uji mineral kane cilësi fiziko-kimike te ujit mineral qe përdoret për pije. Ekzistojnë burime te ujit natyral ne pothuajse te gjitha fshatrat e Hanit te Elezit.

Ujërat nëntokësorë kanë përhapje të kufizuar. Nga analiza e hartës hidrogeologjike shihet se ka ujëra nëntokësorë rreth aluvioneve lumore si është Lepenci. Burimet natyrore ujore janë të vogla por ka mjaft për shkak sasisë së reshjeve dhe terrenit malorë.




Fig. 3. Harta hidrologjike

Flora dhe fauna

Si vend malor, edhe Komuna e Hanit të Elezit është pjesë e miksit shumë të pasur biodiversiv të Kosovës.

Fauna – Përfshihen shumë kafshë të rralla dhe të rrezikuara. Këtu bëjnë pjesë një numër gjitarësh, si ariu i murrmë (*Ursus arctos*), derri i egër (*Sus scrofa*), ujku (*Canis lupus*), kaprolli (*Capreolus capreolus*) dhe shpendët si shqiponja e malit (*Aquila chrysaetos*), thëllëza e malit (*Alectoris graeca*), skifteri kthetrabardhë (*Falco naumanni*), bufi (*Bubo bubo*), dhe shkaba (*Gyps fulvus*). Mishngrënësit e mëdhenj përshkajnë distanca të mëdha, kalojnë kufijtë e shteteve duke bërë kështu të mundur mbijetesën e popullatave ndërkufitare të specieve të tyre. Më të shpeshta janë kafshët si lepuri, ketri dhe shpezët korbi, laraskat, harabelat e fushës, qukapikët, thëllëzat, lejlekët dhe shpezët mishngrënës si shqiponjat, petritët, gjeraqinat e hutat.

Këtu jeton gjarpri i ujit (natrix natrix), gurit (vipera ammodytes), bollujca (tropidonatus natrix), kërmilli i vjeshtës (helix pomatia), breshka e rëndomtë (testudo bermanni). Peshq nuk ka shumë lloje, përderisa në lumin Lepenc më kryesorët janë trofta e përroskave që jeton në ujëra të shpejta dhe ftohta (lumi i Laçit) dhe krapit (kleni) shumë i shpeshtë i pjesëve të ulëta të Lepencit.

Flora – Janë shumë komunitete të ndryshme të bimëve që gjenden të shpërndara në habitate të ndryshme. Shfaqja e tyre varet nga lartësia mbi nivelin e detit, ekspozimi dhe lloji i tokës apo përmbajtja e shkëmbit. Këtu gjenden komunitete të ndryshme pyjore, që pjesërisht kanë degraduar në komunitete shkurresh malore, veçanërisht në zona ku pyjet janë prerë në mënyrë të përsëritur. Pjesa më e madhe e zonave mbi brezin pyjor mbulohen nga kullota malore, nga bimësia e tokave shkëmbore-gëlqerore dhe, shkëmbore-silikate, nga bimët e lëndinave, vegjetacioni i tokave të lagështa që ndodhen lart në male dhe nga vegjetacioni i rrafshnaltave me bar.

Ne pjesët kodrinore të Komunës dominojnë pyjet me mjaft lloje dhe janë të përziera. Prej drunjve dallohen pyjet gjetherënëse si: ahu (fagus sylvatica), qarri (quercus cerris), bungu, shkoza (carpinus orientalis). Përhapje më të kufizuar kanë llojet tjera që paraqiten si të vetmuara si: bliri (tilia kordata), frashri etj. Përhapje kanë edhe tipat tjerë që janë të ulëta lloji i shkurreve si thana (cornus mas), murrizi (crataegus monogyna), kaça (rosa canina), kulumbria (prunus spicosa), lajthia (corylus avellana), në vise të larta fieri shqiponje (pteridium aquilinum), etj. Prej bimëve barishtore ka lloje të ndryshme si ato që rriten në ambient të hapur pa prezencë të drunjëve si edhe ato që rriten brenda pyjeve. Këtu rriten edhe bime që pas trajtimit përdoren si është kantarioni (hypercium perforatum), kamomili (matricaria chamomila), dredhëza (fragaria vesca), manaferra etj.

Me pyje gjethembajtëse, janë vetëm 2 sipërfaqe të ndara (në Sharr/ Gorancë dhe Karadak/ Neçavc) Hapësira e rrafshët e komunës (lugina e Lepencit) është e vogël pa drunjë të dendur zakonisht rritet shelgu (salix alba) dhe verri në brigje të lumenjve, por edhe gështenja e egër. Ka edhe formacione të livadheve si tërfilli dhe shkurre të rralla.

Në Gorancë gjendet një bime e llojit me karakter endemik e quajtur “Convovulus cochlearis” (Dredhja e Kosovës).

Zonat e mbrojtura

Komuna e Hanit të Elezit është e pasur me trashëgimi natyrore. Natyra me Sharrin magjik ofron zona dhe elemente që mund të veçohen për mbrojtje dhe atraksion për vendasit dhe vizitorët dhe mund të ndihmojë zhvillimin në sferën e turizmit. Edhe Karadaku në lindje, edhe pse me kodrina më të ulëta, me pyjet e lisit, ahut e pishave, lumenjtë dhe krojet e pastërta, lëndinat, etj., ofrojnë një miks interesant natyror. Rrjedhimisht Komuna dhe komuniteti duhet të punojnë që peizazhe dhe monumente të përzgjedhura natyrore që janë të bollshme në Han të Elezit të fusë formalisht në Listën e Zonave të Mbrojtura të IMN/ MMPHI.



Foto 2. Natyra unike e Maleve të Sharrit, Komuna e Hanit të Elezit.

Fotocredit: Bedri Bushi, KAHIE, promovimi i natyrës 2012-2022

Por duhet nënvizuar edhe faktin se në veçanti pyjet e ahut në Malet e kardiakut janë duke u degraduar me të madhe për shumë vite nga druvarët ilegal për shfrytëzim të tyre si biomasë për djege. Organet relevante lokale dhe qendrore duhet të bashkëpunojnë me komunitetin dhe shoqërinë civile për të ndërmarrë hapa për ndalimin e kësaj dukurie

Rreziqet natyrore

Vërshimet, rrëshqitjet e borës, bora e madhe, era e fortë, breshri, akulli, thatësira, paraqitja masive e sëmundjeve ngjitëse të njerëzimit, të shtazëve dhe të bimëve dhe fatkeqësi të tjera, që i shkakton natyra.

Fatkeqësitë e tjera nënkupton fatkeqësitë e mëdha në trafikun rrugor, zjarret, fatkeqësitë në xeherore, shkatërrimi i digave dhe fatkeqësitë e tjera ekologjike dhe industriale, që i shkakton njeriu me punë dhe me sjellje, gjendja e jashtëzakonshme, emergjente, temperaturat e larta, kolapsi teknik i sistemeve energjike të furnizimit me rryme, telekomunikacioni dhe teknologjisë informative, aktet terroriste dhe mënyrat e tjera të rrezikimit masiv. Territori i komunës së Hanit të Elezit vazhdimisht është ballafaquar dhe mundë ballafaqohet me fatkeqësi natyrore dhe të tjera, kështu që Drejtoria e Shërbimeve Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim ka përgjegjësi për menaxhimin e këtyre situatave emergjente, siç që janë:

- Zjarret
- Vërshimet
- Tërmetet
- Fatkeqësitë e tjera elementare

Njëra ndër fatkeqësitë natyrore më sfiduese është Tërmeti, dihet se në pikëpamje sizmologjike, Komuna e Hanit të Elezit si edhe pjesa ma e madhe e Kosovës paraqet një rajon me aktivitet sizmik të lartë, i cili është goditur në të kaluarën dhe mund të goditet edhe në të ardhmen nga tërmete autoktone shumë të fortë, të cilët i kanë vatrat të cekëta.

Thatësira

Thatësia mundë të konsiderohet si rrezik për kulturat bujqësore gjatë sezonit verorë, kryesisht gjatë muajve korrik dhe gusht kur temperaturat janë më të larta dhe të reshurat janë më të rralla.

Vërshimet

Gjatë viteve lumi Lepenc së bashku me përroin e Rezhancës, dhe përrnjtë e Seçishtes, Dimces e Laçit (3 të fundit më rrallë) së kanë vërshuar një pjesë të zonës urbane dhe disa pjesë të fshatrave që gjenden rreth tyre. Përveç intensitetit të reshurave, vërshimet në këtë zonë janë pasojë e hedhjes së mbeturinave dhe materialeve inerte, si dhe ndërtimet ilegale dhe uzurpimet e shtratit të lumit të cilat drejtpërdrejtë ndikojnë në ngushtimin e shtratit të lumit.

Këto rrjedha ujore në rastin e reshjeve të mëdha atmosferike vërshojnë dhe shkaktojnë dëme të konsiderueshme në objekte të banimit, prona bujqësore, infrastrukturë, etj. Në vitet e fundit janë shënuar disa raste vërshimesh. Vërshimet më të mëdha kanë ndodhur kryesisht përgjatë përroit të Rezhancës duke filluar me Lagjen e Re të zonës urbane dhe duke vazhduar me zonat e rrezikuara nga lumi Lepenc që nga Lagja Uji i Thartë, Lagja Ranat, Lagja e Anëlumit, infrastruktura përreth dhe më tej në jug në tokat kualitative bujqësore. Duhet përmendur edhe përroin e Dimcës dhe përroin e Seçishtes që në të kaluarën kanë vërshuar një pjesë të zonës urbane respektivisht një pjesë të fshatit Seçishtë.





Foto 3. Vërshimet në Lagjen e Re (Vlerësimi i rreziqeve nga fatkeqësitë natyre dhe tjera, HiE 2017)

Pjesa më sensitive dhe problematike mbetet në Lagjen e Re ku ndër dhjetëra vite në tokën bujqësore është ndërtuar e tërë Lagja. Përroi i Rezhancës që dikur shërbente për ujitje tani është potencial për probleme. Ndërtimet në tokat private përreth kanë lënë pronën e përroit për tu shfrytëzuar edhe si rrugë kryesore e Lagjes. Me shtimin e numrit të banorëve rruga është zgjeruar dhe në vitin 2012-2013 përroi është futur në tunel me dimensione 2.5*2.0 m' për gjatësi 1.2 km' duke filluar nga grykëderdhja në Lepenc e më lart. Mirëpo ky trajtim i përroit e shtoi ndjeshmërinë në pikën ku uji nga lugina e hapur hyn në tunel. Në disa raste më pastaj kur kishte të reshura, lumi solli ujë më shumë, mbeturinat e hedhura ilegalisht dhe materialin nga erozioni duke bërë që të bllokohet hyrja e kanalit dhe duke vërshuar nëpër rrugë dhe Lagje. Kjo ndodhi më 2014 (ku dëmet materiale ishin vlerësuar mbi 500,000 Euro) dhe 2017, plus disa raste tjera ku organet komunale intervenuan dhe hapën hyrjen e kanalit në momentin vendimtar. Vërshimet nga lumi Lepenc nuk kanë qenë masive sikur vitet '70 dhe '80 të shekullit të kaluar. Megjithatë ka pasur raste edhe më vonë (2017) kur Lagja Ranat dhe toka bujqësore kualitative në jug (53 nga 103 ha) janë vërshuar. Potenciali i vërshimeve nga përrrenjtë Dimca dhe Seçishta janë reduktuar në maksimum pas intervenimeve në shtretërit e tyre.




Foto 4 Vërshimet në infrastrukturë dhe toka bujqësore kualitative (fotocredit: Remzi Bushi, HiE 2017)




Fig. 4 Harta - rreziqet natyrore dhe rreziqet tjera

Burimi: Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjencave – sektori i Emergjencave, Han të Elezit 2022

Rrëshqitja e dheut - Kjo dukuri është e shprehur në disa pjesë të sipërfaqeve tokësore në komunë e sidomos tek formacionet shkëmbore përgjatë rrugës nacionale N2 (në pjesën më veriore të komunës) dhe rrugës lokale Hani i Elezit – Gllloboçicë (Kaçanik). Rrëshqitjet natyrore si edhe ato te provokuara nga faktori njeri duhet identifikohen me një projekt të veçantë si dhe të merren masat adekuate, sidomos në ndërtim të objekteve të banimit dhe infrastrukturë. Arsyet dhe shkaqet e të gjitha rrëshqitjeve të dheut në komunë kanë qenë nga reshjet e shumta atmosferike dhe nga faktori njeri.



Foto 5 Rrëshqitjet e dheut në nacionalen N2 dhe lokalen HiE-Gllloboçicë/ Kaçanik (PZHK HiE 2010-2025)

Burimi: Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjencave – sektori i Emergjencave, Han të Elezit 2022

Shkalla e erozionit	Sipërfaqja. hektar	%
Erozion shumë i dobët	1186	3.8
Erozion i dobët	14501	47.4
Erozion mesatar	13184	43.1
Erozion i fortë dhe shumë i fortë	1759	5.7

Tabela 1. Shkalla e erozionit

Burimi; Plani Hapësinor i Kosovës 2010-2020+, Analiza Hapësinore e Hanit të Elezit

Për të penguar vazhdimin e këtij fenomeni negativ duhet të merren këto veprime hidroteknike dhe bujqësore/ biologjike.

Masat hidroteknike

- Ndërtimi i teracave, gabioneve dhe pendave në shtretërit e përroskave dhe përrenjëve si masa mbrojtëse hidroteknike për ta minimizuar fuqinë gërryese.
- Ndërtimi i argjinaturave në brigjet e lumenjve si masë parandaluese e gërryerjes
- Mbjellja e fidaneve pyjore në shtretërit e lumenjve
- Ndalimi i nxjerrjes së inerteve në shtretërit e lumenjve

Masat bujqësore

- Të mirëmbahen tokat bujqësore
- Të aplikohen drejtë praktikat bujqësore
- Përdorimi i sistemit të ujitjes dhe kullimit të bëhet në bazë të udhëzimeve të ekspertëve
- Rritja e investimeve për mbrojtjen e tokës në brigjet e lumenjve.

KUSHTET SOCIO-EKONOMIKE

Ndarja administrative

Qyteza e Hanit të Elezit ndodhet në pjesën juglindore të Kosovës afër kufirit me Maqedoninë. Shtrihet në luginën e Lumit Lepenc në mes të Bjeshkëve të Sharrit në perëndim dhe Bjeshkëve të Karadakut në lindje. Si Komunë, Hani i Elezit ka edhe dhjetë fshatra të shpërndara në të dy anët e qytetës duke formuar një model të zgjatur veriperëndim-juglindje i cili është rreth 6.5km i gjatë me një sipërfaqe prej 83.16km² ose 8315.68.67ha (0,77% të territorit të Kosovës). Pjesa më veriore e territorit është Laçi, kurse duke vazhduar ne jug arrin në kep të Fangjit në Maqedoni. Territori është në përgjithësi malor dhe karakterizohet nga bimësia e drunjtë kryesisht me origjinë nga malet me bimësi ahu dhe bungu, si dhe nga vegjetacioni barishtor që është më i lartë dhe më i shpeshtë në fusha dhe më i paktë në sasi në male.

Popullsia

Në Komunën e Hanit të Elezit jetonin 9,403 banorë sipas regjistrimit 2011⁴. Që nga viti 1948 e deri më 2011, Komuna e Hanit të Elezit ka pasur një rritje të vazhdueshme të popullsisë. Në vitin 1948 Hani i Elezit kishte 3,321 banorë, që do të thotë se për këtë periudhë kohore 63 vjeçare, numri i popullsisë ishte rritur pothuajse trefish.

	Popullsia e Komunës së Hanit të Elezit në vite							
Viti	1948	1953	1961	1971	1981	1991	2001	2011

⁴ Atlasi i regjistrimit të popullsisë 2011 <http://ask.rks-gov.net/media/2005/atlasi-i-regjistrimit-te-popullsisë-2011.pdf>

Numri i popullsisë gjatë viteve	3321	3722	4001	4693	6044	7029	7029	9403
---------------------------------	------	------	------	------	------	------	------	------

Tabela 2. Numri i popullsisë gjatë viteve

Për shkak se PZHK HiE 2010-2025 nuk ishte miratuar ende në atë kohë, ASK e konsideroi popullsinë e Komunës së Hanit të Elezit si rurale. Prej numrit të gjithmbarshëm të banorëve në komunë, Hani i Elezit dhe tre vendbanimet kryesore kishin numrin vijues të banorëve: Hani i Elezit 2,533; Seçishta 2.252; Paldenica 1,723 dhe Goranca 1,028. Vendbanimet tjera më të vogla kishin këtë numër të banorëve: Pusteniku 629; Rezhanca 475; Kriveniku 283; Dimca 249; Dërmjaku 121, Neçavci 110 dhe Vërtomica 0. Dendësia e popullsisë ishte 121 banorë/ km².

Nga llogaritë Njësies së përkohshme të ASK në Han të Elezit për REKOS 2011, zona urbane kishte 3.787 banorë ose 37.5% të popullsisë komunale që është përafërsisht sa mesatarja e Kosovës prej 38%. Me këtë rast duhet pasur parasysh se ky numër i banorëve të zonës urbane përfshin zonën kadastrale të Hanit të Elezit dhe pjesë të zonave kadastrale të Seçishtes, Dimcës, Paldenicës, Rezhancës e Pustenikut. Përveç numrit të banorëve rezident, vlerësohet se ishin 791 persona nga Hani i Elezit të cilët jetonin jashtë Kosovës më 2011⁵.

Sipas vlerësimeve ku është marrë parasysh shtimi natyror dhe migrimi, në Komunën e Hanit të Elezit në vitin 2021 jetonin 10.111 banorë⁶, që duke krahasuar me numrin aktual të banorëve në Kosovë 1,773,971, përbëjnë rreth 0,57% të banorëve të Kosovës. Sipas të njëjtit vlerësim, dendësia e popullsisë është 122¹ banorë për km², që është më e ulët se ajo e nivelit të Kosovës - 163.2² banorë për km².

Prezantimi i të dhënave statistikore për vitet e mëparshme është bërë në bazë të regjistrimeve të vitit 1948/'81, ndërsa për vitin 1991 të dhënat janë mbledhur nga statistikat të atëhershme të vlerësimit. Regjistrimet dhe vlerësimet e mëparshme të kryera nga autoritetet e Kosovës përfshijnë numrin e përgjithshëm të popullsisë, ndërsa të dhënat e regjistrimit të vitit 2011 përfshijnë vetëm popullsinë rezidente.

Mosha dhe gjinia

Në bazë të regjistrimit të fundit, popullsia e komunës është kryesisht e re. Vërehet një dominim i grupmoshave nën 30 vjet (56%). Popullsia aktive 15-64 vjet përfshinë 63% të banorëve të komunës, që është gati e njëjtë si mesatarja e Kosovës.

Sa i përket raporti gjinor në përbërjen e popullsisë, në Komunën e Hanit të Elezit vërehet një dominim i vogël i meshkujve prej rreth 1,4%.

MOSHA									
0-9	10-19	20-29	30-39	40-49	50-59	60-69	70-79	80+	Gjithsej
1,845	1,833	1,585	1,404	1,212	759	461	230	74	9,403
974	953	831	709	623	370	230	121	25	4,836
871	880	754	695	589	389	231	109	49	4,567

Tabela 2 Ndarjet e popullsisë sipas grupmoshave dhe gjinisë (mashkullore lart dhe femërore në mes)

Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës, Regjistrimi i popullsisë 2011

Përkatësia etnike

⁵ <https://ask.rks-gov.net/media/1379/migrimi-kosovar-2014.pdf>

⁶ <https://ask.rks-gov.net/media/6873/vlersimi-i-popullesise-ne-kosove-2021-final.pdf>

Nga 9,403 banorët e Komunës së Hanit të Elezit sipas regjistrimit të vitit 2011; 9,357 ishin shqiptarë (99.5%), 42 boshnjakë (në Paldenicë), 2 të tjerë, 1 nuk deshi të deklarohet dhe për 1 tjetër nuk mundën të siguroheshin të dhëna.

Ekonomitë familjare

Sipas regjistrimit të fundit të popullsisë Komuna e Hani të Elezit ka 1.452 ekonomi familjare. Në përgjithësi dominojnë familjet me nga 5 dhe 6 anëtarë si dhe ato me nga 4, 7 dhe 8 anëtarë. Gjithashtu kemi edhe numër të konsiderueshëm të ekonomive familjare me 10+ anëtarë. Ekonomitë familjare me 1,2 dhe 3 anëtarë janë me numër më të vogël rreth 9.3% e të gjitha familjeve në komunë.

NUMRI I ANËTARËVE TË EKONOMISË FAMILJARE										
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10+	Gjithsej
14	50	72	195	325	239	146	126	91	194	1,452

Tabela 3 Ekonomitë familjare sipas numrit të anëtarëve

Niveli i arsimimit

Sipas regjistrimit të fundit (2011) për nivelin e arsimit mbi 10 vjet, Komuna e Hanit të Elezit ka një nivel me ndryshime të vogla krahasuar me normën mesatare të nivelit të Kosovës. Përderisa, përqindja arsimimit mbi 12 klasë është më e lartë se ajo e Kosovës, përqindja për nivelet kolegji e mbi janë më të ulta se e mesatares së Kosovës

Niveli i arsimimit														
	Nuk ka arsim formal		Fillor		E mesme e ulët		E mesme e lartë			Kolegj	Fakulteti (bachelor)	Pasuniversitar (master)	Doktoraturë	Gjithsej
	Dinë shkërim dhe lexim	Nuk dinë shkërim dhe shkërim	1-3 klasa, sistemi fillor	4-5 klasor sistemi i ri	6-8 klasa, sistemi i vjetër	9-12 klasa, sistem i ri	12 klasa sistemi i vjetër	12 klasa, sistem i ri						
Hani Elezit	402	299	762	750	2076	773	1537	662	78	205	13	1	7,558	
%	5.3	4.0	10.1	9.9	27.47	10.2	20.3	8.8	1.0	2.7	0.2	0	10	
Kosovë	43702	43827	71623	70948	210138	77631	98748	54395	10640	29424	2811	228	1,429,175	
%	6.1	6.1	10	9.9	29.5	10.9	13.8	7.6	1.5	4.1	0.47	0.03	100	

Tabela 4 Niveli i arsimimit në Han të Elezit dhe Kosovë

Burimi: REKOS, regjistrimi, 2011

Shfrytëzimi i tokës

Bujqësia me rol mesatar në zhvillimin e gjithmbarshëm të Hanit të Elezit sipas regjistrimit të fundit të ekonomive familjare (2011) kishte vetëm 26 të punësuar që përbën vetëm rreth 2.5% të totalit të punësuarve. Numri i **ndërmarrjeve bujqësore** është tejet i ulët. Siç u përmend më lartë, numri total i ndërmarrjeve të regjistruara bujqësore përbën vetëm 4% të ndërmarrjeve në komunë, që tregon përgjithësisht për kapacitete të vogla të ndërmarrjeve dhe strukturim kryesisht familjar.

Toka bujqësore e kategorizuar sipas kualitetit i takon ekskluzivisht kategorive 5-8, përveç ndonjë sipërfaqe rreth lumit Lepenc e cila tashmë është ndërtuar veçanërisht në Lagjen e Re.

Aktiviteti kryesisht zhvillohet në formë të bujqësisë familjare për krijimin e të ardhurave shtesë në familje, me parcela të vogla private bujqësore dhe me mekanizëm bujqësor të munguar apo vjetruar (amortizuar) me përjashtim të rasteve të pakta kur mekanizmi është subvencionuar. Sipërfaqet e tokës bujqësore përgjatë Lumit Lepenc (kulturat bujqësore- lavërtare të mbjella kryesisht me misër) ujitën përmes kanaleve të hapura të ujitjes të ndërtuara si kanale klasike dheu. Serrat e perimeve, frutat e pyllit si dhe disa pemishte, të subvencionuara këto nga entitete të ndryshme, kanë sistemet enkas të ndërtuara për ujitje pikë-pikë. Perimet në hapësirat e jashtme dhe shumica e pemishteve ujitën duke shfrytëzuar burimet private, lumenjtë/përrojet si dhe ujin nga ujësjellësi. Nuk ka ndonjë sistem të mirëfilltë të ujitjes sepse shumica e këtyre sipërfaqeve bujqësore janë të shpërndara nëpër të gjithë territorin e komunës.

Viteve të fundit ka filluar përkrahja e fermerëve përmes subvencionimit nga qeveria qendrore/lokale, LAB-i (i treguar më lart), IKC-ja, Caritas Luxembourg, Caritas Kosova, Fondacioni Kosovë-Luxembourg gjithnjë në bashkëpunim me komunitetin. Në të shumtën e rasteve, subvencionimi ka përfshirë 90% të lëndës (serra së bashku me sistemin e ujitjes, farërat dhe plehrat/ushqimin e duhur apo shtalla së bashku numrin e kafshëve shtëpiake). Në disa raste janë subvencionuar edhe mekanizmat bujqësore si motokultivatorët dhe mekanizmat bujqësor përcjellës. Megjithatë nevojat për përkrahje janë ende më të mëdha se mundësitë buxhetore.




Fig.5 Harta - Përshtatshmeria e tokës

Toka bujqësore - Sipas të dhënave nga Sektori i Gjeodezisë, Kadastrit dhe Pronës, bazuar sipas regjistrit të vitit 1958, sipërfaqja e përgjithshme e tokës bujqësore është si në vijim:

Sipërfaqja e tokës bujqësore (ha)		
Tokë pjellore	Tokë lavërtarë	1.177,30
	Livadhe	230,16
	Kullosa	1.693,26
	Gjithsej	3.100,72
Tokë jo pjellore		519,40
Gjithsej		3,620.12

Tabela 3. Sipërfaqja e tokës bujqësore

Nga zhvillimet në terren dhe të dhënat komunale është më se e qartë se toka lavërtarë është duke u shfrytëzuar kualitativisht vetëm rreth 13%. Pjesa tjetër e sipërfaqes është duke u shndërruar ditaditës në tokë ndërtimore (posaçërisht Lagja e Re), lënë djerrë apo duke iu ndërruar destinimi në favor të livadheve/ kullosave.

Ndërrimi i destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore - Sipas të dhënave komunale, ndërrimi formal i destinimit të tokës bujqësore është tepër i ulët (më pak se pesë ari në vit). Kjo është shifra e bazuar në kërkesat e aprovuara për ndërrim destinimi që janë bërë për ndërtimet në zonën urbane

dhe ne vendet ku kanë marrë grante prej MBPZHR-së. Ndërtimet tjera qe janë bërë në vendbanim e në toka bujqësore janë pa leje dhe si te tilla nuk kanë as dokumente për ndërrim destinimi.

Burimi: Komuna Han të Elezit- DBZHRP-së 2022

Prodhimtaria bujqësore - Sa i përket tokës lavërtare, tradicionalisht në territorin e Hanit të Elezit (në të shumtën në Rrafshnaltën e Krivenikut) është mbjellë gruri. Kulturat tjera që mbillet tradicionalisht janë misri, elbi, tërshëra dhe patatja të cilat janë në sasi më të vogla. Mesatarja e prodhimit të drithërave sillet nga 3.5 t/ha deri në 4.5 t/ha te gruri dhe nga 5t/ha deri në 6.5 t/ha te misri. Edhe kultivimi i perimeve ka marrë hov viteve të fundit. Janë ndërtuar serra për kultivim ekstenziv të domates, specit, trangullit, pjeprit por edhe perimeve barishtore. Këto kultura mbillen edhe në hapësira të jashtme.

Në vazhdën e këtij hovi përfshihet edhe kultivimi i frutave të pyllit si dredhëza dhe mjedra. Në kuadër të pemtarisë është prezantuar edhe rrushi i tryezës. Vazhdojnë të kultivohen edhe arrat, mollarat, kumbullat, dardhat dhe frutat tjera. Kultivimi i foragjereve përfshinë barin klasik (sanë) dhe jonxhën. Këto të fundit po kultivohen nëpër toka të destinuar si livadhe

Sipërfaqet e mbjella me këto kultura janë dhënë në vijim:

Sipërfaqet e mbjella me kultura të ndryshme (ha)		
Drithërat dhe të ngjashme	Gruri	15,00
	Misri	00,00
	Elbi	13,50
	Tërshëra	2,50
	Patatja	5,00
	Gjithsej	36,10
Perime të ndryshme (domate, specia, tranguj, pjepër, perime barishtore, etj.)	Në serra	2,50
	Në hapësirë të jashtme	1,50
	Gjithsej	4,00
Fruta pylli	Mjedra	1,50
	Dredhëza	2,50
	Gjithsej	4,00
Pemishte	Arra	7,70
	Pemishte tjera (molla, dardha, ftoj, kumbulla, etj.)	5,00
	Gjithsej	12,70
Vreshta		1,50
Gjithsej sipërfaqe e kultivuar bujqësore		58,30

Tabela 4. Sipërfaqja e kultivuar bujqësore

Prodhimtaria blegtorale - Blegtoria është zhvilluar gjithashtu në kohët e fundit duke bërë që të shtohet veçanërisht numri i lopëve qumështore, por edhe të deleve dhe dhive. Edhe numri i pulave dhe kolonive të bletëve është shtuar me të madhe. Numri i tyre është dhënë në tabelën në vijim:

Numri i krerëve të kafshëve shtëpiake/ shpezëve/ kolonive të bletëve		
Gjedhi	Lopë qumështore	450
	Pjesa tjetër e gjedhit	135
	Gjithsej	585
Delet		1639
Dhitë		52
Pulat		200
Kolonitë e bletëve		2060

Tabela 5. Numri i krerëve të kafshëve blegtorale

Prodhimtaria e qumështit vlerësohet në 87,67 litra/ ditë, e mishit në 3500 kg/ vit, e vezëve 180 copë/ ditë dhe e mjaltit në 4000 kg/ vit.

Pyjet

Po sipas të dhënave nga Sektori i Gjeodezisë, Kadastrit dhe Pronës, tokat pyjore përfshijnë 4.848,56ha. E tërë sipërfaqja pyjore kategorizohet si e mbrojtur, pa destinim për ndonjë qëllim komercial.

Sipërfaqja reale e pyjeve nuk përkon me atë destinuar si më lart. Duke filluar nga vitet e 90-ta, pyjet janë dëmtuar (zjarre) dhe prerë në vazhdimësi në mënyrë jo-formale për tu shfrytëzuar si lëndë djegëse (burim kryesor për ekonomitë familjare). Në të vërtetë pyje të larta kanë mbetur në sipërfaqe relativisht të vogël. Një gjë pozitive është se aty ku pyjet janë prerë kanë filluar të rriten pyje të reja të cilat duhet ruajtur dhe zhvilluar. Shumica e sipërfaqes është potencial për pyje të larta përveç anës jug-perëndimore e cila mbulohet nga shkurret. Më së shumti është i përhapur ahu por ka edhe sipërfaqe me bung, shkozë, pishë, frashër, etj.

Në dhjetë vitet e fundit ka pasur aktivitete të pyllëzimit si mbjellja e 17 hektarëve me pisha në Gorancë nga qeveria lokale dhe qendrore, etj. Këto aktivitete planifikohen të vazhdojnë edhe në të ardhmen së bashku me përmirësimin e sistemit të menaxhimit të pyjeve. Rrallimet komerciale dhe para-komerciale janë të përvitshme dhe ndikojnë pozitivisht në mirëmbajtjen e pyjeve dhe në shërbim më të mirë të ngrohjes.

Trashëgimia kulturore

Në komunë ekzistojnë potenciale të rëndësishme të trashëgimisë kulturore materiale dhe jo materiale. Në shumëllojshmërinë e vet kjo trashëgimi kulturore përfshinë objekte të trashëgimisë arkitekturale dhe arkeologjike. Numri i objekteve dhe tërësive të trashëgimisë kulturore në komunë.




Fig. 6 Harta - Trashëgimia kulturore

Trashëgimia arkitekturale

Në kuadër të listës së trashëgimisë arkitekturale përfshihen 9 monumente/ ansamble, një i ndërtuar në shek. XVII kurse tjerat të ndërtuara gjatë shekujve XIX dhe XX. Kjo listë përfshinë një shumëllojshmëri objektesh - shtëpi, mulli dhe objekte fetare që janë të shpërndara përgjatë tërë territorit komunal. Lista e mëposhtme duhet të plotësohet në vitet në vijim me komplekse dhe objekte të luftës së fundit të UÇK-së, objekte/ shtëpi me vlerë etnografike, etj.

Emri	Periudha	Viti	Nr. unik në databazë
Lagja Daci	Shek. XIX	Pusteniq, HiE	3172
Lagja Brava	Shek. XIX	Pusteniq, HiE	3172
Pjesë e Lagjes Bushi (e Poshtme)	Shek. XX (vitet '60-'70)	Pusteniq, HiE	4158
Xhamia e Vjetër në HiE	1981	HiE	4159
Shtëpi – kullë e Baki Currit	Shek. XIX	Dërmjak, HiE	1092
Shtëpi – kullë e Muharrem Currit	Shek. XX	Dërmjak, HiE	152
Xhamia në Krivenik	Shek. XVII (1600)	Krivenik, HiE	821
Shtëpia e Naser Thaçit	Fund Shek. XIX	Krivenik, HiE	171
Mulliri i Zulbeharit	Shek. XX (para 100 vite)	Laç/ Pusteniq, HiE	4153

Tabela 6. Lista e trashëgimisë kulturore në mbrojtje të përkohshme (2021) – trashëgimia arkitekturale, nënkategoria: monument/ ansambël; MKRS, 2021

Trashëgimia arkeologjike

Lista e trashëgimisë arkeologjike ka një lokalitet dhe një objekt në Paldenicë. Është edhe lokaliteti i minierave të vjetra të kromit që Komuna/ MKRS duhet ti fusin në listë.

Emri	Periudha	Vendi	Nr unik në databazë
Lokalitet arkeologjik në Paldenicë	Romake	Paldenicë, HiE	3605
Kishë paleokristiane në Paldenicë	Shek. IV - VI	Paldenicë, HiE	797

Tabela 7. Lista e trashëgimisë kulturore në mbrojtje të përkohshme (2021) – trashëgimia arkeologjike, nënkategoria: lokalitet arkeologjik/ rezervat; MKRS, 2021

Trashëgimia shpirtërore

Si monument i veçantë i trashëgimisë ku edhe Han të Elezitu ka pjesën e vet, është listuar Eposi i Kreshnikëve. Ky është një monument i trashëgimisë kulturore shpirtërore shqiptare në pesë vendet të Ballkanit (Kosovë, Shqipëri, Maqedoni, Mali i Zi dhe Serbi), i përbërë prej gjithsej 15 vëllimesh.

Industria

Si një zhvillim që i ka dhënë karakterin qytezës dhe në të njëjtën kohë ishte edhe shkaktar i evolimit dhe zhvillimit të saj, industria është dega më e zhvilluar ekonomike në Han të Elezit. Bazuar në burimin natyror nëntokësor, mergelet si lëndë e parë për prodhimin e çimentos, i cili më vonë (gjatë viteve 70 dhe 80) u hulumtua në sasinë e 13.438.260 ton në Han të Elezit (e verifikuar) dhe 25.985.030 ton në Paldenicë (e pa verifikuar); kapacitetet prodhuese fillestare të çimentos (sot quhet fabrika për prodhimin e çimentos “Sharrcem”) u ndërtuan që në vitin 1936 duke u shtuar më vonë në vazhdimësi në vitet e 70-ta dhe 80-ta. Nga viti 2000 deri 2010 fabrika ishte e komercializuar nga firma zvicerane Holcim, kurse nga 2010 ajo është privatizuar nga firma greke Titan Group. Gjatë këtyre viteve janë bërë edhe hapa substancial në përmirësimin dhe digjitalizimin e linjave prodhuese, përmirësime në rritjen e efijencës, automatizim të punëve, menaxhim më të mirë të shëndetit dhe sigurisë së punëtorëve, reduktimet e ndotjes, etj.

Prodhimi i çimentos ka variuar nëpër vite. Gjatë sistemit të mëparshëm kishte arritur kulmin e prodhimitarisë më 1982 me 550.000 ton në vit. Pas montimit të teknologjisë më të avancuar, më 2009 u arrit sasia e rreth 600.000 tonëve në vit. Që nga atëherë e deri më 2014, prodhimtaria ka arritur çdo herë mbi 500.000 tonë në vit. Në vitin 2015 prodhimtaria vjetore arriti në 630.000 ton⁷. Me këtë sasi të prodhuar, nevojat e Kosovës mbulohen në sasinë nën 50%. Përqindja tjetër importohet kryesisht nga Maqedonia por edhe Shqipëria dhe Serbia.

Që nga viti 2002 e në disa raste edhe më parë, Sharrcem ka shfrytëzuar rreth 500.000 ton mergele në vit në mihjen sipërfaqësore në Han të Elezit duke arritur totalin e mbi 10.000.000 tonëve deri në fund të 2021. Kjo sasi duhet analizuar në kontekstin e sasisë totale të mergeles së verifikuar në zonat e lartpërmendura. Bazuar në këtë si dhe vrojtimeve në terren, mundë të thuhet se rezervat e mergeles në Dimcë janë shpenzuar në sasi relativisht të mirë që qon në përfundim se duhet shtuar masat në shfrytëzim sa më racional të kësaj lënde të parë.

Përveç qëllimit kryesor të prodhimitarisë, Sharrcem ka ndërmarrë edhe hapa për rrjetëzimin e tij si dhe për mbështetje të komuniteti në Han të Elezit. Në vitin 2011, Sharrcem ishte iniciues në themelimin e Rrjetit për Përgjegjësi Shoqërore të Korporatave (CSR). Gjithashtu është themelues dhe financuesi kryesor i Laboratorit për Aktivitete të Biznesit (LAB), i themeluar më 2014 me qëllim që të kontribuojë në edukimin dhe mbështetjen financiare të iniciativave që do të mundësonin alternativa të vetë-punësimit dhe gjenerimit të të hyrave për qytetarët e Hanit të Elezit. Në kuadër të Lab-it dhe nismave tjera për komunitetin si dhe për përfitime sociale, Sharrcemi ka investuar në vlerë mbi 450.000 euro deri në vitin 2021.

Guri gëlqeror, si burim tjetër industrial, shfrytëzohet relativisht mirë në Han të Elezit. Janë gjithsej 3 gurëthyes dhe dy nga ata operojnë për nevoja të Sharrcem.

⁷ Të dhënat janë mare nga publikimi “CSR and Sustainability Report 2015” i Sharrcemit, faqe 8-9

Fabrika "Kosovaplast" për prodhimin e stiroporit gjithashtu është privatizuar dhe shndërruar në biznes të ngushtë familjar me numër minimal të punëtorëve dhe me aktivitet të limituar. Gjithashtu ekziston një fabrikë e betonit dhe disa biznese prodhuese tjera të vogla.

Po ashtu vitin 2020 ka filluar punën impianti për pasurimin e mineralit të kromit në fshatin Gorancë (Zhedën). Është ky një investim Zviceran dhe parashihet punësimi i 50 punëtorëve të profileve të ndryshme. I tërë prodhimi është i paraparë për eksport.

Resurse tjera natyrore të pashfrytëzuara në Han të Elezit janë edhe argjila e vërtetuar me mbi 26 milion ton, guri dekorativ, kromi, hekuri dhe uji mineral.

Turizmi

Natyrë e Hanit të Elezit është shumë unike me dy masivet malore të Sharrit dhe Karadakut të cilat mbyllin çdo horizont. Në këto hapësira vlerësohen veçmas pishat e Gorancës dhe Neçavcit si dhe Pustenuku, Kriveniku dhe Dremjaku me asetin shtesë të trashëgimisë kulturore-historike. Kur kësaj i shtojmë edhe Luginat e Lumit Dimca dhe Laç të cilat janë gjithashtu atraksione të veçanta turistike, atëherë paketa turistike bëhet edhe më e larmishme. Pas 2008 është investuar edhe në infrastrukturë rrugore duke e lehtësuar qasjen drejt këtyre lokacioneve. Mirëpo duhet investuar edhe më tej në sferën e shërbimeve hoteliere-shërbyese dhe sportive-rekreative. Kombinimi i shtëpive tradicionale për qëndrim të shkurtë, ushqimit tradicional, hiking-ut nëpër shtigje malore, afërsisë së Shkupit, Bregut të Diellit/ Tetovë, Shtrazës (Kaçanik) si dhe promovimit të gjithë këtij sistemi do ta bënte më atraktive dhe më të dëshiruar shijimin e këtyre mrekullive nga qytetarët kosovar dhe nga jashtë. Ushqimet tradicionale mund të bëhen nga produktet bujqësore të treguara më lart.

Vlerat kulturore të vjetra dhe të reja (më shumë detale jepen te zhvillimi social – pjesa e trashëgimisë kulturore) gërshetohet në mënyrë unike me natyrën e Sharrit duke ia shtuar mundësitë për zhvillimin e turizmit.

Në qytezë ekzistojnë objekte banimi dhe objekte industriale të vlerësuara si trashëgimi industriale⁸ sepse i përkasin periudhës kur industria ishte në filllet e veta. Një pjesë e fabrikës Sharrcem e vlerësuar si e tillë është rrënuar para disa viteve, por kanë mbetur silosët e vjetër të cilët duhet ruajtur dhe përmirësuar në kuadër të zhvillimeve të gjithmbarshme. Rindërtimi i Hanit të vjetër ishte vlerësuar gjithashtu potencial për zhvillim të turizmit⁹. Trashëgimia kulturore me zona arkeologjike, objekte arkitektonike, objekte të veçanta të trashëgimisë¹⁰ si dhe artefakte të ndryshme do ta plotësonin mozaikun e vlerave për një turizëm serioz në Komunë.

Transporti

Lokacioni unik i Qytezës së Hanit të Elezit si vend kufitar dhe në raport me shtrirjen e rrjetit rrugor/hekurudhor nacional dhe zhvillimi në mënyrë të favorshme i rrugëve lokale në territorin e komunës mundësojnë lidhje shumë të mira të vendit me pjesët tjera të Kosovës, Maqedoninë Veriore dhe përtej. Në kontekst rajonal, Intervenimet e viteve të fundit kanë bërë që cilësia e rrugëve ndër-komunale dhe atyre lokale të jetë shumë e mirë, përderisa ka ende nevojë për intervenime në krijimin e kushteve më të mira të sigurisë dhe për lëvizjen e këmbësorëve (shih Aneksin 7, si dhe Hartën Infrastruktura e transportit).

Intervenimet e viteve të fundit kanë bërë që cilësia e rrugëve lokale që lidhin komunën dhe vendbanimet të jetë shumë e mirë, ndërsa ende ka nevojë për intervenime në krijimin e kushteve më të mira të sigurisë dhe për lëvizjen e këmbësorëve.

⁸ Sipas Planit Rregullues Urban të hartuar nga KHiE dhe UN Habitat-i më 2014, faqe 45 dhe 54

⁹ Sipas Planit Rregullues Urban të hartuar nga KHiE dhe UN Habitat-i më 2014, faqe 45 dhe 54

¹⁰ Sipas Planit Zhvillimor Komunal të hartuar nga KHiE dhe UN Habitat-i më 2011, faqe 35-36

Rrugët e nivelit lokal

Rrugët lokale - Posaçërisht në 15 vitet e fundit një pjesë relativisht e madhe e investimeve kapitale të buxhetit komunal dhe qendror si dhe donacioneve të huaja janë shpenzuar për të përmirësuar infrastrukturën e përgjithshme në Han të Elezit. Nga ky shpenzim pjesën më të madhe e mori përmirësimi i infrastrukturës rrugore ku me atë rast u shtruan (asfalt apo pllaka betoni) shumica e rrugëve lokale që lidhin vendbanimet, rrugët urbane dhe rrugë të vendbanimeve rurale. Si rezultat, të gjitha vendbanimet janë të lidhura mirë me njëri-tjetrin.

Nga tabela e mëposhtme kuptohet se janë të shtruara gjithsej 27,13 km rrugë lokale që lidhin vendbanimet duke përfshirë të gjitha rrugët që lidhin fshatrat e banuara me qytezën e Hanit të Elezit. Kanë mbetur të pashtuara vetëm rrugët lokale drejt fshatrave të shpopulluara si dhe rrugët lidhëse për ndonjë vend të caktuar (pikë turistike, etj.; ku disa nga to nuk janë të listuara këtu).

Listën e rrugëve lokale që lidhin vendbanimet e gjeni në tabelën në vijim:

Rrugët lokale në Han të Elezit			
Nr	Emërtimi i rrugës	Statusi	Gjatësia (km)
1	Hani i Elezit - Paldenicë	e shtruar ¹¹	4,36
2	Ura e Seçishtës – Seçishtë - Krivenik	e shtruar	6,40
3	Lagja Maliq - Pustenic	e shtruar	5,13
4	Rruga Nacionale N2 (Hani i Elezit) - Dimcë	e shtruar	1,30
5	Rruga Nacionale N2 (Kashan) – Laç	e shtruar	2,87
6	Rruga Nacionale N2 (Dheu i Bardhë) – Paldenicë	e shtruar	0,93
7	Hani i Elezit – Dërmjak – Neçavc – Gjurgjedell (Kaçanik)	e shtruar	8,80
8	Hani i Elezit – Lagja Curri	e shtruar	0,54
9	Rruga Nacionale N2 (Uji i Thartë) – Bush (Pustenic)	e shtruar	1,80
10	Hani i Elezit – Dërmjak i Ulët	e shtruar	0,87
11	Rruga Nacionale N2 (Kashan) – Paldenicë	e shtruar	1,38
12	Paldenicë - Vërtomicë	e pashtuar	4,20
13	Paldenicë - Neçavc	e pashtuar	4,20
14	Gorancë - Krivenik	e pashtuar ¹²	5,25
Gjithsej			48,03

Tabela 8. Gjatësia e rrugëve lokale dhe gjendja e tyre

Nga të dhënat komunale rezulton se janë gjithsej 48.03 km rrugë lokale që lidhin vendbanimet e Komunës së Hanit të Elezit dhe 34.38 km nga to janë të shtruara dhe të shënuara.

Në kuadër të rretit rrugor janë gjithsej 5 ura mbi lumin Lepenc dhe disa ura të vogla mbi përrenjtë e tjerë, të gjitha të ndërtuara nga betoni dhe të kalueshme për automjete. Përderisa të gjitha kanë linjë për këmbësorë, Ura te Ranat dhe te Uji i Thartë janë një kahore.

¹¹ Rrugë e shtruar nënkupton rrugën me shtresë asfalti apo pllaka betoni

¹² Rrugë e pashtuar nënkupton rrugën me shtresë zhavorri apo dheu

Rrugët e vendbanimeve (urbane dhe rurale) – Janë të shtruara në shumicën e rasteve. Nga 37,7 km rrugë gjithsej, janë shtruar 32,4 km.

Infrastruktura jo-motorike - Janë gjithsej 14,2 km trotuare përgjatë të gjitha rrugëve lokale të lartpërmendura dhe kjo tregon për një rrjet jo të përfunduar për lëvizje të këmbësorëve. Në zonën urbane ky rrjet është kryesisht prezent duke ofruar lëvizje të sigurte nëpër të gjitha rrugët duke përfshirë edhe shtegun për këmbësorë në Qytezë përgjatë hekurudhës me 0,8 km'. Duhet përmendur edhe shtegun e këmbësorëve drejt SHFMU në Paldenicë me 0,42 km'.

Në rrugën nacionale N2 dhe hekurudhën Fushë Kosovë – Hani i Elezit kalimet nëpër to janë jo të sigurta. Përderisa kalimet nëpër nacionalen N2 realizohet përmes "zebrave" në 5 vende dhe kalimeve joformale në shumë vende tjera, ekziston vetëm një mbikalim hekurudhe por qytetarët bëjnë kalime joformale dhe jo të sigurta së paku në 4 vende tjera. Kalimet nëpër dy akset e lartpërmendura duhet trajtuar edhe në aspekt të lëvizjes së integruar të njerëzve për të pasur qasje në funksione të ndryshme urban por edhe në pronat e tyre

Edhe pse të identifikuara, nuk ka shtigje të rregulluara për biçikleta apo shtigje malore për ecje (të rregulluara dhe shënjuara).

tutje.

Transporti

Shërbimi i transportit ofrohet në kuadër të sektorit privat përmes autobusëve dhe minibusëve, si dhe shërbimit të taksive. Në Han të Elezit nuk ka Stacion Autobusi.

Transporti ndër-komunal – Transporti publik ndër-komunal dhe ndërshtetëror realizohet përmes:

- rrugës nacionale N2. Nga qendra e Qytezës deri në Kaçanik dhe më tej si dhe anasjelltas ofrohet shërbimi me autobus 4 herë në ditë. Ekzistojnë edhe linjat me autobusë Prishtinë-Shkup dhe anasjelltas dhe Prizren-Shkup dhe anasjelltas (mbi 5 herë në ditë) të cilat shfrytëzojnë nacionalen N2 apo autoudhën R6, mirëpo në të shumtën e rasteve nuk ndalojnë në Han të Elezit;
- hekurudhës Fushë Kosovë – Shkup një herë në ditë (në mëngjes për në Shkup dhe në mbrëmje kthimi për në Fushë Kosovë) nga Stacioni i Hekurudhës në Qytezë¹³.

Transporti lokal – Po nga sheshi i Qytetit bëhet edhe transporti lokal i udhëtarëve i organizuar me minibus 3 herë në dite për në Gorancë dhe një herë në ditë për Seçishtë/Krivenik (shkuarje/ardhje).

Nga të dhënat më lart nënkuptohet se për shkak të distancave të shkurta në mes vendbanimeve dhe faktit se Hani i Elezit është komunë e vogël, transporti lokal i udhëtarëve dhe mallrave është bëhet kryesisht me makina private dhe në këmbë. Në këtë mes është identifikuar fshati Paldenicë me 1723 banorë dhe me distancë mesatare 3 dhe maksimale 5.km' nga Qyteza ku është i nevojshëm organizimi i transportit publik.

Gjithashtu mbetet nevoja për përmirësime të konsiderueshme në shërbimet e autobusëve në aspektin e kualitetit të shërbimit, shfrytëzueshmërisë dhe besueshmërisë. Është me rëndësi që të në të ardhmen të futen në funksion edhe mjete të transportit që kanë ndikim sa më të vogël negativ në mjedis.

Edhe përkundër mungesës së shtigjeve të rregulluara të ecjes dhe hiking-ut, natyra mundëson lëvizje nëpër mjediset shumë interesante të komunës. Ecjet bjeshkatore në zonën e Pustenikut dhe Gorancës, Paldenicës e Dremjakut si dhe tjera organizohen tradicionalisht për ditën e çlirimit dhe përgjatë tërë vitit nga mjedis dhe sport-dashësit.

Hapësirat për parkim

Konsiderohet se ka numër të mjaftueshëm të parkingjeve publike posaçërisht në Qytezën e Hanit të Elezit. Ky shërbim ofrohet pa pagesë. Në kontekst të përmirësimit të gjithmbarshëm të lëvizshmërisë dhe inkurajimit të lëvizjes jo-motorike, duhet bërë analiza dhe potencialisht të prezantohet pagesa e parkingjeve publike sipas kohëzgjatjes së parkimit.

239 vend-parkimet ekzistuese të menaxhuara nga Komuna dhe të hapura për publikun janë të shpërndarë në 14 lokacione si më poshtë:

Vend parkimet	Nr i vend parkimeve
Oobjekti komunal	45
Rruga Xhemsedin Suma	23
Stacioni hekurudhor	11
SHFMU Hani i Elezit	8
SHFMU Paldenicë	15
SHFMU Gorancë	5
SHF Seçishtë	5
QKMF Hani i Elezit	6
AMF Gorancë	25
Ura e Seçishtes	32
Varrezat e Dëshmorëve Pustenik	42
SHF-të në Krivenik, Laç dhe Pustenik	22
Gjithsej	239

Tabela 15 Lokacionet dhe numri i vend parkingjeve

Funksionale janë edhe 2 vend parkingje private me mbi 75 vende ngjitur kufirit ku shërbimi ofrohet me pagesë. Në të shumtën e rasteve këto parkingje nuk janë të mbushura me më shumë se 10 vende.

Bizneset private kanë gjithashtu parkingje për konsumatorët/ punëtorët e tyre duke përfshirë zingjirët e marketeve Viva Fresh, ETC dhe disa markete lokale, 2 stacionet e karburantit, Sharrcem, shumë lokale hotelerike-shërbyese etj.; me gjithsej 274 vend parkime. Këto parkingje shfrytëzohen edhe nga banorë jo të Hanit të Elezit të cilët qarkullojnë nëpër infrastrukturën nacionale/ rajonale.

Parkingje ekzistojnë edhe për kamionët transportues me gjithsej 67 vende.

2.6.5. Transporti hekurudhor

Në Komunën e Hanit të Elezit ka shtrirje të rrjetit hekurudhor. Nëse shikohet pozita në raport me rrjetin hekurudhor në nivel të Kosovës, mund të thuhet se Han të Elezit ka lidhje të përshtatshme rrugore me nyjet kryesore hekurudhore Fushë Kosovë dhe Shkup. Distanca deri në terminalin hekurudhor të Fushë Kosovës është 67 km. Sipas të dhënave nga komuna, prona e hekurudhës në komunën e Hanit të Elezit gjatësi 6.2 km' sipërfaqe prej 36.58.66 ha. Momentalisht hekurudha nuk është funksionale sepse Hekurudhat e Kosovës janë duke e rindërtuar rrjetin. stacioni hekurudhor në Qytezë dhe një mbikalim për këmbësorë po aty. Kalim formal me laurë për makina dhe këmbësorë është afër Urës së Seçishtës ndërsa kalime jo-formale janë të organizuara në 3 raste: te Uji i Thartë, te Ranat dhe në pjesën më jugore për nevoja të gurëthyesit dhe aktiviteteve bujqësore.

2.6.6. Transporti ajror

Për nevoja të lidhjes në distanca të largëta përmes transportit ajror, banorët e Hanit të Elezit përdorin Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës, i cili gjendet në një distancë prej 79 km nga qendra komunale. Përveç Aeroportit të Prishtinës, si alternativë përdoren edhe aeroporti ndërkombëtar i Shkupit me vetëm 45 km' distancë dhe ai i Kukësit dhe Tiranës. Autoudhat ekzistuese Durrës-Merdarë si dhe ajo Prishtinë-Han i Elezit mundësojnë lidhje të shpejtë dhe cilësore me këto aeroporte.

Infrastruktura e energjisë elektrike

Furnizimi me energji elektrike sigurohet nëpërmjet një sistemi të veçantë komunal dhe të përbashkët me Kaçanikun. Njësia punuese KEDS në Han të Elezit mbulon 10 vendbanime, ndërsa 1 vendbanim (Pusteni) mbulohet nga njësia punuese të komunave fqinje (shih Aneksin 8).

Infrastruktura - Energjia elektrike ofrohet në tërë Komunën e Hanit të Elezit. Ky shërbim ofrohet përmes 2 lidhjeve alternative nga Bibaj, Ferizaj si primare respektivisht nga Gjilani si sekondare. Të 2 lidhjet janë të fuqisë 35kv, secila me qëllimin primar furnizimin e prodhuesit të çimentos Sharrcem. Nga aty, përmes transformatorit 35/6kv, rrjeti i fuqisë 6kv furnizon Qytezën dhe të gjitha vendbanimet tjera përmes 14 transformatorëve me fuqi të ndryshme. Përgjatim bën Pusteniku dhe Laçi të cilët për shkak të lokacionit furnizohen nga rrjeti i fshatrave fqinje të Komunës së Kaçanikut.




Figura 8. Harta Stacionet bazë të energjisë elektrike

Në Komunën e Hanit të Elezit ekzistojnë dy stacione të energjisë elektrike si më poshtë:

- Hani i Elezit: gjatësia gjeograike-21.29703056, gjerësia gjeografike-42.15026945, dhe
- Pusteniku: gjatësia gjeografike-21.27370283, gjerësia gjeografike-42.15249998.

Në hartën më lart është e hijezuar territori i komunës ku përfshihen vetëm dy stacione bazë. Numri i konsumatorëve mesatar të lidhur në këto stacione është 3400 përdorues. Duke marrë parasysh që në këtë komunë mbulojnë nga pak edhe dy stacione baze të komunës së Kaçanikut që janë në kufi me komunën e Hanit të Elezit, pra, stacionet baze në Gllaboqice dhe Gajre (Ivajë) atëherë numri mesatar i përgjithshëm është i përafërt me 5500 përdorues. Në këtë numër të përdoruesve përfshihen edhe ata të përkohshëm (kalimtar) për shkak të qarkullimit për dhe nga Maqedonia e Veriut si dhe nga qytetet tjera të Kosovës.

Shërbimi dhe menaxhimi - Furnizimi dhe mirëmbajtja menaxhohet nga KEDS ndërsa faturimi/inkasimi nga KESCO, të dyja këto kompani private turke. Shërbimi është në përgjithësi stabil dhe pa reduktime. Përtej kësaj, edhe përkundër përmirësime të vazhdueshme, rrjeti ende mbetet në përgjithësi i vjetër dhe me defekte të herëpashershme. Problematike paraqitet edhe mungesa e ndërprerësve në pika të caktuara që do ta mundësonin furnizimin e vazhdueshëm me rryme të pjesëve të caktuara në rast të defekteve.

Numri i përgjithshëm i shfrytëzuesve të rrjetit elektro-energjetik në komunë është 3400 përdorues.

Burimi: KEDS 2022

Prodhimi i energjisë - Momentalisht nuk ka prodhues të energjisë elektrike në Han të Elezit por planifikohen së paku 2 hidrocentrale të vogla në vitet e ardhshme. Për të dy hidrocentralet në vijim Komuna ka lëshuar lejet e ndërtimit, MMPHI pëlqimet e nevojshme mjedisore/ ujore dhe ZRRE autorizimet finale:

- Hidrocentrali “Lepenci 1” me kapacitet 9.9 MW dhe pronar Hidroenergji shpk nga Ferizaj. Uji do të devijohet në gypa në lokacionin “Guri i Shpuar” (Kaçanik) ndërsa impianti prodhues planifikohet në vendin “Uji i Thartë” ngjitur rrugës nacionale N2;
- Hidrocentrali “Kotlina” me kapacitet 4.4 MW dhe pronar Muja shpk nga Prishtina. Uji i lumit Kotlina/Laç do të devijohet në gypa në fshatin Kotlinë (Kaçanik) ndërsa impianti prodhues planifikohet në Laç.

Për shkak se këto hidrocentrale nuk kanë filluar të ndërtohen sipas kohës së paraparë, të gjitha pëlqimet mjedisore/ ujore, lejet ndërtimore dhe autorizimet nga ZRRE kanë skaduar.

Burimi: OJQ Gjethi 2021

Infrastruktura e ujësjellësit

Burimet dhe infrastruktura - Zona urbane e Hanit të Elezit me Lagjet përreth (pjesa e poshtme e Seçishtes deri te burimi, lagja Maliqi, lagja Brava dhe lagjet përgjatë rrugës nacionale N2, etj.; me 5487 banorë) ka një sistem të përbashkët të ujësjellësit. Për shkak të disa problematikave që do të përshkruhen më poshtë ai është i ndarë në dy pjesë. Pjesa në perëndim të hekurudhës furnizohen nga burimet e Gllloboçicës (Kaçanik) si në vijim:

- Burimi 1 (te lajthia) në koordinatat: $x=4670199$; $y=7515681$ dhe nivel $z=773m'$
- Burimi 2 dhe 3 (kepi i shqipes) në koordinatat: $x=4670509$; $y=7515981$ dhe nivel $z=756m'$
- Burimi 3 (i cili karakterizohet me sasi të vogël uji dhe gjendet ngjitur përroit Kotlinë)

Sipas matjeve¹⁴, këto burime në periudhën e thatë kanë kapacitet prej 11-12 l/sec ndërsa në periudhën e shirave arrin deri në 18-20 l/sec. Uji nga këto burime vjen me rënie të lirë deri në rezervuarin betonarme mbi lagjen Brava në lartësi mbidetare $h=494 m'$. Rezervuari ka 2 dhoma me diametër 11.8m' dhe lartësi 4m' të cilat mundë të mbajë rezerva uji deri në $V=860 m^3$. Në kuadër të këtij sistemi ekziston edhe një rezervuar aty afër me kapacitet $V=1200 m^3$ i ndërtuar në lartësi mbidetare $h=521m'$ për të furnizuar në mënyrë të rregullt pjesën e epërme të fshatit Seçishtë, Lagjet Maliqi dhe Brava dhe ndoshta edhe fshatin Paldenicë. Megjithatë, për shkaqe teknike ai nuk është futur në përdorim. Në të njëjtën kohë edhe pjesa e epërme e fshatit Seçishtë ka rrjet të ndërtuar të ujësjellësi i cili nuk është në përdorim.

¹⁴ Matjet janë bërë nga Drejtoria Komunale e Shërbimeve Publike në bashkëpunim me UN Habitat-in në disa raste, më të fundit gjatë vitit 2015.

(OBSh) dhe rregulloreve/ normave të IKSHP (uji i burimit nëntokësor klorinohet vazhdimisht) por ka mungesa gjatë sezonës së thatë dhe shpeshherë praktikohen reduktimet e ujit sipas nevojës. Pjesa e Qytezës në lindje ka ujë jo kualitativ (uji sipërfaqësor nuk trajtohet fare) dhe mungesa gjithashtu. Kohëve të fundit janë realizuar projekte në pjesën e para-filtrimit të ujit gjatë marrjes së tij nga lumi dhe planifikohet futja e Impiantit në përdorim. Edhe pse jo funksional, Impianti në parim do të mundësonte pastrimin e ujit me para-filtrim përmes shtresave të zhavorrit të granulateve të ndryshme, filtrimin kryesor përmes dhomëzave me rërë përmes të cilave uji kalon me shtypje, rrezatimin me rreze ultravjollcë dhe klorinimin.

Sa i përket sasisë minimale të ujit nga burimet me kapacitet total 30-32 l/sec, ajo duket të jetë më se e mjaftueshme nëse krahasohet me numrin e lartpërmendur të banorëve dhe shpenzimet mesatare deri 200 l/ ditë për kokë banori. Megjithatë mungesat e ujit janë evidente. Bazuar në matjet e mësipërme, një arsye duket të jetë humbja e ujit nga burimet e Glloboçicë deri në rezervuar. Përtej humbjeve në rrjetin prurës dhe shpërndarës, gjendjen edhe më shumë e rëndojnë lidhjet ilegale dhe keqpërdorimi i ujit për ujitje dhe pastrim të rrugëve/ oborreve.

Sistemi i ujësjellësi në fshatin Gorancë menaxhohet nga vetë banorët. Në lidhje me këtë, Komuna ka bërë investimet e nevojshme për rehabilitimin e sistemit bazuar në rekomandimet e KRU-së në mënyrë që menaxhimi t'u kalojë atyre në një të ardhme të afërt. Aktualisht ujësjellësi në fshatin Gorancë përballet me të njëjtat problematika që u përmendën më lart për Qytezën. Kualiteti nuk sigurohet në vazhdimësi për shkak të klorinimit jo të vazhdueshëm si dhe ka mungesa të ujit. Gjatë sezonit veror, mirëmbajtësi i rrjetit aktivizon edhe pompën e ujit për të arritur sasinë e nevojshme për furnizim me ujë. Të gjitha këto problematika që u cekën më lart vlerësohet se vijnë si pasojë e mos menaxhimit të sistemit nga KRU dhe aplikimit të tarifës fikse për pagesë dhe jo sipas shpenzimeve.

Kontrollet e cilësisë së ujit në ujësjellësin e Qytezës, të Gorancës dhe në burimet publike në vendbanimet rurale janë të vazhdueshme nga IKSHP.

Numri i qytetarëve dhe klientëve të shërbyer me ujë përmes sistemeve të përbashkëta është si në vijim:

	Vendbanimet	Sasia e ujit	Nr i Banorëve	Kyçje amvisërie	Kyçje tjera
1	Qyteza - perëndim	5-6 l/s	2252	513	6
2	Qyteza - lindje	18-20 l/s	5,487	390	55
3	Goranca	5 l/s	1,028	196	5
		TOTALI :	8767	1099	66

Tabela 9. Sasia e ujit dhe numri i klientëve të shërbyer

Fshatrat në të cilat nuk ofrohet shërbim përmes sistemit të përbashkët të ujësjellësit janë Paldenica, Seçishta, Kriveniku, Pusteniku dhe Dimca, përderisa në Dremjak, Vërtomicë dhe Neçavc nuk planifikohen sisteme sepse ato fshatra tashmë janë zbrazur.

Infrastruktura e Ujërave të Zeza

Infrastruktura – Ngjashëm si në rastin e sistemit të ujësjellësi, sistemi i përbashkët i kanalizimit të ujërave të zeza përfshin zonën urbane të Hanit të Elezit me lagjet e lartpërmendura përreth duke përfshirë edhe lagjen Curri dhe fshatrat Paldenicë dhe Seçishte. I tërë rrjeti është funksional duke përfshirë edhe kolektorët e nevojshëm dhe ka pikën e zbrazjes në pjesën më jugore të Komunës, në lokacionin e planifikuar të Impiantit për trajtimin e ujërave të zeza ngjitur rrjedhës së Lumit Lepenc. Gjithashtu edhe fshatrat e tjera të banuara kanë sistemet e tyre (Goranca, Rezhanca, Kriveniku dhe Pusteniku duke përfshirë edhe Laçin). Për arsye të trajtimit të ujërave planifikohen të lidhen me sistemin e Qytetit. Në raport me numrin e banorëve, shërbimi me kanalizime ofrohet 100%.

Komunat e Ferizajt, Shtërpces, Kaçanikut dhe Hanit të Elezit derdhen ujërat e zeza të pa trajtuara në rrjedhat ujore të pellgut të Lepencit.

Fabrika Sharrcem ka Impiantin që trajton ujërat e zeza të kompleksit të vet (ujëra të zeza nga toaletet dhe kuzhina) dhe disa ekonomive familjare në afërsi që reliefi nuk ua mundëson lidhjen me sistemin e qytetit. Në realitet, ky është rasti i vetëm pozitiv në regjionin e Ferizajt.

Materialet e përdorura gjatë periudhave kanë evoluar dhe atë varësisht nga zhvillimi i teknologjisë përdorur ndërvenime janë bërë në tërë Komunën e posaçërisht në rrjetin e Qytezës për të zëvendësuar dhe rritur diametrat e tubave të vjetruara. Deri më 1999 janë përdorur tubat e asbest-çimentos duke u shtuar më vonë tubat e betonit dhe PVC-së, për të vazhduar në 10 vjetshin e fundit me materialet plastike PE, HDPE, SN.

Për të gjitha fshatrat janë dhënë detalet si në vijim:

Nr	Vendbanimet	Rrjet kanaliz.	Derdhet në	Nr. i banorëve	Nr. i klientëve	Gjatësia e rrjetit (m')
1	Qyteza me Paldenicë/Seçishtë	PO	Lumi Lepenc	6508	930	4230
2	Gorancë	PO	Përroi i Gorancës	1028	146	2000
3	Rezhancë	PO	Përroi i Gorancës	475	67	200
4	Krivenik	PO	Përroi i Seçishtes	289		
5	Dimcë	PO	Përroi i Dimcës			
6	Pustenik	PO	Përrockë			
7	Laç	PO	Lumi Kotlina			
8	Dremjak (i zbrazur)	JO				
9	Vërtomicë (i zbrazur)	JO				
10	Neçavc (i zbrazur)	JO				
			Gjithsej;	8300	1143	6430

Tabela 10. Sistemi dhe klientët shërbyer

Sistemi kanalizimi të ujërave atmosferik ka në qendrën e qytetit ((L=3516m') dhe në qendrën e fshatit Gorancë (L=710 m'). Kanale të hapura atmosferike ka përgjatë gjitha rrugëve lokale (L=3,710 m') Në përgjithësi ato janë funksionale por mirëmbajtja e tyre paraqitet problematike.

Menaxhimi – Mirëmbajtja e sistemit të kanalizimeve fekale dhe atmosferike menaxhohet nga Kompania e kontraktuar për Mirëmbajtjen e kanalizimit fekal dhe atmosferik e menaxhuar nga Drejtoria e Shërbimeve Publike duke realizuar të gjitha projektet dhe intervenimet e nevojshme përfshirë projektet e reja, mirëmbajtjen, dhe eliminimin e defekteve. E njëjta Drejtori ende vazhdon ti bëjë investimet në rregullimin e pjesëve të reja të rrjetit pasi që akoma ujësjellësi dhe kanalizimi publik nuk menaxhohen nga KRU.

Infrastruktura e varrezave


Në përgjithësi, secili vendbanim i Komunës së Hanit të Elezit i ka të ndara sipërfaqet e veta që i shfrytëzon për varreza. Numri i sipërfaqeve të varrezave në komunës është 12, ndërsa sipërfaqja totale e tyre është 174807 m². Përveç funksionit primar, sipërfaqet e varrezave nuk posedojnë ndonjë përmbajtje tjetër plotësuese.

Sipërfaqe të veçantë paraqet Kompleksi i Varrezave të Dëshmorëve në Pustenik. Përveç sipërfaqes së ngushtë të varrezave dhe Lapidarit, kompleksi përfshin edhe hapësirën e gjelbër të rregulluar dhe mirëmbajtur si dhe hapësirën e parkingut.

Në vijim janë dhënë lokacionet dhe sipërfaqet e varrezave publike:

Nr.	Emri, Lokacioni	Sipërfaqja (ha')
1	Varrezat e Dëshmorëve	5742 m ²
2	Varrezat e Qytezës dhe vendbanimeve përreth në Paldenicë	2500 m ²
3	Varrezat e Paldenicës në pjesën e epërme të fshatit	21300 m ²
4	Varrezat e Gorancës	13698 m ²
5	Varrezat e Rezhancës	8357 m ²
6	Varrezat e Krivenikut	17200 m ²
7	Varrezat e Seçishtës	22266 m ²
8	Varrezat e Lagjes Maliqi	3000 m ²
9	Varrezat e Lagjes Brava	7450 m ²
10	Varrezat e Dimcës	40820 m ²
11	Varrezat e Dremjakut	13097 m ²
12	Varrezat e Neçavcit	19377 m ²

Tabela 11.Lokacionet dhe sipërfaqja e varrezave



Analiza SWOT

Analiza SWOT

Më poshtë paraqiten problemet më të rëndësishme mjedisore, zonat mjedisore dhe faktorët avantazhues, përkeqësues, kërcënues dhe mundësitë për përmirësim.

Zonat me Probleme Mjedisore

Ky seksion bën një përmbledhje të analizës së mësipërme të kushteve mjedisore në Hanit të Elezit dhe vë në dukje:

- Zonat që vuajnë nga një degradim i thellë mjedisor apo që po kalojnë një shok mjedisor;
- Zonat me ndjeshmëri të veçantë mjedisore, të cilave mund të pësojnë ndryshime të pakthyeshme të ekosistemeve, në se nuk u ofrohet një mbrojtje më e mirë mjedisore; dhe
- Përmbledhje të natyrës dhe shkallës së ndikimeve të mundshme në mjedis, nisur nga përkrahjet e bëra në këtë kapitull.

Diskutim i grupeve të faktorëve në analizën SWOT.

Zonat që vuajnë nga degradim i thellë mjedisor

Lumi Lepenc, vuanë nga degradim dhe ndotja mjedisore të shkaktuar nga depozitimi i vazhdueshëm i mbetjeve të ujërave të ndotura dhe i lëndëve të ngurta. Pastrimi i lumenjve të Hanit të Elezit kërkon një menaxhim më të mirë të mbetjeve të ngurta, sidomos në vendbanimet e mëdha, si dhe sigurimin e kolektorëve të duhur gjatë rrugës.

Nëse nuk kontrollohet rritja e numrit të automjeteve, menaxhimi i emisioneve nga Sharrcem dhe nuk ndërmerren masa për të përmirësuar rrugët, standardet e karburanteve dhe të shkarkimeve, atëherë rritja e parashikuar me katër herë më shumë e mjeteve do të ketë pasoja në cilësinë e ajrit. Masat e ndërmarra nga Qeveria për reduktimin e makinave të vjetra nëpërmjet taksimeve dhe rënia e ritmit të ndërtimeve kanë dhënë efekte pozitive në ndotjen e ajrit, por janë të pamjaftueshme për të siguruar cilësi të ajrit dhe nivel të zhurmave brenda standardeve.

Zonat që kanë nevojë për Mbrojtje Mjedisore

Bazuar në të gjitha informatat të cilat janë marrë nga kjo fushë me theks të veçantë nga Instituti i Kosovës për Mbrojtje të Natyrës dhe grupi punues për Shfrytëzim të Tokës dhe Mjedis, rrjedhimisht Komuna dhe komuniteti duhet të punojnë që peizazhe dhe monumente të përzgjedhura natyrore që janë të bollshme në Han të Elezit ti fusë formalisht në Listën e Zonave të Mbrojtura të IMN/ MMPHI.

PEIZAZHET

Komuna e Hanit të Elezit është e pasur edhe me peizazhe dhe ekipet punuese kanë paraparë trajtim adekuat të laramanisë së peizazheve duke parashikuar masa dhe veprime për mirëmbajtjen dhe zhvillimin e tyre:

Bukuria e peizazhit është pasuri për turizmin. Për ta mbrojtur, intervenimet e njeriut në pikat skenike - pika atraktive duhet të minimizohen. Posaçërisht në zonat e dedikuara për zhvillimin e turizmit.

- Turizmi malor paraqet degën e re ekonomike që sapo ka filluar të zhvillohet në pjesën e Pustenikut, Neçavcit dhe ndonjë hapësire tjetër.
- Peizazhet bujqësore parashikohet që këto zona të mbrohen dhe zhvillohen me rrugë që i shërbejnë poashtu janë paraparë staza për ecje, llojllojshmëria e produkteve bujqësore është një parakusht i rëndësishëm

- për mirëmbajtjen e strukturave të vogla të këtyre peizazhit.
- Livadhet dhe kullosat është paraparë që të mbjelljen me llojeve të shumta të bimëve barishtore.
- Vargmalet është paraparë që të mbrohen nga prerja e pakontrolluar e pyjeve dhe zjarret duke penguar erozionin i cili është fenomen i cili paraqitet në zonat e zhveshura.

Argumente të Analizës SWOT

Pikat e forta

Në komunën e Hanit të Elezit ekzistojnë hulumtime të natyrave dhe fushave të ndryshme të cilat janë bërë edhe në të kaluarën edhe tani ka një inventarizim bukur të mirë të identifikimit të problemeve mjedisore, ka analiza për ekosisteme, ka strategji të zhvillimit ekonomik, analizë hapësinore, plane dhe projekte të zhvillimit komunal dhe mbrojtje të mjedisit si dhe këtë dokument të VSM i cili analizon në mënyrë sistematike ndikimet potenciale mjedisore nga aplikimi i Planit Zhvillimor Komunal. Duke qenë komunë me një bujqësi të zhvilluar sidomos lider për hortikulturë dhe pylltari poashtu mjaft të zhvilluar, kjo komunë është në avantazh për shkak të pozitë së saj që ka si zonë kufitare por edhe vetë si komunë si zona ekonomike dhe sociale me potenciale të konsiderueshme të zhvillimit ekonomik, turistik, komunikimet (rrjeti nacional dhe ndërkombëtare i infrastrukturës). Pika të forta janë edhe prezenca e kapaciteteve të zhvilluara intelektuale, kapacitetet rinore. Kemi edhe për çdo ditë e më shumë instalimin e teknologjive inovative dhe reduktim të dukshëm të industrive ndotëse. Legjislacioni mjedisor është drejt përafrimit me atë të Bashkimit European.

Pikat e dobëta

Hani i Elezit vazhdon të ballafaqohet me zbrazje të disa vendbanimeve, me ndojte nga fabrika e çimentos, me ndotje të ujerave. Zbrazja e këtyre vendbanimeve dhe ndikimi i presionit të rritjes dhe zhvillimit në disa vendbanime tjera determinohen kryesisht me mungesën e vendeve të punës, papunësisë mungesa e shërbimeve dhe kulturës së jetesës, faktorë që duhen të menaxhohen.

Probleme me pronën private të truallit, privatizimet, prania e hot spoteve mjedisore si ajo te fabrika e çimentos dhe në pikat tjera, mungesa e zbatimit korrekt të legjislacionit, veçanërisht atij mjedisor, krahas zhvillimeve të pa kontrolluara gjate dy dekadave te fundit, janë pjesë e pikave të dobëta në këtë analizë. Pika të dobëta vazhdojnë të mbeten mangësitë në trajtimin e trashëgimisë kulturore, arkeologjike, të ndërtuar dhe natyrore, infrastrukturës, veçanërisht në furnizimin me ujë të pijshëm, kanalizimi i ujërave të zeza, mungesa e pastrimit të ujërave të zeza, menaxhimi i dobët i mbetjeve komunale, etj.

Mundësitë

Mundësitë e Hanit të Elezit janë të mjaftueshme pasi që është në zonë kufitare, lidhje permes autoudhes Prishtinë - Shkup, si dhe ka zona të mjaftueshme të trashëgimisë kulturore dhe arkeologjike si dhe mbështetjen e mundshme të donatorëve dhe qeverise, është e mundur që komuna të vazhdoj të hartojë dhe zbatojë plane, programe dhe iniciativa të tjera për zhvillimin e studiuar të pjesëve të trajtuar me këtë plan zhvillimor komunal dhe trajtuara si zona për shfrytëzime të ndryshme, trajtimin e hapësirave të zgjeruara ndërtimore të parapara me planë, hapësirave pyjore, peizazheve atyre rekreative dhe përmirësimin e treguesve mjedisorë. Në Planin e Zhvillimit Komunal është e mundur të rritet ndjeshëm aplikimi i Ligjeve dhe Vendimeve të Kuvendit Komunal në favor të mjedisit dhe shëndoshjes së financave publike komunale. Me qëllim të rritjes së hapësirave publike rekreative është e rekomanduar inkurajimi i biznesit privat në hapësirat rekreative (parqe, salla lojërash, fusha

sporti, sipërfaqe për fëmijët). Rritja e cilësisë së transportit publik është një mundësi që duhet të zhvillohet.

Kërcnimet

Mos trajtimi i hot spoteve mjedisore, mos trajtimi i zonave të mbrojtura mundë të shkaktoj kërcënime serioze mjedisore dhe shëndetësore në komunën e Hanit të Elezit.

Humbje e vlerave natyrore, rekreative, shkencore dhe turistike, vendbanime të tëra të mbesin pa asnjë banor, kostoja e shërbimeve të ngritët deri në shkallën që shkakton trazira sociale dhe ekonomike. Problemi i pronësisë së tokës sidomos mungesat e pronave komunale për zhvillime përbejnë një grup problemesh shqetësuese ndikimi i të cilëve do të vazhdojë gjatë.

Nëse bazohemi në faktin se blerja e sipërfaqeve për parqe, hapësira shlodhëse kërkon financime të mëdha dhe në kontekstin e buxheteve jo të mëdha të Hanit të Elezit përbejnë një tjetër kërcënim.

Analiza SWOT

<p>Përparësitë Në përgjithësi me PZHK janë trajtuar të gjitha problemet dhe sfidat mjedisore Në përgjithësi PZHK është një projekt i mirë; Kushte të përshtatshme fiziko-gjeografik, turizëm i zhvilluar dhe burime natyrore kryesisht të mjaftueshme; Interesim në rritje i qytetarëve, autoriteteve shtetërore dhe shoqërisë civile për mjedisin Legjislacion mjedisor dhe planifikimi hapësinor i zhvilluar dhe përmirësuar; Prani i teknologjive inovative në procese industriale dhe ndërtimore; Kushte të mira të transportit të mallrave dhe njerëzve; Rritja e efektshmërisë së zbatimit të Ligjeve dhe detyrimeve financiare të popullsisë dhe biznesit në raport me taksat komunale; Përfshirja e ekipeve të kualifikuara në zbatimin e planeve dhe hartimin e projekteve të rëndësishme në kuadër të PZHK-së;</p>	<p>Dobësitë Mungesa e disa informatave për thellim të analizave për zhvillimet e planifikuara me PZHK Shkallë e lartë e ndërtimeve informale; Përqindje e lartë e papunësisë; Shpopullimi i zonave malore dhe përqendrim i konsiderueshëm në zonat e ulëta; Rrugë me përmbajtje jo të plotë (trotuar, parkingje, etj) Shkallë e konsiderueshme nga ndotja e zhurmës dhe gazrave të djegieve të brendshme motorike; Motivim i ulët në segment të caktuar të administratës publike dhe qeverisjes lokale; Zvogëlimi i hapësirave të gjelbërta dhe hapësirave të tjera publike; Ndërtimi i banimit kolektiv pa norma të duhura urbanistike dhe ndërtimore; Mungesa e koordinimit me komunat për rreth; Infrastrukturë jo shume e zhvilluar dhe e paintegruar (jo shumë funksionale); Menaxhim i dobët i mbeturinave; Mos trajtimi i hot spotëve mjedisorë; Menaxhim jo i mirë i turizmit; Shkallë e ulët e të hyrave vetanake në buxhetin e komunës;</p>
<p>Mundësitë Planifikimi i masave për mbrojtje dhe zhvillim të mjedisit; Gatishmëri e donatorëve dhe Qeverisë për trajtim të pikave të nxehta mjedisore; Burimet alternative të energjisë së erës, diellit dhe ujit. Zhvillimi i kapaciteteve manaxhuese të politikave, planeve dhe programeve në nivel komunal; Krijimi i një Forumi qytetar gjithë përfshirës për kualitet të jetës më të mirë, si një njësi për oponencë dhe edukim mjedisor; Bashkëveprim i koordinuar me komunat tjera; Ndërtimi i impiantit regjional dhe trajtimi i përkohshëm në pikat e fundit të derdhjeve të ujit të përdorur. Përmirësimi i shërbimeve në transportin publik; Përfshirja e biznesit privat në hapësirat pyjore, të gjelbra dhe rekreative (parqe, salla lojërash, sipërfaqe për fëmijët).</p>	<p>Kërcënimet Rrezikim i shëndetit të popullatës; Prishje e balancit mjedisor; Shkatërrim i resurseve tokësore, ujore dhe resurseve tjera; Shkatërrim i ekosistemeve, biodiversitetit, florës dhe faunës; Shkatërrim i trashëgimisë kulturore dhe natyrore; Konflikte në lidhje me çështjet e pronësisë; Pakësimi i hapësirave publike për shkak të presionit; Mungesa dhe/ose kosto e lartë për disponim e sipërfaqeve të lira për projekte zhvillimore; Ulje e ndjeshme e biodiversitetit; Mungesa e koherencës midis aksioneve të shoqërisë civile dhe pushtetit vendor, donacioneve dhe departamenteve universitare/studiove profesionale etj.</p>

PLANI ZHVILLIMOR KOMUNAL

VIZIONI DHE SKENARET E ZHVILLIMIT

Vizioni i Komunës së Hanit të Elezit

Komuna e Hanit të Elezit komunë e shëndetshme me peizazhe dhe ekosisteme interesante. Vend i resurseve natyrore me traditë industriale. Vend i ofertave të mëdha për investitor të brendshëm dhe të jashtëm. Vend i përshtatshëm për zhvillim të bujqësisë moderne dhe të organizuar. Komunë policentrike me lidhje funksionale, komunale dhe rajonale si dhe me vlera të trashëgimisë kulturore. Vend ku përkrahet dija, puna, mirëqenia, në funksion të kualitetit jetësor dhe mjedisorë.

Koncepti i Zhvillimit Hapësinor i Hanit të Elezit

Ekipi komunal i planifikimit dhe ekipet tjera të angazhuara në hartimin e Planit Zhvillimor Komunal kanë analizuar nga aspekti ekonomik, social dhe mjedisor disa koncepte dhe skenarë të mundshme të zhvillimit hapësinorë të vendbanimeve, pas analizës serioze në rrafshin profesional, politike por edhe me shoqërinë civile, duke marrë parasysh gjendjen faktike në komunë dhe zhvillimet që kanë ndodhur në hapësirën e komunës së Hanit të Elezit por edhe të gjitha implikimet që reflekton kjo gjendje në aspektin ekonomik, social dhe mjedisorë është konstatuar se duhet te behet:

- Shfrytëzimi racional i tokës dhe zhvillimi i vendbanimeve në mënyrë kompakte
- Qytetarët e informuar/ me njohuri të nevojshme dhe të përfshirë në vendim-marrje
- Ofrimi i infrastrukturës/shërbimeve sociale baras për të gjithë qytetarët
- Ofrimi i lëvizshmërisë optimale dhe të sigurve për qytetarët dhe vizitorët
- Ofrimi i infrastrukturës/shërbimeve teknike baras për të gjithë qytetarët
- Nxitje e zhvillimit ekonomik bazuar në potenciale lokale
- Krijimi i një mjedisi të sigurve përmes përmirësimeve organizative, mjedisore dhe adresimit të ndryshimeve klimatike
- Mbrojtja e trashëgimisë natyrore/ biodiversitetit dhe trashigimia kulturore

Koncepte t e Zhvillimit Hapësinor

Janë elementet konceptuale të mëposhtme përmes të cilave është përshkruar dhe strukturuar organizimi hapësinor në Han të Elezit si dhe synohet të arrihen qëllimet e parapara rrjedhimisht i tërë zhvillimi i planifikuar i Komunës:

- **Nyjet** – Janë përqendrimet e aktiviteteve zhvillimore-funksionale sipas një apo disa karaktereve të veçanta të zhvillimit bazuar në potenciale të caktuara që i ka zona.
- **Korridoret** – Janë lidhjet funksionale në mes të nyjeve të lartpërmendura dhe me komunat tjera.
- **Zonat e rritjes** – Janë hapësira në territorin komunal ku parashihen zhvillime të reja nga ato ekzistuese. Bëhet fjalë kryesisht për zona banimi dhe ekonomike.
- **Plotësimi dhe dendësimi** – Janë zonat e planifikuara për plotësim dhe dendësim. Bëhet fjalë kryesisht për zonat e ekzistuese të ndërtuara urbane të cilat kanë hapësira për t'u plotësuar dhe dendësuar përmes ndërtimeve më të dendura dhe rritjes së etazhitetit ku planifikohet inkurajim i ndërtimeve më të larta. Këtu mundë të përfshihen edhe vendbanime rurale të caktuara në të cilat do të inkurajohet dendësi më e lartë banimore kryesisht përmes shfrytëzimit më kompakt të hapësirës dhe parcelave më të vogla për banim.
- **Mbajtja nën kontroll** - Ky koncept ka për qëllim mbajtjen nën kontroll të hapësirave të ndërtuara, rritjen e dendësisë kryesisht në qendrën urbane dhe në ato vendbanime që ka një rritje të shtuar, duke e dekurajuar zhvillimin horizontal dhe dëmtimin e tokës bujqësore/ pyjeve.
- **Mbrojtja** -Përmes këtij koncepti është planifikuar mbrojtja e resurseve natyrore, ekonomike, dhe trashëgimisë kulturore. Pra koncepti zhvillimit parasheh mbrojtjen e tokave bujqësore

përmes kufizimit të shtrirjes ndërtimore të pakontrolluar dhe mbrojtjen e resurseve natyrore dhe kulturore si aset për zhvillim të turizmit.

Skenarët e propozuar hapësinor

Me qëllim të arritjes së një zhvillimi gjithëpërfshirës të Hanit të Elezit janë propozuar dhe shqyrtuar 2 skenarët e mëposhtëm. Përveç temave tjera, skenarët janë zhvilluar përmes punëtorisë së vizionimit e cila u bë me pjesëmarrje të gjitha palëve të interesit dhe pas një vlerësimi të tyre është arritur pajtueshmëria për skenarin e dakorduar.

Skenari 1 – Zhvillimi qendror - Sipas këtij skenari zhvillimi është propozuar të përqendrohet plotësisht në Qytezë dhe lagjet përreth. Përveç si nyje administrative me shërbime publike për të gjithë komunën, aty do të koncentroheshin edhe zhvillimet ekonomike kryesore. Zona urbane do të dendësohej si dhe do të zhvillohej edhe më tej horizontalisht në hapësirë, ndërsa bujqësia dhe pylltaria do të zhvillohej në zonat rurale. Zhvillimi do të bazohej kryesisht në shtyllat në vijim: industri, shërbime, tregëti, bujqësi, dhe turizëm.

Përparësitë - koncentrimi dhe kualiteti i shërbimeve sociale, ruajtja dhe shfrytëzimi i tokave bujqësore dhe pyjore, lehtësi në kontrollin e zhvillimeve në përgjithësi dhe plasimi i informacionit turistik më kualitativ, etj.

Mangësitë:

Zhvillimi i koncentruar dhe ndarja jo e barabartë e zhvillimit tek banorët, Koncentrim i zhvillimit të banimit në Qytet, shërbime më pak kualitative në fshatra, nxitje e udhëtimeve dhe ndotje të mjedisit, etj.

Sipas vlerësimit, shumica e propozimeve nga ky skenar janë planifikuar të futen në konceptin zhvillimor të dakorduar.

Skenari 2 – Zhvillimi i decentralizuar - Sipas këtij skenari, përmes kontrollit të shtuar, zhvillimet do të drejtoheshin në 3 nyje kryesore: Qytezën, Paldenicën dhe Gorancën. Me atë rast Qyteza do të shërbente si nyje kryesore administrative dhe si vend industrial, ndërsa 2 nyjet tjera, përveç shërbimeve administrative dytësore dhe sociale të nivelit të njëjtë me Qytezën, do të kishin të zhvilluar edhe ekonominë përmes turizmit, shërbimeve dhe tregtisë. Me atë rast, për shkak të vështirësive të kompaktësisht, 2 vendbanimet sekondare do të zhvilloheshin horizontalisht kryesisht me banim, funksione përcjellëse dhe funksione ekonomike.

Përparësitë – zhvillim më i shpërndarë territorialisht sipas potencialit të lokacioneve; numër i caktuar i bizneseve shërbyese hoteliere të konsoliduara, shërbime sociale kualitative të shpërndara më mirë për banorët lokal

Mangësitë – Vështirësi e kontrollit të zhvillimit dhe udhëheqjes së tij në 3 nyjet e përzgjedhura, dëmtimi fondit të tokave bujqësore dhe pyjore, dëmtim i resurseve turistike nga zhvillime individuale, pamundësi e plasimit të paketës së tërësishme turistike komunale, etj.

Sipas vlerësimit, aspekte pozitive nga ky skenar janë planifikuar të futen në skenarin respektivisht konceptin zhvillimor të dakorduar.

Skenari i dakorduar – Skenari 1 (zhvillim qendror) - me propozime pozitive të integruara nga skenari 2 (zhvillim i decentralizuar) - Me këtë skenar zhvillimi të dakorduar parashihet zhvillim i balancuar mes Qytezës si nyje kryesore zhvillimi dhe shpërndarje e zhvillimeve kryesisht sociale (arsim, shëndetësi kulturës sport e të ngjashme) dhe turistike për të gjithë banorët e Komunës. Planifikohet zhvillimi i mëtejshëm i qendrës urbane/ Qytezës. Qendrat sekondare dhe qendrat e përzgjedhura turistike i bashkëngjiten hartës zhvillimore të komunës me qëllim të shfrytëzimit maksimal të natyrës, trashëgimisë dhe kapaciteteve komunale gjithnjë duke e balancuar atë me

zhvillim bujqësor të kufizuar, zhvillim pyjor dhe mbrojtje të mjedisit. Më shumë detale i gjeni në pjesën e konceptit zhvillimor

Deri te ky propozim zhvillimor i dakorduar erdhi bazuar në potencialet reale të komunës, duke i marrë për bazë aspekte pozitive nga skenarët e mëparshëm dhe duke pasur si synim strukturimin e të gjitha potencialeve dhe ambicieve të banorëve të Komunës.

Koncepti i zhvillimit hapësinor të Komunës së Hanit të Elezit

Koncepti kryesor i zhvillimit hapësinor është zhvilluar duke u bazuar në analizën paraprake dhe konceptet e nyjeve/ qendrave me karakter të ndryshëm funksional që mundësojnë zhvillim më intensiv; korridoreve që lidhin nyjet në mes tyre, plotësimin dhe dendësimin të sipërfaqeve të ndërtuara, mbajtjes nën kontroll të zhvillimeve të dëmshme, mbrojtjes së resurseve natyrore, kulturore dhe ekonomike; dhe rritjes së zhvillimit në zonat ekzistuese.

Zhvillimi administrativ dhe ofrimit të shërbimeve publike planifikohet me qytezan si qendër kryesore ku ofrohen dhe koordinohen këto shërbime. Me shërbime arsimore që do të vazhdohet të ofrohen për gjithë banorët e Komunës në tri SHFMU-të dhe në SHML-në, shërbimet shëndetësore përveç qendrës komunale do të kenë prioritet shtesë edhe 2 vendbanimet më të mëdha rurale (Gorancë dhe Paldenicë) për arsye të numrit më të madh të banorëve dhe lidhjet gravituese të fshatrave përreth. Aty planifikohen shërbime të nivelit të AMF-ve. Për më shumë do të jenë këto dy fshatra dhe Seçishta që do të kompaktësohen dhe dendësohen si vendbanime për të ruajtur tokën për zhvillime tjera të planifikuara dhe së bashku me qytezan për të akomoduar numër më të madh të banorëve.

Zhvillimi ekonomik do mundësohet kryesisht përmes ruajtjes së industrisë ekzistuese dhe promovimit të industrive të reja të ndërlidhura. Industria ekzistuese është ajo e materialeve ndërtimore. Prodhuesi i çimentos në Komunë është i vetmi në Kosovë, ndërsa guri gëlqeror shfrytëzohet relativisht mirë për të prodhuar rërë dhe zhavorr. Këto industri planifikohen të mbeten ndërsa do të promovohen industritë e ndërlidhura ndërtimore si p.sh. materialet ndërtimore gjysmë të fabrikuar që shpejtojnë procesin e ndërtimit me theks te objektet banuese dhe hapësirave të mëdha për prodhim serik. Të gjitha këto zhvillime vlerësohet se do të mbajnë në nivel edhe veprimtaritë tjera të ndërlidhura si transporti i mallrave, hoteloritë, etj. Për të mundësuar këtë zhvillim është paraparë krijimi i zonës ekonomike në Gorancë e cila do të jetë shtysë e këtij zhvillimi. Natyrisht se parashihen zona komerciale më të vogla në Qytet që për qëllim do ta kenë joshjen bizneseve industriale të vogla, rrjeteve të qendrave tregtare, bizneset tregtare, bizneseve shërbyese, etj. Shtysë për ndërmarrjet e vogla do të jetë edhe zgjerimi i planifikuar i shërbimeve të terminalit doganor i cili gjendet në Han të Elezit.

Për të pasur një zhvillim të qëndrueshëm dhe të shëndetshëm dhe i cili do të mundësojë edhe zhvillimet ekonomike të mëposhtme, mjedisit dhe reduktimit të ndotjes do të kushtohet vëmendje e veçantë. Edhe përkundër investimeve të industrive në kontekstin mjedisor, Hani i Elezit mbetet ende hot spot i ndotjes. Në kuadër të PZHK-së planifikohet qasje më serioze në reduktimin e ndotjes me synim arritjen e standardeve në fuqi. Inspektorati komunal në bashkëpunim me inspektoratin qendror të mjedisit, OJQ-të mjedisore dhe organizatat tjera do të arrije deri te rezultatet e vazhdueshme nga analizat e pavarura për të pasur gjendje reale mjedisore. Dhe bazuar në ato rezultate do të veprojnë si mekanizëm i pa-kompromis për të ndaluar/ parandaluar ndotjen. Parimi ndotësi paguan do të jetë prioriteti bazë.

Turizmi planifikohet të jetë një shtysë e rëndësishme e zhvillimit të gjithmbarshëm të Komunës. Duke shfrytëzuar të mirat unike të natyrës si Sharri e Karadaku, pyjet e pishave, lugina e Lumit Dimcë, etj.; planifikohen të krijohen zona turistike p.sh. në Pustenicë, Gorancë e Neçavc, prezantimin e sporteve malore, etj.; të lidhura me korridore ekologjike të zhvilluar enkas. Pika turistike do të ketë

edhe në Dërmjak, luginës së përroit të Dimcës dhe tjera. Trashëgimia Kulturore dhe historike planifikohet të kapitalizohet si pjesë integrale e këtij sistemi e cila do ti jepte një shtysë të rëndësishme zhvillimit të tij. I gjithë ky aranzhman turistik planifikohet të koordinohet nga qyteza me pikat orientuese në Pustenic dhe zonat turistike kryesore.

Edhe përkundër resurseve të kufizuara të tokës bujqësore, planifikohet shfrytëzimi maksimal i atyre sipërfaqeve (toka pjellore ngjitur Lepencit, lavërtaria në Krivenik si dhe livadhet/ kullosat në të gjithë Komunën). Për blegtori, prioritet do të jenë shfrytëzimi i kullosave të Sharrit dhe në Paldenicë. Pemtaria, perimtaria dhe frutat e pyllit do të kenë gjithashtu fokus të veçantë.

Fshatrat do të përbëjnë rrjetin bartës të zhvillimit rural. Me qëllim të ofrimit të zhvillimit të qëndrueshëm, fshatrat do të jenë të mbështetura me shërbime të mira publike e sociale, si dhe infrastrukturë adekuate. Në aspekt të zhvillimit hapësinor parashihet konsolidimi i strukturave të ndërtaura, deri në pikën ku karakteri i fshatit nuk ndryshohet dukshëm.

Të gjitha zhvillimet janë shtjelluar më hollësisht poshtë në kapitullin e zhvillimit sipas sektorëve.

Zhvillimi sipas sektorëve

Mjedisi dhe trashëgimia natyrore dhe kulturore

Mbrojtja e mjedisit – Duke përfshirë pjesën lindore të Qytezës e cila në kontekst të ndotjes së ajrit do të adresohet si më poshtë, pjesa tjetër e komunës ka natyrë dhe mjedis fantastik. Natyra e Sharrit dhe Karadakut dhe e korridoreve përgjatë rrjedhave ujore përbëjnë rrjetin e gjelbër unik të shtrirë në mbi 75% territorit komunal. Ky ekosistem natyror deri së voni kryesisht i paprekur ofron ujin e pastër nga krojet dhe përrenjtë e shumtë, pastrimin e ajrit dhe ujit të ndotur, resursin për energji dhe ngrohje, lokacionin shumë të përshtatshëm për relaksim dhe socializim për banorët si dhe kushte esenciale për biotën ujore dhe jashtë saj.

Me qëllim të mbrojtjes së këtij mjedisi natyrore dhe shijimit/ shfrytëzimit të tij të qëndrueshëm, sipas legjislationit aktual të zbatueshëm, planifikohet që organet relevante por edhe të gjithë akterët që veprojnë në mjedis të shfrytëzojnë dhe mbrojnë këtë resurs kyç sipas parimeve të zhvillimit të qëndrueshëm. Rekomandimet të përgjithshme janë dhënë në vijim:

- shfrytëzimi i resurseve natyrore (uji, pyjet, mergeles, guri gëlqeror, kromit etj.) të jetë i planifikuar në mënyrë integruese dhe gjithmonë bazuar në këtë dokument. Edhe implementimi i këtyre projekteve të jetë serioz duke aplikuar parimin e “zhvillimit të projektit dhe kthimit të tij në gjendje të pranueshme për segmente apo faza të projektit”, si dhe duke monitoruar në mënyrë permanente shfrytëzimin e resursit dhe përmirësimet mjedisore sipas marrëveshjes paraprake;
- të gjithë operuesit duhet të ndërtojnë apo instalojnë pajisje/ impiante përkatëse në mënyrë që mbetjet nga operacioni tyre që kalojnë në natyrë të jenë sipas standardeve në fuqi. Këtu përfshihen mbetjet industriale, ujërat e zeza, mbeturinat dhe çdo lloj externalje tjetër. Në rast të kundërt, organet relevante operojnë sipas parimit “ndotësi paguan”.

Komuna gjatë zhvillimit të hapësirave në zonat me vlerë natyrore dhe kulturore historike duhet të ketë parasysh masat e mbrojtjes të vlerave natyrore dhe tërësive kulturo-historike, e caktuara me PHK.

Përtej mbrojtjes së këtij mjedisi natyrore, ai planifikohet të përmirësohet dhe shfrytëzohet si rrjet i alternativ i lëvizshmërisë jo-motorike i cili do ta plotësojë konceptin e përgjithshëm zhvillimor. Brezet e zhvilluara përgjatë rrjedhave së lumenjve si korridore natyrore të gjelbra do të paraqesin mundësi ideale për vija të shëndetshme dhe funksionale qarkullimi dhe në të njëjtën kohë do të paraqesin disa prej atraksioneve kryesore në kuadër të komunës.




Fig 11. Harta - Ndotja e mjedisit

Mbrojtja e ajrit - Edhe pse me përmirësime gjatë viteve të fundit, problematika e ndotjes së ajrit në Qytezë në pjesën lindore prej lumit Lepenc, ende përbën çështje e cila duhet adresuar seriozisht. Komuna së bashku me organet relevante të qeverisë qendrore do të bashkëpunojnë ngushtë për të reduktuar ndotjen nga pluhuri dhe gazrat brenda standardeve kosovare. Do të bëhen studime për të ditur pse matjet nga stacioni i IHMK-së dhe Sharrcem tregojnë kryesisht jo ndotje me tejkalime minimale ndërsa situata në terren ndryshon. Studimi gjithashtu do të krijojë listën formale të

ndotësve dhe do të mundësojë analiza mikro-hapësinore për pjesë të caktuara të qytezës sipas potencialit që kanë për tu ndotur. Rekomandimet nga studimet do të përfshijnë hapat e mëtutjeshëm në reduktim përfundimtarë të ndotjes, pastrim të Qytezës nga pluhuri dhe monitorim të vazhdueshëm për të mos lejuar kthimin në gjendjen e mëparshme. Krijimi i brezave të gjelbër mbrojtës përreth industrive duhet të jetë pjesë e përmirësimeve në këtë fushë. Edhe pse deri tani organet relevante qendrore kanë qenë dhe janë përgjegjëse për monitorim të ndotjes së ajrit (marrja/ analiza e rezultateve nga stacioni monitorues dhe aplikimi i gjobave sipas rastit), duke marrë parasysh gjendjen e krijuar dhe vështirësinë e monitorimit, organet lokale duhet të bëhen bashkëpërgjegjëse në këtë rast. Kjo do të rezultojë me reagim më të shpejtë dhe efikasitet më të lartë. Parimi “ndotësi paguan” duhet të aplikohet patjetër ndërsa gjobat duhet të jenë në raport të drejtë me dëmet eventuale.

Përtej këtyre hapave, bazuar në ligjet në fuqi do të behet kontrollimi i emetimeve të pluhurit dhe tymit nga çdo operues duke përfshirë industritë tjera, gurëthyesit, bizneset/ administrata/amvisëritë (ngrohja), djegiet e mbeturinave, etj. Përgjatë rrugëve rekomandohet të mbillen pemë për të krijuar tamponë të gjelbërimit. Në planin afatgjatë, PZHK synon zhvillim më kompakt dhe përdorim më të vogël të automjeteve me qellim të zvogëlimit të dioksidit të karbonit. Gjithashtu është planifikuar eliminimi i mbeturinave ilegale në një afat sa më të shkurtër.

Mbrojtja e ujit -Bazuar në udhëzimin administrativ për normat teknike të planifikimit MMPH Nr.08/2017 (shtojcë kapitulli II, neni 3) është planifikuar mbrojtja e ujerave sipërfaqësor dhe nëntokësor përmes përcaktimit të 3 zonave mbrojtëse ujore dhe përmes aplikimit të masave konkrete do të bëhet eliminimi i ndotësve - deponive joformale përmes menaxhimit të mbeturinave; ujërave të zeza për sistemeve të kanalizimeve dhe aktiviteteve tjera të faktorit njeri. Komuna do të marrë masa për mbrojtjen e zonave ujore, burimeve të ujërave nëntokësore dhe sipërfaqësore, si dhe vet ujerave sipërfaqësor dhe ujë-rrjedhave të hapura

Mirëmbajtja e ujerave, kontrollimi i zhvillimeve dhe ndërtimet do të ndalohen dhe kufizohen në bazë të ligjit për ujërat dhe udhëzimin administrativ për normat teknike të planifikimit MMPH Nr.08/2017 (shtojcë kapitulli 3 paragrafi 3)

Mbrojtja e tokave bujqësore- Bazuar në udhëzimin administrativ për normat teknike të planifikimit MMPH Nr.08/2017 (shtojcë kapitulli II neni 1) toka bujqësore, si aset ekonomik dhe mjedisor, do të mbrohet nga fragmentimi, erozioni dhe degradimet tjera si ndërtimi i shpërhapur. Si masë veçantë në këtë drejtim do të jetë respektimi i kufijve të zonave ndërtimore. Ndërkaq toka bujqësore përgjatë lumenjve do të ketë trajtim të veçantë sa i përket mbrojtjes nga ndotja, për shkak të ndikimeve që mund të shkaktohen në rrjedhën e tyre nga herbicidet/ pesticidet/ ushqimet bujqësore të përdorura përmes monitorimit dhe kufizimit të përdorimit të tyre. Do të merren masa për mbrojtje nga erozioni, fragmenti dhe ndërtimi ashtu siç e përcaktojnë normat teknike të planifikimit MMPH Nr.08/2017 paragraf 1.3).

Mbrojtja e pyjeve - Bazuar në udhëzimin administrativ për normat teknike të planifikimit MMPH Nr.08/2017 (shtojcë kapitulli II neni 2) pyjet do të jenë të mbrojtura nga degradimet dhe prerjet ilegale (shpyllëzimi). Pjesët e degraduara do të rigjenerohen përmes ri-pyllëzimit. Përveç rolit mjedisor dhe zhvillimit të biodiversitetit, mbrojtja dhe rehabilitimi i pyjeve do të ketë ndikim pozitiv edhe në shmangien e erozioneve. Pyllëzimi do të bëhet përmes mbjelljeve të bimëve apo farës.

Masa të veçanta mbrojtëse do të aplikohen edhe për mbrojtjen e biodiversitetit dhe peizazhit. Bimësia e rrallë ruhet me kujdes duke i përfshirë edhe ato të cilat identifikohen në vazhdim (fruta pylli dhe shumë tjera duke i përfshirë edhe ato shëruese).

Trungjet e identifikuar për mbrojtje do të futen në listën formale të IMN-së dhe do të mbrohen përmes ekspertizës profesionale, duke i digjitalizuar, monitoruar gjendjen e tyre dhe intervenuar

sipas karakterit të mbrojtur (rëndësi shkencore, mjedisore, kulturore, historike, peizazhi, etj.). Gjatë intervenimeve përmes projekteve zhvillimore duhet te ruhet me kujdes biodiversiteti.

Mbrojtja nga erozioni dhe rehabilitimi i sipërfaqeve erozive - Bazuar në udhëzimin administrativ për normat teknike të planifikimit MMPH Nr.08/2017 (shtojcë kapitulli II neni 1 paragrafi 1.2.1) në zonat erozive të identifikuar në hartën e erozionit, do të ndalohet prerja e pyjeve dhe lërimi i tokës si dhe do të merren masa mbrojtje përmes mbjelljes së vegjetacion si masë natyrore për parandalimin e erozionit të mëtejshëm. Komuna do bashkëpunojë me Agjencinë e Pyetjeve dhe Komunitetin që të marrin fidane dhe të pyllëzojnë hapësirat erozive. Komuna në bashkëpunim me shoqata mjedisore do të bëjë fushata vetëdijesimi për rëndësinë e ruajtjes së bimësisë si masë parandaluese.

Mbrojtja e trashëgimisë natyrore – tërësia dhe elementet e trashëgimisë së pasur natyrore janë elemente të integruara ngushtë me rrjetin e gjelbër dhe veçoritë rurale përmes cilave ruhet dhe zhvillohet identiteti lokal por edhe ndikon seriozisht në zhvillimin e gjithmbarshëm të Komunës posaçërisht në sferën e turizmit.

Bazuar në udhëzimin administrativ për normat teknike të planifikimit MMPH Nr.08/2017 (shtojcë kapitulli II, neni 5) do të mbrohen zonat natyrore me vlera të mbrojtura të natyrës (zonat turistike të identifikuar nga PZHK dhe zonat tjera të caktuara). Sipas karakterit të mbrojtjes kushteve për nën-zona brenda tyre, aty do të ndalohen dhe kufizohen aktivitetet: ndërtimi i ndërtesave të infrastrukturës, ndërtimi i ndërtesave të reja transite, komunale, energjetike, të telekomunikacionit dhe rrugëve, mihja ose mbulimi i terrenit, mihja dhe nxjerrja e gurëve, mineraleve, shtresimeve ose fosileve, deponimi i mbeturinave dhe lëshimi i ujërave të ndotura, ndryshimi i regjimit të ujërave, përdorimi i të mirave të natyrës për qëllime ekonomike, kryerja e veprimtarive përmirësuese, mënjanimi i mureve të gjalla dhe përbërësve tjerë të natyrës, mbjellja e monokulturave, grumbullimi i kërpudhave, bimëve dhe pjesëve të tyre, shqetësimi, vrasja ose kapja e shtazëve, gjuetia, peshkimi, veprimtaritë rekreative- sportive, vendosja e reklamave dhe shenjave të tjera, aktivitete të tjera të cilat mund të rrezikojnë vlerën e mbrojtur të natyrës. Përfshirë bëjnë zonat turistike të shpallura nga Komuna në të cilat mund të lejohen zhvillimet turistike brenda nën-zonave të caktuara (zhvillim i infrastrukturës, objekte sportive/ rekreuese, të vogla tregtare dhe hoteliere-shërbyese).

Mbrojtja e trashëgimisë kulturore - Në zonat dhe sipërfaqet e mbrojtura të trashëgimisë kulturore në Han të Elezit të cilat janë në listën e MKRS dhe të përcaktuara nga Komuna do të mbrohen dhe zhvillimet përreth tyre do të kufizohen në bazuar në udhëzimin administrativ për normat teknike të planifikimit MMPH Nr.08/2017 (shtojcë kapitulli II neni 6). Në këto zona do të ndalohen aktivitetet: ndërtimi i ndërtesave më të larta dhe atyre që nuk janë në harmoni me ndërtesat ekzistuese fqinje; ndërtimi i auto-udhëve, rrugëve nacionale dhe rajonale, zhvillimi i veprimtarisë së industrisë së rëndë, instalimi mbitokësor i furnizimit të rrymës elektrike, telekomunikacionit, përçuesve digjital.




Fig. 12 Harta - Plani i mbrojtjes së trashëgimisë kulturore dhe natyrore

4.4.2. Mbrojtja nga Rreziqet Natyrore dhe Rreziqet tjera

Mbrojtja e mjedisit dhe përgatitja për tu përballur me fatkeqësitë është me rëndësi jetike. Shumë faktorë duhet të merren parasysh në faza të hershme gjatë planifikimit në mënyrë që ndikimi në mjedis dhe demet nga fatkeqësitë të jenë sa më minimale.

Komuna e Hanit të Elezit ndodhët në një terren të thyeshëm malor ndërsa qyteza gjendet në një luginë të zgjeruar ku bashkohen disa përrenj. Masat për parandalimin e fatkeqësive dhe menaxhimin e tyre janë paraparë duke pasur parasysh udhëzimin administrativ për normat teknike të planifikimit MMPH Nr.08/2017 (shtojcë kapitulli II, neni 3),

Vërshimet - zonat ndërtimore janë përcaktuar në hapësirat tokësore të cilat nuk janë të rrezikuara nga përmbytjet. Në raste specifike kur ndërtimi (kryesisht biznese) lejohet në ato zona, janë paraparë masa mbrojtëse si: hapësirat e volumit ujëmbledhës si dhe infrastrukturë kulluese deri të rrjedhat ujore.

Masat e përgjithshme të mbrojtjes nga vërshimet përfshijnë rregullimin natyror dhe mirëmbajtjen e shtretërve dhe përmirësimin dhe menaxhimin brezave hapësinorë përgjatë rrjedhave ujore.

Në zonën e identifikuar të vërshimeve përgjatë lumit Lepenc (Nga lagja Laçi/ Pustenic deri në kufi në jug) zhvillimi kufizohet në distancë të caktuar nga lumenjtë. Për këtë rast dhe rrjedhat tjera lumore që kalojnë përgjatë vendbanimeve do të ndërmerren masa për rregullimin e shtratit ujor duke ruajtur vlerat natyrore dhe biodiversitetin. Para ndërmarrjes së masave nevojitet që të bëhen vlerësimet hidrologjike dhe vlerësime të biodiversitetit me qëllim të ruajtjes së bimësisë dhe drunjëve. Rekomandohet që të iket nga praktikatat e betonimit të shtretatit të lumenjve apo përrenjve.

Bizneset tregtare dhe shërbyese do të mbështeten edhe në korridoret rrugore që lidhin këto nyje sipas karakteristikave të lokacionit. Këto korridore paraqesin një potencial shtesë që e plotëson zhvillimin e gjithmbarshëm

Ndërmarrjet dhe biznesi do të zhvillohen edhe në terminalin doganor dhe vendbanimet tjera sipas potencialeve lokale dhe kërkesave. Veprimtaritë ekonomike që do të zhvillohen në vendbanime duhet të jenë në harmoni me karakterin e tyre, dhe që në asnjë mënyrë të mos cenojnë vlerat dhe potencialet e tyre lokale, sidomos ato bujqësore, natyrore dhe të trashëgimisë. Për më tepër, duhet të përkrahen veprimtaritë ekonomike të cilat i promovojnë vlerat lokale dhe i përfshijnë ato në zhvillimet bashkëkohore.

Me qëllim të mbështetjes së plotë të zhvillimit të ndërmarrjeve, sidomos atyre të vogla dhe të mesme (NVM), duhet të ofrohen edhe masa tjera më “të buta”. Fillimisht, është e nevojshme të bëhen studime përkatëse për profilet e ndërmarrjeve të cilat do të ishin më të suksesshme në Han të Elezit, duke i marrë parasysh potencialet lokale, si dhe mundësinë e plasimit të prodhimeve dhe shërbimeve në tregun kosovar dhe më gjerë. Po ashtu, është e nevojshme që të avancohen më tej aftësitë për punë dhe të kapaciteteve lokale njerëzore sipas nevojave të tregut, përmes organizmit të trajnimeve profesionale. Avancimi i aftësive ndërmarrëse lokale do të bëhet përmes organizmit të trajnimeve, nxitjes së bashkëpunimit në mes bizneseve, dhe krijimit të kushteve për aktivitete komplementare ndër-sektoriale komunale dhe ndër-komunale.

Turizmi – Është ky lloj zhvillimi i cili është i rëndësishëm për të komplementuar zhvillim e gjithmbarshëm komunal. Qyteza në veçanti do të strukturojë paketën mikse kulturo-natyrore dhe industriale ku natyrës ikonike të Sharrit, Karadakut dhe luginave të lumenjve iu gërshetohet historia industriale e Qytezës me pjesët e vjetra industriale dhe banimit të ndërtuar enkas dhe lokacionet e ndryshme kulturore duke përfshirë edhe ato të luftës së fundit. Natyrisht se lista e monumenteve kulturore është shumë më e gjerë me monumente dhe lokacione arkeologjike të shpërndara në tërë Komunën. Duke i pasur parasysh potencialet, mund të pritet që këto lista të zgjerohen edhe më tej në të ardhmen.

Nyje shumë e rëndësishme turistike mbetet në Sharr/ zona turistike Pustenic e cila do të jetë fokusi kryesor me natyrë të bukur dhe lokacionet me vlerë kulturo-historike. Përveç bizneseve shërbyese hoteliere dhe vilave private aty do të ofrohet rekreacion dhe lëvizje në natyrë, qëndrim dhe socializim, etj. Krejt këtij aranzhmani i shtohen edhe zonat turistike të Gorancës dhe Neçavcit (sipërfaqe me pisha), zona turistike e luginës së lumit Dimca si dhe pikat tjera turistike në Laç/ Pustenic, Krivenik dhe Dërmjak.

Vlerat unike natyrore do të plotësohen me vlerat krenare të trashëgimisë historike shumë të rëndësishme të luftës së UÇK-së. Gjithandej nëpër komunë e posaçërisht në Sharr janë Zonat, lokacionet, përmendoret dhe përkujtimoret e luftës për çlirim të grave dhe burrave të Komunës së Hanit të Elezit. Gjatë prezantimit të ofertës turistike, këto asete do të jenë vlerë shtese e tregimit Hanelezas për traditën e përpjekjes së pakufishme dhe të vazhdueshme për jetë të lirë dhe të sigurte të banorëve dhe për të mundësuar shijimin e kësaj natyre nga vizitorët.

Përmes transportit të organizuar, vizitave private dhe dhënies së informacionit, ky funksionalitet turistik organizohet nga Qyteza dhe pikës informuese në Pustenic. Shpërndarja dhe qasja në informacion digjital është pjesë e domosdoshme e këtij funksionaliteti.

Për zhvillimin e turizmit do të nevojiten një varg masash shtesë, të cilat duhet të mundësojnë shfrytëzimin e potencialeve lokale por pa i cenuar vlerat e tyre. Këtu fillimisht bëjnë pjesë studimet e nevojshme për profilet e mundshme të turizmit në Han të Elezit dhe vizitorët potencial, të pasuara me aktivitete për promovimin e vlerave lokale. Po ashtu, është e nevojshme që të ngritën kapacitetet profesionale për ofrimin e shërbimeve turistike, duke u bazuar në përvojat e mira ndërkombëtare për turizëm të qëndrueshëm. Ndërkaq, infrastruktura fizike që do ti mbështesë

aktivitetet turistike duhet të zhvillohet me kujdes dhe në harmoni me vlerat natyrore dhe kulturore, duke shmangur çfarëdo cenimi të tyre.

Sipërfaqet turistike në Pustenic dhe Neçavc do të definoohen më tej me HZK ku përmes nënzonimit do të përcaktohen nënzonat ku lejohen zhvillimet banuese/ rekreative (vila) apo hotelieri shërbyese, tregtare, etj. Në të gjitha sipërfaqet tjera rekreative turistike dhe jashtë atyre nënzoneve te tri të lartpërmendurat, nuk do të lejohet kurrfarë zhvillimi që do të dëmtonte vlerat natyrore të atyre sipërfaqeve.

Bujqësia - Sipërfaqet bujqësore kanë shtrirje të përhapur brenda territorit komunal me ato kualitative përgjatë Luginës së Lepencit në pjesën më jugore të tij, si dhe ato më pak kualitative në pjesët kodrinore. Bazuar në cilësinë e tyre dhe impaktit që në to kanë zhvillimet tjera hapësinore, janë të rëndësishme masat që duhet të ndërmerren me qëllim të mbrojtjes në njërin anë, si dhe rritjes së nivelit të shfrytëzimit, vlerës dhe prodhimit në anën tjetër. Në lidhje me mbrojtjen, është e domosdoshme që toka bujqësore si aset zhvillimor të mbrohet nga ndërtimet joformale dhe shpërhapjet zhvillimore të paplanifikuara. Kjo arrihet përmes respektimit të kufijve të zonave të ndërtimit. Po ashtu është e nevojshme të sigurohet mbrojtja nga format e ndryshme të ndotjes, vërshimeve dhe fatkeqësive (kjo komponentë do të prezantohet me thellësisht në 5.1).

Pas një studimi të fushës, planifikohet konsolidimi i tokave bujqësore në:

- rrafshnaltën e Krivenikut e cila është e përshtatshme për lavërtari (kryesisht me kulturën e grurit). Konsolidimi mundë të arrijë edhe mbi 200 ha ndërsa aty nuk parashihet ujitje;
- tokat kualitative bujqësore përgjatë pjesës jugore të lumit Lepenc (mën urën e Seçishtes). Këto sipërfaqe bujqësore do të kenë trajtim të veçantë. Aplikimi i masave të veçanta agroteknike në këto lokacione duke përfshirë plehrat kimike dhe substancat tjera, do të jenë të kufizuara për shkak të pranisë së lumit. Konsolidimi i këtyre tokave bujqësore përgjatë lumit është gjithashtu i planifikuar në favor të kultivimit të kulturave të përshtatshme (kryesisht misër dhe perime në serra) si rezultat i mundësisë për ujitje nga kanalet ekzistuese dhe të planifikuara. Ujitja bëhet drejtpërdrejtë nga lumi Lepenc.

Sa i përket përmirësimit të kushteve të qasjes në toka bujqësore më lart, parashihet ngritja e cilësisë së rrugëve rurale në nivel të arsyeshëm për këtë rang të rrugëve (p.sh. shtrimi me zhavorr).

Fshatrat e Hanit të Elezit përbëjnë rrjetin bartës të zhvillimit rural. Brenda tyre, terrenet e rrafshëta apo luginore do të jenë bartëse të zhvillimit të veprimtarive bujqësore individuale duke i pasur parasysh potencialet që i ofron toka në të cilat ato shtrihen. Fshatrat e terreneve kodrinore të komunës do të jenë kryesisht bartëse të zhvillimit të blegtorisë, duke iu përshtatur kushteve dhe terrenit. Në përgjithësi, sipas potencialeve të tokës bujqësore nëpër fshatra dhe interesit individual të bujqve, do të promovohet edhe pemëtaria si dhe kultivimi i frutave të pyllit (dredhëza, mjedra, aronia, boronica e të ngjashme). Është me rëndësi që në zhvillimin hapësinor të fshatrave të ruhet potencialet që i ofron struktura hapësinore e tyre për zhvillimin e jetës së shëndoshë dhe veprimtarive ekonomike rurale.

Me qëllim të ofrimit të një spektri të plotë të masave përkrahëse për zhvillimin e bujqësisë, grantet dhe subvencionet targetohen specifikisht në tokat bujqësore të konsoliduara (për grurë, misër dhe perime në serra apo të jashtme) dhe në tokat tjera bujqësore në rastet e pemishteve dhe frutave të pyllit. Përveç mbrojtjes së tokës, mbështetjes nga aspekti hapësinor dhe fizik me infrastrukturë përkatëse dhe subvencionet/ grantet, ofrohen edhe masa tjera më "të buta". Mbështetja e vazhdueshme në ngritjen e njohurive dhe kapaciteteve profesionale, sidomos për qasjet bashkëkohore në bujqësi, si dhe avancimi i teknikave të aplikuara bujqësore, janë kushte të domosdoshme që potencialet bujqësore të shfrytëzohen në shkallë sa më të lartë dhe në mënyrë të qëndrueshme. Identifikimi i llojeve të prodhimeve që ofrojnë cilësi në territorin e Hanit të Elezit, si dhe krijimi i rrjetit të furnizimit/plasimit, janë të domosdoshme për kthimin e bujqësisë në gjenerues të punësimit dhe zhvillimit.

Zhvillimi eventual kapaciteteve përpunuese bujqësore mbetet në varshmëri nga kapacitetet dhe cilësia e prodhimit bujqësor, e sidomos nga nevojat e tregut ku mund të plasohen prodhimet e përpunuara. Komuna do të bëjë përpjekje për të bërë një analizë për sigurimin e tregut për shitjen e prodhimeve bujqësore (bashkëpunim edhe me komuna fqinje).

Duke u bazuar në udhëzimin administrativ për normat teknike të planifikimit MMPH Nr.08/2017 (shtojcë kapitulli II, neni 1 paragrafi 1.2.2), tokat bujqësore mbrohen nga fragmentimi duke marrë masat kundër fragmentimit. Pra toka e punueshme bujqësore e konsoliduar, sipërfaqja e së cilës është ≤ 1.00 ha, nuk mund të fragmentohet në parcela. Kjo masë mbrojtjeje duhet të respektohet në dokumentet e planifikimit hapësinor. Për më shumë, toka e punueshme bujqësore, sipërfaqja e së cilës është ≤ 0.50 ha, të mos mund të fragmentohet tutje.

Pylltaria - Sipërfaqet e bollshme pyjore të Hanit të Elezit kryesisht në Malet e Karadakut por edhe të Sharrit do të mbrohen nga prerja dhe degradimi. Kjo do të arrihet në bashkëpunim me të gjithë akterët e përfshirë publik, privat dhe të shoqërisë civile. Planifikohen projekte voluminozë të pyllëzimit sipas karakteristikave të lokacionit. Rëndësi të veçantë do ti kushtohet mbrojtjes dhe rivitalizimit të sipërfaqeve pyjore të identifikuar si të mbrojtura në kuadër të zonave turistike.

Sipërfaqe tjera pyjore të identifikuar (publike dhe private) ku nuk dëmtohet peizazhi natyror apo urban si i domosdoshëm për standard optimal jetësor dhe si aset për zhvillim të turizmit, do planifikohet për zhvillim të pylltarisë. Pjesë të caktuara në Karadak dhe Sharr të jepen në shfrytëzim për pylltari komerciale (partneritet publiko-privat apo modalitet tjetër) për të prodhuar lëndë druri për industri, ndërtimtari apo biomasë. Përderisa në Sharr do të lejohet vetëm kultivimi i drurit lokal (ahu, bungu, pisha, etj), me kujdes të veçantë në Karadak do të lejohet edhe prezantimi i drunjtëve industrial jo endemik (pauloënia apo të ngjashme).

Infrastruktura teknike

Infrastruktura teknike përfshinë shtrirjen e rrugëve publike, ndërtesave, instalimeve nëntokësore dhe mbitokësore për furnizimin e energjisë elektrike dhe termike, rrjetit të ujësjellësit dhe kanalizimit, telekomunikacionit dhe instalimeve të tjera të ngjashme. Kapacitetet e këtyre sistemeve dhe cilësia e shërbimit do të përmbushin nevojat e banimit, si dhe do ta mbështesin zhvillimin ekonomik

Uji i pijes – Me qëllim të ofrimit të shërbimit optimal për të gjithë banorët e komunës, do të merren hapat në vijim:

- Rrjeti i përbashkët i Qytezës, Seçishtes dhe vendbanimeve përreth do të përmirësohet dhe shtohet duke përfshirë të gjitha amvisëritë dhe bizneset (pjesën e mbetur të Seçishtes dhe pjesë të vendbanimeve përreth). Duke qenë se për 8 vitet e ardhshme këtu do të akomodohen shumica e banorëve shtesë të Komunës, diasporës dhe vizitorëve turistik, do të planifikohet përkitazi për sasi të shtuar të ujit deri në 6l/ sekondë.
- Njëjtë do të vepohet me fshatin Gorancë. Ky sistem do të futet në menaxhim formal të KRU Bifurkacioni, Njësia në Han të Elezit.
- Për fshatin Paldenicë komuna do të bëjë projektin dhe do të ndërtojë sistemin e përbashkët të ujësjellësit i cili do të menaxhohet nga KRU respektive.
- Për fshatrat Dimcë, Krivenik, Dremjak, Neçavc dhe Vërtomicë do të bëhen hulumtime dhe analiza për modalitetin më të përshtatshëm për ofrimin e shërbimit.
- Për nevoja turistike planifikohet të rregullohen burime të ujit të pijes në lokacione të caktuara.

Për të arritur këtë qëllim të shërbimit të banorëve lokal por edhe veprimtarive ekonomike sipas konceptit zhvillimor, do të bëhen studime dhe hulumtime për kapacitete të shtesë të burimeve ujore. Paralelisht me burime të reja ujore, menaxhimi i shërbimit do të avancohet me ofrim permanent të ujit kualitativ sipas standardeve në fuqi dhe e fundit jo për nga rëndësia, planifikohet menaxhim më i mirë i komplet sistemit për të ulur ndjeshëm humbjet komerciale dhe teknike të ujit në më pak se 20% nga mbi 50% sa është tani. Racionalizimi i kapaciteteve njerëzore dhe financiare në raport me të hyrat si dhe aplikimi i gjobave do të jetë i domosdoshëm duke pasur në konsideratë kufizimet me ujë që mundë të ndodhin nga sasia e çrregulluar e reshjeve atmosferike të ndikuara potencialisht nga ndryshimet klimatike.

Ujërat e zeza – Duke marrë parasysh se shërbimi ofrohet në tërë komunën (100%), planifikohen përmirësime të nevojshme dhe rritje të kapacitetit paralelisht me kërkesat zhvillimore të planifikuara, dhe ndarjen e ujërave atmosferik nga ujërat e zeza në pika të caktuara.

Kolektorit ekzistues në lindje të lumit Lepenc i cili përmbledh të gjitha vendbanimet dhe lagjet e asaj ane do ti shtohet edhe kolektori i planifikuar perëndimor që nga Laçi/ Pustenic e deri në pikën më jugore të Komunës (afër kufirit me RMV) ku është planifikuar të ndërtohet impianti për trajtimin e ujërave të zeza. Me kompletimin e sistemit të shkarkimit të ujërave të zeza do të ndalohet njëri nga burimet e ndotjes së mjedisit.

Komuna e Hanit të Elezit do të bashkëpunojë ngushtë me Komunitat Ferizaj dhe Kaçanik duke përfshirë edhe presionin e duhur së bashku me OSHC-të në mënyrë që të shpejtohet realizimi i projekteve të impianteve të tyre që do të sillte ndikim vendimtar në mjedis (lumin Lepenc).




Fig. 17 Harta - Plani i ujitjes dhe drenazhimit

Mbeturinat - Për planifikimin e menaxhimit të mbeturinave është marrë për bazë udhëzimi administrativ MMPH Nr. 08/2017 mbi normat teknike të planifikimit kapitulli 17. Kompania publike lokale "Pastrimi" tashmë mbulon tërë territorin komunal me shërbim (100%). Deponimi i mbeturinave mbetet si synim tek ajo e rajonit të Gjilanit (Velekincë).

Për të ulur sasinë e mbeturinave të deponuar planifikohet inicimi i ndarjes së mbeturinave. Komuna e Hanit të Elezit dhe Kompania "Pastrimi" janë mbështetur vazhdimisht nga GIZ. OJQ Gjethi e cila operon në rajonin e Ferizajt, tashmë ka bërë një sërë studimesh e analizash në këtë kontekst. Synohet prezantimi i ndarjeve të mbeturinave në burim. Për të arritur këtë synim planifikohen subvencione dhe incentiva të ndryshme për kohë të caktuar në njërën anë si dhe aplikim strikt të gjobave dhe prezantim të pagesës për volum të mbeturinave të gjeneruara në anën tjetër. Fillimisht do të synohet ndarja e plastikës, metalit, letrës dhe mbeturinave organike. Përderisa për 3 të parat tashmë ekzistojnë reciklues të tyre ku REX-i Kaçanikas është i njohur në këtë mes për plastikë, mbeturinat organike tashmë kanë filluar të riciklohen përmes komposterëve individual. Komposterët e mbeturinave organike planifikohet të shtohet në fshatra ndërsa Komuna do të bëjë studime për mundësinë e subvencionimit të një recikluesi të madh për mbeturinat organike. Modalitetet mund të jenë të ndryshme që nga ndërmarrje private apo publike apo publiko/private.

Këto masa do të lehtësonin situatën në terren në lidhje me krijimin e deponive joformale të mbeturinave. Rrjedhimisht, paralelisht me hapat e lartpërmendura do të ndërmerreshin aktivitetet e domosdoshme për eliminimin e të gjitha deponive joformale dhe parandalimi i krijimit periodik të tyre.

Analiza dhe studime do të bëhen që të mundësohet përcaktimi i deponisë së të mbeturinave inerte. Kjo do të arrihet bazuar në kushtet për përzgjedhjen e lokacionit sipas udhëzimi administrativ MMPH

Nr. 08/2017 mbi normat teknike të planifikimit (shtojcë kapitulli IV neni 17). Për më tepër, në bashkëpunim me gurëthyesit do të mundësohet ndarja dhe riciklimi i pjesëshëm i këtyre mbeturinave duke përfshirë betonin dhe armaturën.




Fig. 18 Harta - Plani i menaxhimit të mbeturinave

Energjia - Me përmirësimin e kapaciteteve të rrjetit shpërndarës i planifikuar në të gjitha vendbanimet do të mundësohet furnizim cilësor me energji elektrike. Kapacitetet e përmirësuara duhet të parashihen edhe për nevojat zhvillimore, ku përveç nevojave për banim dhe sektorë të ndërlidhur me banimin, do të të parashihen edhe nevojat për zhvillimin e aktiviteteve ekonomike nga KEDS dhe palët zhvilluese.

Me qëllim të mbështetjes së një furnizimi cilësor me energji dhe shfrytëzimit racional të saj, parashihen masat për rritjen e efijencës energjetike. Në kuadër të ndërtesave dhe hapësirave publike, rritja e efijencës bëhet përmes aplikimit të masave konkrete teknike (struktura izoluese ndërtimore, pajisje eficiente elektrike dhe të ngrohjes si dhe pajisje solare për gjenerim të energjisë). Ndërkaq në shkallë më të gjerë, planifikohet aplikimi i masave për vetëdijësimin dhe informimin e qytetarëve për rëndësinë dhe përfitimet nga efijencia e energjisë dhe gjenerimi i saj sidomos në objektet e banimit, si dhe burimet aktuale të subvencionimit nga qeveria dhe donatorët brenda këtij konteksti. Mbështetja e qytetarëve rreth aplikimit për këto subvencione është gjithashtu e përfshirë.

Sa i përket prodhimit të energjisë elektrike, në të 2 rastet e caktuara të hidrocentraleve të vogla planifikohet që ato të mos ndërtohen. Për shkak të mos fillimit të punëve në të dy rastet ("Lepenci 1" dhe "Lumi i Kotlinës"), lejet ndërtimore, pëlqimet mjedisore/ ujore dhe autorizimet respektive nga ZRRE kanë skaduar dhe Komuna duhet të sigurohet që ato të mos vazhdohen.

Arsyja tjetër qëndron në faktin se të gjitha rastet kur hidrocentralet në Kosovë janë përfunduar (duke përfshirë edhe komunën fqinje të Kaçanikut), OSHC-të kanë paditur MMPHI-në dhe Gjykata

Supreme ka shtyrë ekzekutimin e lejes së integruar mjedisore dhe ujore të tyre deri në një vendim përfundimtar të Gjykatës në lidhje me mos aplikimin e koncesionit, degradimet mjedisore dhe mos konsultimin e publikut (OJQ Gjethi dhe OJQ GLPS). Ngjashëm ishin ndjekur procedurat edhe për hidrocentralet e parapara në Han të Elezit dhe potencialisht mundë të jenë bërë të njëjtat shkelje.

Për shkak të resurseve të kufizuara ujore dhe prioriteteve tjera në shfrytëzim të tij (konsum social dhe ekonomik/ bujqësor), Komuna dhe qeveria qendrore nuk do të lejojnë hidrocentrale tjera të vogla në territorin e Komunës. Hidrocentrale mikro dhe piko mundë të lejohen për ndonjë atraksion turistik apo nevoja bjeshkatore, por edhe në ato raste nuk do të lejohet devijimi i ujit nga rrjedha natyrore e tij.

U theksua më lart se do të promovohet gjenerimi i energjisë elektrike nga burimi i diellit përmes instalimit të paneleve fotvoltaike në ndërtesa (publike dhe private) duke përfshirë edhe panelet e veçanta për ngrohje të ujit. Për më tepër planifikohen studime rreth mundësive dhe lokacioneve të përshtatshme për ferma solare. Me këtë rast vetëm rrafshnaltat me shkurre të Sharrit (vendi i quajtur Zheden ngjitur kufirit me Maqedoninë) dhe Karadakut (mbi mihjen sipërfaqësore të Sharrcem dhe hapësira tjera të identifikuar) në vende të caktuara mundë të kualifikoheshin si hapësira të përshtatshme gjithmonë duke u siguruar mos dëmtimi i pyjeve dhe peizazhit natyror që mundë ta rrezikonte natyrën dhe zhvillimin turistik.

Duke i marrë parasysh parakushtet e zhvillimit të gjithmbarshëm ekonomik, njëjtë planifikohet edhe me kërkesat për gjenerim të energjisë elektrike nga era. Studimet e veçanta do të mundë të identifikonin lokacione në Komunën e Hanit të Elezit por PZHK me këtë rast do të lejonte instalimin e tyre vetëm në lokacionet e mëposhtme nëse ato do të kualifikoheshin si të përshtatshme:

- Pjesa e Karadakut ku lidhet me kufirin me Maqedoninë dhe Komunën e Kaçanikut (Gjurgjedell);
- malet e Sharrit duke filluar nga Gorancë në kufi me Komunën e Kaçanikut dhe vazhduar përgjatë kufirit me Maqedoninë.

Për përzgjedhjen e lokacionit për vendosjen e infrastrukturës energjetike (gjenerim dhe transfer) duhet bazuar në udhëzimin administrativ MMPH Nr. 08/2017 mbi normat teknike të planifikimit (shtojcë kapitulli IV neni 16) ku përcaktohet kushtet për distancën e vendosjes së tyre nga pjesët e ndërtuara të vendbanimeve, vija ndërtimore apo ndërtesave.




Fig. 21 Harta - Plani i infrastrukturës së transportit

Rrugët e nivelit kombëtar - Në kuadër të këtyre rrugëve janë autoudha R6 (Prishtinë-Hani i Elezit), rruga nacionale N2 (Prishtinë-Shkup) përmes të cilave Komuna e Hanit të Elezit ka qasje dhe lidhje të gjithanshme me shtetet fqinje, rajonet dhe komunat fqinje, pika të rëndësishme transporti (pika kufitare në Gllaboçicë dhe aeroportet e Prishtinës dhe Shkupit) dhe vende tjera strategjike.

Si masa për përmirësimin e gjendjes në këtë nivel janë ato që kanë të bëjnë me përmirësimin e qarkullimit jomotorik dhe përmirësimin e sigurisë së qarkullimit. Po ashtu, do të aplikohen masa për menaxhimin e shpejtësisë së qarkullimit motorik (shirit gjelbërimi të lartës apo pengesa tjera) me qëllim të uljes së rrezikut në trafik.

Rrugët e nivelit lokal - Pasi që tashmë janë rregulluar/shtruar shumica e rrugëve lokale, planifikohet të bëhet konsolidimi i atij rrjeti si dhe rrjetit rrugor nëpër vendbanime (zonë urbane dhe rurale) me qëllim të krijimit të rrjeteve funksionale të qarkullimit. Rruga alternative që lidh Qytezën me fshatrat perëndimore është prioritet për Komunën për të funksionalizuar lëvizjen e domosdoshme e cila potencialisht bllokohet nga fluksi te pikë kalimi kufitar. Rrugët lokale Gorancë – Gllaboçicë (kaçanik) dhe Gorancë - Krivenik janë gjithashtu të rëndësishme në kuadër të kornizës zhvillimore të propozuar duke ndërlidhur zonën turistike të Gorancës me pjesën tjetër të Komunës dhe Kosovës.

Masat për krijimin e kushteve për qarkullim të sigurt të këmbësorëve do të ndërmerren nëpër lagjet e vendbanimeve ku mungojnë (këtu përfshihen trotuare dhe/ apo shtigje për këmbësorë dhe çiklistë). Për të ofruar siguri të plotë të qarkullimit në trafik, do të ndërmerren masa si aplikimi i brezit të gjelbër i cili ndikon në uljen e shpejtësisë së qarkullimit motorik, krijimin e brezave mbrojtës dhe të gjitha hapave tjera sipas udhëzimit administrativ të lartpërmendur.

Hekurudha – Rregullimi dhe mirëmbajtja e kësaj infrastrukture dhe transportit mbetet kompetencë e Hekurudhave të Kosovës dhe Departamentit/ Ministrisë së linjës. Në aspektin e sigurisë së kalimeve në hekurudhë, Komuna do të bashkëpunojë me Hekurudhat e Kosovës për të zgjidhur çështjet dhe ofruar siguri optimale për banorët që lëvizin nga njëra anë në tjetrën (lëvizje motorike apo jo-motorike). Emergjencë mbetet rregullimi funksional i vendkalimeve në zonën urbane (Lagja Rana dhe Ura e Fejzës), por masa për rregullimin e vendkalimeve duhet të merren edhe te Uji i Thartë.

Shtigjet jo motorike – Jo më pak të rëndësishme se rrugët e lëvizjeve motorike, shtigjet lëvizëse për këmbësorë dhe biçikleta do të jetë funksion shumë i rëndësishme që do ta plotësojë rrjetin e gjithmbarshëm të linjave mes nyjave zhvillimore dhe definitivisht konsiderohet të jetë pjesa më atraktive e këtij mozaiku. Luginat e Lepencit dhe përrenjve të Dimcës, Laçit dhe Rezhancës do të shndërrohet në korridore të gjelbra dhe të shëndetshme për lëvizje të qytetarëve dhe vizitorëve (në këmbë dhe biçikleta). Përtej këtyre, në kontekst të lidhjeve të hapësirave të parapara për zhvillim, në bashkëpunim me OSHC-të (OJQ Gjethi si liderë në rajon), shtigjet ekzistuese për ecje/ hiking nga Hani i Elezit drejt zonave turistike në Pustenic, Gorancë, Dimcë/ Dërmjak, Vorba, Paldenicë/ Neçavc/ Vërtomicë dhe nga Laçi në Pustenic/ Gorancë do të rregullohen dhe do të mirëmbahen vazhdueshëm. Për më shumë, do të bëhen analiza terreni për të shtuar linjat lëvizëse drejt aseteve tjera natyrore dhe kulturore dhe drejt nyjave zhvillimore sipas konceptit të treguar më lart.

Transporti publik – Në të ardhmen Komuna do të koordinojë planin e transportit dhe përdorimit të tokës me qëllim të zvogëlimit të kërkesës për udhëtime brenda zonës urbane sidomos me makina private. Si një nga këto masa u përmend më lart simulimi i transportit jomotorik por edhe masa tjera që do të tregohen më poshtë. Cilësia e ofrimit të shërbimit, në kuptim të frekuencës, infrastrukturës përcjellëse, dhe mjeteve të transportit do të jetë e nivelit të kënaqshëm. Si shërbim i mirëfilltë, transporti publik do të ofrohet si alternativë ndaj qarkullimit me automjete individuale.

Transporti nder-komunal do të mbetet pak a shumë i ngjashëm me atë ekzistues pasi që konsiderohet se i përmbush kërkesat e qytetareve. Në këtë mes do të bëhet përpjekje për të prezantuar udhëtime të drejtpërdrejta një herë në ditë Han i Elezit-Prishtinë dhe anasjelltas, si dhe Han të Elezit-Ferizaj të dielave.

Transporti lokal mbulon zonën urbane përmes linjave transportuese lokale duke marrë parasysh se zona urbane është e vogël. Përtej linjave ekzistuese të transportit lokal të cilat mbeten dhe përmirësohen, do të prezantohen linjat lidhëse lokale me Paldenicën. Përtej kësaj, do të shikohet mundësia e prezantimit të linjave sezonale të transportit drejt nyjave turistike (Gorancë dhe Neçavc). Në kuadër të kësaj shpërndarjeje, Komuna do të vazhdojë të funksionalizojë ven-ndalime adekuate për autobus në rrugëve në zonën urbane, rurale dhe pika të caktuara brenda nyjave turistike.

Stacionet i autobusëve dhe ai hekurudhor. Përderisa stacioni hekurudhor do të mbetet në lokacionin ekzistues ku parashihen përmirësime krahas modernizimit të hekurudhës nga organet relevante, stacioni i autobusëve do të ndërtohet në lokacionin ngjitur stacionit të zjarrfikësve. Në të dy rastet qasja deri aty për këmbësorë dhe makina është shumë e përshtatshme.




Fig. 22 Harta - Plani i transportit lokal

Vend-parkimet – Situata me vend-parkime në Komunën e hanit të Elezit është e kënaqshme.

Për nevoja të zhvillimit të propozuar, bazuar në udhëzimi administrativ MMPH Nr. 08/2017 mbi normat teknike të planifikimit në shtojcë, kapitulli IV, neni 8 plani propozon masat në vijim:

- Të organizohen vend-parkime funksionale në hyrje të njyave zhvillimore me fokus zonat turistike por edhe në Qytezë sipas nevojës. Parkimet mundë të jenë publike apo private;
- Të organizohen vend-parkime jashtë rrugore publike apo private si pjesë përbërëse e ndërtesave publike, komerciale, qendër biznesi, etj.
- Të organizohen vend-parkime jashtë rrugore private të ndërtesave private dhe në bashkëpronësi.

Te gjitha zhvillimet e reja duhet të i përmbahen udhëzimit administrativ mbi normat teknike të planifikimit hapësinor për të siguruar hapësirë të mjaftueshme për parking sipas standardeve.

Zhvillimi social

Zhvillimi i mëtejshëm social i Hanit të Elezit, përmes ofrimit të shërbimeve përkatëse, është parakusht për ngritjen e mëtejme të potencialit njerëzor dhe mundësimin të një jete cilësore. Si pjesë e këtij zhvillimi parashihen masa brenda sektorëve të arsimit, shëndetësisë, kulturës, sportit dhe shërbimeve tjera publike, që ofrohen për banorët dhe vizitorët.

Arsimi - Bazuar në udhëzimin administrativ MMPH Nr. 08/2017, shtojcë, kapitulli IV neni 3 shikuar përgjithësisht, infrastruktura e institucioneve dhe shtrirja e rrjetit të ndërtesave shkollore të nivelit fillor dhe të mesëm në Han të Elezit konsiderohet e kënaqshme. Hierarkia e institucioneve shkollore përputhet edhe me heirarkinë dhe organizimin e vendbanimeve.

Përtej çerdhes ekzistuese, paralelisht me zhvillimet e planifikuara, do të shqyrtohen mundësi që të plotësohen nevojat shtesë me çerdhe shtesë publike apo private.

Në nivel të shkollimit fillor/ të mesëm të ulët parashihet shtimi i hapësirave mësimore në 2 lokacione:

- Në Lagjen e Re do të ndërtohet një shkollë e re fillore (klasat 1-5);
- Në Han të Elezit në lokacionin aktual të shkollës parashihen kapacitete të reja për shkollim të mesëm të ulët (klasat 6-9). Përderisa hapësirat aktuale mjaftojnë për shkollimin fillor për nxënësit e Komunës nga Qyteza me vendbanimet përreth, Dimca, Kriveniku dhe Pusteniku; për të arritur kualitetin e dëshiruar të shkollimit të mesëm të ulët (këtu shtohen edhe nxënësit nga Seçishta dhe Lagja e Re) dhe synimin për mësim tërë-ditor, Komuna planifikon shtimin e hapësirave shkollore. Komuna tashmë siguron transportin e nxënësve nga këto vendbanime.

SHFMU-të në Paldenicë dhe Gorancë mbesin të tilla.

Shkolla e Mesme e Lartë mbetet funksionale ndërsa prioritet mbetet ndërtimi i palestrës. Sa i përket arsimit të mesëm profesional, ai do të avancohet më tej si platformë e zhvillimit social dhe rrjedhimisht edhe atij ekonomik. Në këtë mes do të bëhen studime të nevojshme për të plotësuar nevojat e suplementimit të zhvillimit të planifikuar si industri, tregti, bujqësi dhe shërbyes (hotelieri/ turizëm). Analizat për drejtimet e duhura do të bëhen bashkë me Komunën e Kaçanikut dhe Ferizajt për shkak të afërsisë dhe hapësirës më të gjerë zhvillimore.

Të gjitha shkollat do të furnizohen vazhdimisht me pajisjet e duhura me fokus laboratorët e nevojshëm. Kujdes i veçantë do ti kushtohet qasjes së lehtë dhe të sigurve të nxënësve në të gjitha objektet shkollore, ku intervenim urgjent nevojitet në rastin e shkollës në Han të Elezit.

Shëndetësia – Ofrimi i shërbimeve shëndetësore për banorët dhe vizitorët e planifikuar do të bëhet përmes rrjetit aktual të institucioneve (QKMF në qendrën komunale dhe AMF-së në Gorancë) dhe infrastrukturës së planifikuar (objekti i ri QMF-së në Paldenicë).

Në kuadër të zhvillimit të planifikuar, përmes QKMF-së planifikohet ofrimi i shërbimeve kryesore shëndetësore në Komunës. QKMF do të mbajë shërbimet ekzistuese duke përfshirë edhe pediatriinë, ndërsa 2 AMF-të do të kenë së paku shërbimin e infermierisë (8-orësh). Përtej kësaj Komuna do të bëjë përpjekje që edhe AMF-të të ofrojnë shërbime të rregullta shëndetësore të mjekësisë familjare.

Me qëllim të sigurimit të vazhdimësisë së shërbimeve cilësore, institucionet shëndetësore do të përkrahen përmes sigurimit të pajisjeve dhe materialeve të nevojshme shëndetësore. Të 3 qendrat shëndetësore do të pajisen me pajisje mjekësore varësisht nga nevoja dhe shërbimet që duhet të kryejnë.

Kultura – Qendra e re kulturore plotëson të gjitha nevojat dhe planifikohet të shërbejë të gjithë banorët e Komunës. Për më shumë, zhvillimi i kulturës në Han të Elezit do të bëhet edhe përmes rrjetit ekzistues të ndërtesave shkollore të cilat do të jenë edhe në shërbim të komunitetit në periodat kohore kur nuk pengohet procesi mësimor.

Biblioteka e Qytzës do të përmirësohet, me synim futjen e sistemit digjital i cili do të përdoret për tituj, lexim dhe mirëmbajtje/ shtim të fondit. Kjo bibliotekë do të mbështesë me tituj esenciale SHFMU-të në Paldenicë dhe Gorancë.

Komuna do të bëjë analizat dhe hapat e duhur për themelimin e Muzeut kulturo/etnografik për të cilin do të planifikojë edhe objektin në kohën e duhur. Hapësira të caktuara brenda Qendrës Kulturore në Qytezë do të shfrytëzohen në fillim.

Për të qenë funksional parashihet mirëmbajtja e objekteve kulturore dhe furnizimi permanent me pajisje të duhura.

Komuna, në radhë të parë drejtoritë përgjegjëse për kulturë dhe arsim, me përfshirjen e shoqërisë civile dhe komunitetit, do të vazhdojnë dhe zgjerojnë më tej mbështetjen për zhvillimin e aktiviteteve dhe ngjarjeve kulturore. Përveç rolit të këtyre aktiviteteve në zhvillim të shëndoshë social, ato kanë rol edhe në njohjen dhe avancimin e identitetit lokal, si dhe promovimin e vlerave kulturore të Hanit të Elezit. Me këtë rast parashihen të subvencionohen së paku:

- 1 shfaqje teatrale në vit;
- Organizimi i përvitshëm të ngjarjeve kulturore të ditës së çlirimit dhe datave tjera të ngjashme (evente artistike, hiking i organizuar, turne sportivë, vizita të ndryshme, etj.);
- Vizita në pikat turistike për nevoja të banorëve, diasporë dhe vizitorëve tjerë;
- Organizimin e turneve sportive tradicionale kombëtare dhe ndërkombëtare, etj.

Për subvencione me shuma më të mëdha do të aplikohet kushti i bashkë-financimit ku fituesit e mundshëm duhet ta kenë edhe një bashkë financues shtesë për aktivitetet e propozuara.




Fig. 23 Harta - Plani i zhvillimit publik dhe social

Sporti – Stadiumi, palestra private për futboll si dhe rrjeti i përhapur palestrave të institucioneve shkollore (3 gjithsej), ofrojnë një strukturë të mirë për zgjerimin e mëtejshëm të rrjetit të hapësirave të sportit në komunë. Në këtë kontekst, përfundimi i projektit të stadiumit. Sa i përket fushave të jashtme sportive, ato aktuale (1 në Qytezë dhe 6 tjera në shkollat e komunës) janë vlerësuar të jenë

shfrytëzimit dhe aktivitetet e përdoruesve. Kjo do të arrihet edhe me përfshirjen e një gamë të objekteve rekreative dhe kulturore që pasqyrojnë shumëllojshmërinë e rekreative dhe ndjekjet kulturore dhe interesat në Han të Elezit.

Këto hapësira në të gjitha vendbanimet do të lidhen përmes një sistemi të vazhdueshëm të shtigjeve me zonat natyrore përreth që janë me bollëk në Han të Elezit.

Bazuar në udhëzimin administrativ mbi normat teknike për planifikim MMPH nr 08/2017 (shtojcë kapitulli IV neni 9), normat minimale për sipërfaqen e parcelës së hapësirave të gjelbra janë si në vijim:

- Parqet publike në kuadër të lagjes: 1.00 m²/banor;
- Parqet publike në kuadër të vendbanimit: 2.00 m²/banor;
- Brezat e gjelbër përgjatë rrugëve: 1.00 m²/banor;
- Brezat e gjelbër përgjatë rrjedhave ujore: 2.00 m²/banor.

Shtigjet duhet të projektohen dhe ndërtohen në përputhje me standardet dhe normat teknike, gjithnjë duke pasur në konsideratë gjithëpërfshirjen, qasjen për të gjithë dhe duke ruajtur vlerat natyrore të zonës, lagjes apo ekosistemit lumor. Ndër tjerash planifikohen rregullimi i korridoreve të gjelbra përgjatë lumit Lepenc dhe përrrenjve Dimca, Rezhanca dhe Laçi dhe përgjatë pikave tjera natyrore të cilat do të ketë përmbajtje të ndryshme (shtigje për ecje, biçikleta, kënde lojërash, pajisje për fitnes të hapur, hapësira sportive rekreative, hapësira për t'u ulur, etj.;

Sheshi i Qytezës do të përmirësohet dhe mirëmbahet. Përtej hapësirës publike të rregulluar në qendër të Gorancës, edhe në Seçishtë dhe Paldenicë planifikuar krijimi i hapësirave publike me funksione të ndryshme për të gjitha grupmoshat. Në vendbanimet tjera rurale do të ruhen hapësirat e lira publike dhe shikohet mundësia e intervenimeve të vogla për ti përmirësuar ato. Të gjitha hapësirat e rregulluara do të mirëmbahen vazhdueshëm.

Parku i madh i Qytezës është planifikuar gjithashtu për përmirësim. Me këtë është paraparë rregullimi i qasjes jo motorike dhe ofrimi i kushteve më të mira për vizitorët duke krijuar më shumë shtigje, hapësira socializimi dhe hapësira rekreative sportive.

Sipërfaqet e reja në zonën urbane që planifikohen të zhvillohen duhet të kenë hapësira të mjaftueshme për hapësira publike me qasje për të gjithë banorëve. Do të synohet që çdo banor të ketë qasje në hapësira publike në largësi jo më shumë se 500 metra apo 15 minuta ecje në këmbë. Gjithashtu rekomandohet lidhja e hapësirave publike, parqeve, korridoreve të gjelbra dhe hapësirave malore ndërmjet veti përmes korridoreve të gjelbra.

Hapësirat e gjelbra në pronësi të shkollave në bashkëpunim me shkollën dhe komunitetin do të rregullohen për shfrytëzim primar edhe nga komuniteti. Janë këto kryesisht kënde të vogla lojërash apo hapësira sportive, me orar të caktuar në shërbim të komunitetit.




Fig. 25 Harta - Plani i hapësirave publike dhe të gjelbra

Objektet fetare dhe varrezat - Bazuar në udhëzimin administrativ për normat teknike të planifikimit hapësinor MMPH Nr.08/2017 (shtojcë kapitulli IV neni 10), si dhe duke llogaritur hapësirat e lira në varrezat ekzistuese dhe vdekshmërinë sipas statistikave të Kosovës është konstatuar se në Hanë të Elezit ka hapësira të mjaftueshme për varreza për 8 vitet e ardhshme. Në zonat ku mungon rrethoja në bashkëpunim me komunitetin dhe institucionet fetare do të rregullohen rrethojat, si dhe do të nxitet një organizim më i mirë sa i përket menaxhimit fizik dhe elektronik të tyre (databaza, mikrolokacionet e secilit varr, mirëmbajtja dhe pastrimi i hapësirave etj.).

Edhe rrjeti ekzistues i objekteve fetare vlerësohet të jetë i mjaftueshëm për 8 vitet në vijim dhe nuk planifikohen objekte të reja. Në bashkëpunim mes institucioneve dhe komunitetit fetar bashkë me administratën publike do të mundë të sigurohet qasja në hapësira të mjaftueshme për data të caktuara.

social dhe punësim për të zvogëluar kërkesat. Të monitorojë dhe menaxhojë zhvillimin hapësinor të banimit të ofrojë kushte adekuate publike sociale të cilat mbështesin zhvillimin e qëndrueshëm të banimit.

Komuna ka të hartuar një program 3-vjeçar të banimit ne baze të cilit jepen kriteret dhe përzgjedhja për mbështetje për familjet që kanë nevojë për strehim. Gjithashtu ka konsideruar llojet e zhvillimeve të nevojshme (ndërtimi i njësisive të reja banesore të cilat jepen me qira joprofitabile; adaptimi i objekteve ekzistuese për banim; sigurimi i banimit me kushte të volitshme për banim, etj.).

Vendbanimet joformale - Komuna do të hartojë programin me metodologjinë për rregullimin e vendbanimit joformal, respektivisht rregullimin e çështjes së pronësisë në Lagjen Brava

Gjate hartimit të programit Komuna do të bazohet në udhëzimin administrativ MMPH Nr. 8/2017 mbi normat teknike të planifikimit hapësinor, në doracakun për rregullimin e vendbanimeve joformale të hartuar nga MMPH dhe do të kërkojë ekspertizë nga MMPH dhe organizatat ndërkombëtare për të ju qasur sa më mire kësaj problematike.

Ndërtimet pa leje

Komuna ka krijuar regjistrin e ndërtimeve pa leje në mënyrë që të ketë një pasqyrë të qartë të ndërtimeve ilegale brenda territorit të komunës. Kjo bazë e të dhënave do të ndihmojë në trajtimin e ndërtimeve pa leje që do të behët bazuar në Ligjin 06/L-024 për trajtimin ndërtimeve pa leje. Në bazë të përgjegjësisive të caktuar me ligj Komuna pas shqyrtimit të kërkesave do të vazhdojë trajtojë ndërtimet tjera pa leje në territorin komunal.

Shfrytëzimi i planifikuar i tokës

Koncepti i ardhshëm për shfrytëzimin e tokës e identifikon zhvillimin (rritjen) e preferuar afatgjatë të Hanit të Elezit dhe modelin e shfrytëzimit të tokës. Në hartën e shfrytëzimit të tokës përcaktohet në mënyrë konceptuale zhvillimi i ardhëm i Komunës. Kryesisht është promovuar shfrytëzimi racional i tokës (dendësim dhe plotësim i zonave të ndërtuara).

Shfrytëzimet e propozuara dhe kushtet për zhvillimin e tokës në mënyrë më detale do të përcaktohet në hartën zonale të komunës (HZK).

Konceptet kyçe të paraqitura në hartën e shfrytëzimit të tokës janë:

- Sipërfaqja ndërtuar e vendbanimeve që përfshinë sipërfaqet me shfrytëzim të përzier (banim, biznese të vogla dhe të mesme, bujqësi minimale, infrastrukturën rrugore, teknike dhe sociale)
- Sipërfaqja e banimit
- Sipërfaqja e tokave bujqësore
- Sipërfaqe pyjore
- Sipërfaqet (lumenj dhe përrenj)
- Zonë ekonomike/ komerciale
- Zona të mbrojtura
- Zona rekreative turistike
- Sipërfaqe e korridoreve të gjelbra e planifikuar për zhvillim rekreacion
- Sipërfaqja e infrastruktura rrugore e të gjitha kategorive të rrugëve dhe transportit përfshire shtigjet për këmbësorë/biçikleta

PARIME, OBJEKTIVA E KRITERE MJEDISORE

PARIME, OBJEKTIVA E KRITERE MJEDISORE QË KUFIZOJNE ZHVILLIMIN KOMUNAL

Ky kapitull paraqet parimet për planifikimin hapësinor të qëndrueshëm, objektivat strategjike dhe veprime operacionale në kuadër të hartimit të PZHK-së. Më tej paraqiten edhe kriteret mjedisore që kufizojnë zhvillimin Komunal në vendbanime të ndryshme të komunës së caktuara.

Parimet e Përgjithshme për Planifikim Hapësinor

Parimet e përgjithshme për planifikimin hapësinor janë një tërësi rregullash të bazuara mbi eksperiencat ndërkombëtare, të cilat shkurtimisht mund të përmbliidhen në dhjetë pika si më poshtë:

1. Nxitja e zhvillimit të qëndrueshëm;
2. Parandalimi i ndikimit të dëmshëm në mjedisin natyror;
3. Ruajtja e tipareve karakteristike natyrore, pejzazhore, të florës e faunës;
4. Zhvillim i shëndetshëm mjedisor, ruajtje e korridoreve ekologjike për të garantuar mbrojtjen e habitateve;
5. Marrja e masave parandaluese dhe rigjenerimi i mjedisve natyrore;
6. Përfshirja e parimeve të tilla si „ndotësi paguan” ose „përdoruesi paguan”;
7. Përdorimi i teknikave dhe metodave më të mira për mbrojtjen e mjedisit;
8. Përdorimi i teknologjisë më të mirë të disponueshme bazuar në ndikimin minimal, ndërtimin pa ndotje dhe përgatitjen e sheshit;
9. Informimi i publikut, përfshirja e komunitetit në vendimmarrje dhe akses i publikut në informacion; dhe
10. Bashkëpunim ndërkombëtar.

Në kuadër të hartimit të PZHK-së parimet e mësipërme përkthehen në përparësitë e mëposhtme (siç janë paraqitur edhe në këtë material):

- Densifikim përpara shtrirjes – kjo ka për qëllim përdorimin e tokës në vendbanime në mënyrë më efektive dhe ngadalësimin e shpërndarjes së disa vendbanimeve përtej kufijve të planifikuar;
- Strukturimi dhe ristrukturimi i zhvillimit koherent të vendbanimeve – kjo synon kryesisht të krijojë një përdorim më të efektshëm të tokës;
- Krijimi i rrugëve të reja brenda strukturës së vendbanimeve– akses i nëpër vendbanime dhe komuna fqinje është një faktor madhor për udhëheqjen e zhvillimit;
- Rehabilitimi i tokës bujqësore;
- Rizhvillimi i pyjeve ekzistuese, pyllëzime të reja;
- Ruajtja e trashëgimisë kulturo – historike dhe natyrore të Hanit të Elezit;
- Ruajtja e shumëllojshmërisë së aktiviteteve dhe përdorimeve nëpër vendbanime;
- Zgjerimi i zonave të banimit atje ku kushtet janë të favorshme.

Objektiva Strategjike

Sipas rëndësisë së tyre, objektivat mund të ndahen në objektiva primare apo globale dhe në objektiva lokale të nivelit komunal. Objektivat kryesore të shqyrtimit të gjerë që lidhen me këtë plan mund të jetë i definuar si:

- Zhvillimi i mëtejshëm i vlerave, ku të gjithë aktorët e kryejnë të drejtën e tyre për të ditur, për t'u dëgjuar, për t'u dëgjuar dhe për të ndikuar në vendimet që ndikojnë në

jetën dhe tendencat e tij. Një nga qëllimet globale është se gjatë zhvillimit dhe implementimit të këtij dokumenti ne kemi pjesëmarrje të cilësisë;

- Zhvillimi i qëndrueshëm, i shpejtë e intensiv dhe ndryshimet në strukturën socio-ekonomik, përfshijnë zhvillimin e barabartë në kuadër të komunës;
- Për të krijuar kushte për një rritje të përhershme në punësim, eliminimin e varfërisë, luftimin e sëmundjeve, përmirësimin e shëndetit dhe reduktimin e vdekshmërisë së fëmijëve në bazë të standardeve që do të ofrojnë qëllimet themelore të ndryshimit në strukturën sociale-ekonomike, zhvillimi dinamik i ekonomisë dhe nivelit të jetës dhe forcimin e rolit të sektorit privat në socio-zhvillimin ekonomik;
- Rritja e vazhdueshme e sigurisë në të gjitha dimensionet (krijimi i sigurisë për edukim themelor, siguri sociale dhe fizike, siguri të mjedisit etj);
- Zhvillimi i një partneriteti global për zhvillim.

Objektivat strategjike të mësipërme synojnë përmirësimin e cilësisë së jetës në komunë (rritja e sigurisë, shtim i mundësive për mënyrën aktive të jetesës, shtim i sipërfaqeve të gjelbra, përmirësim i cilësisë së ajrit, etj.). Ato duhen shoqëruar me veprime operacionale konkrete që çojnë në përmbushjen e objektivave strategjike të planit.

Ndër të tjera, PZHK-ja përpiket të zbatohet disa parime dhe modele zhvillimi të pranuar gjerësisht, si psh. Komuna e Hanit të Elezit komunë policentrike, ku qytetari gjen shërbimet pranë vendbanimit të tij dhe nuk ka nevojë të udhëtojë për të siguruar shërbimet veç në qendrën administrative.

PZHK-ja parashikon zhvillimin e komunës si një tërësi me vendbanime, lagjet, e deri tek zonat e vogla të banimit. Në këtë fazë, duke qenë plan i zhvillimit komunal, do jepen kufijtë, kriteret, intensitetet, densitetet dhe standardet e parashikuara për tërë komunën që nënkupton edhe refleksion në çdo vendbanim, dhe më pas puna do vijojë me planet rregulluese urbane të detajojnë zhvillimin për çdo zonë banimi. Plani do përpiket të përfshijë konceptin e formulës së menaxhimit të pronës në mënyrë adekuate pa dallime të pronarëve gjatë destinimeve në zona ndërtimi, gjelbërimi etj.

PZHK-ja parashih një zhvillim të qëndrueshëm edhe në aspektin mjedisor, duke synuar që zhvillimet e reja të infrastrukturës, zonat industriale, etj., nuk i cenojnë korridoret e qarkullimit të shtazëve ose janë marrë masa të duhura për qarkullim natyrorë të shtazëve dhe llojeve bimore nga një habitat në tjetrin, pyllëzimin, ripyllëzimin, krijimin e disa shiritave të gjelbër, tampon zonave, parqeve dhe shumë mundësi të rritjes së sipërfaqeve të gjelbra brenda vendbanimeve. Një sfidë e veçantë mbetet zbatimi në praktike të këtyre synimeve të PZHK-së; për pyllëzim, ripyllëzim, shirita të gjelbër, tampon zona, dhe në përgjithësi shtimin e hapësirave të gjelbra, krijimi i zonave rekreative dhe përmirësimi i treguesve mjedisorë të komunës.

Gjithashtu plani synon të integrojë dhe përmirësojë situatën aktuale komunale, si psh. zgjerimi i vendbanimeve në drejtimin më të favorshëm në kuptimin e shtrirjes në tokë me pllëshmëri të dobët dhe me përdorim të përzier.

Një tjetër aspekt mjedisor i Planit është rehabilitimi i pikave të nxehta mjedisorë, ndërmarrje që krijon mundësi për shtimin e sipërfaqeve të gjelbra, për çlodhje dhe argëtim.

Në mënyrë të përmbledhur objektivat për mbrojtjen e mjedisit në kuadrin e Planit mund të përmbledhen si më poshtë:

1. Krijimi i një komune të qëndrueshme dhe të shëndetshme;
2. Identifikimi dhe krijimi i habitatve të reja, dhe korridoreve të gjelbëra;
3. Përmirësimi i cilësisë së ajrit, përfshirë reduktimin e zhurmave;
4. Kursimi i energjisë dhe pakësimi i emisioneve të gazeve serrë;

5. Cilësia e ujërave sipërfaqësore në përputhje me kërkesat e legjislacionit të Kosovës dhe Direktivës në kuadër për Ujin të BE-së;
6. Pakësimi i sasisë së mbetjeve dhe menaxhimi i integruar i tyre;
7. Reduktimi i intensitetit të trafikut nëpërmjet promovimit të transportit publik, këmbësor dhe qarkullimit me biçikleta;
8. Shtimi dhe mbrojtja e vlerave kulturore, përfshirë arkeologjike dhe arkitekturore;
9. Konservimi dhe shtimi i zonave dhe elementeve peizazhistik;
10. Mbrojtja e mjedisit natyror në pyjet dhe malet;
11. Ripërdorimi i disa tokave të ndotura në vend të tokave të reja.

Veprime Operacionale në Mbështetje të Objektivave Strategjike

Veprime operacionale për shtimin e hapësirave të gjelbra në komunën e Hanit të Elezit:

1. Krijimi i projekteve për zbatim në zonat të cilat do të mbrohen me këtë plan;
2. Pyllëzimi dhe ripyllëzimi i zonave të parapara me PZHK ;
3. Krijimi i parqeve të reja nëpër dhe për rreth vendbanimeve;
4. Krijimi i korridoreve të reja ekologjike sipas Planit të ri dhe zonave të Hanit të Elezit zgjatimi dhe përmirësimi i kushteve ekologjike në korridorin përgjatë lumenjve;
5. Krijimi i hapësirave të gjelbërta dhe kopshteve në Han të Elezit, etj;
6. Kthimi i zonave të degraduara në sipërfaqe të gjelbra;
7. Gjelbërimi i kopshteve të shtëpive private;
8. Gjelbërimi me peme dhe shkurre dekorative përgjatë rrugëve dhe trotuareve;
9. Ngritja e barrierave të dendura me gjelbërim si perde që ndajnë rrugët nga zonat e banimit dhe zonat tjera, përgjatë rrugëve me trafik të dendur me qëllim të shumëfishtë (rritje gjelbërimi, përmirësim cilësisë së ajrit përmes filtrimit të pluhurave, si edhe rritje e sigurisë rrugore).

Veprime operacionale për përmirësimin e sistemit të transportit dhe shtimit të përmbajtjeve:

1. Përmirësimi i gjendjes së rrugëve ekzistuese dhe zgjerim sipas mundësisë;
2. Krijimi i rrjetit të plote rrugor në vendbanimet e mëdha me përmbajtje edhe për biçiklistët dhe këmbësorët;
3. Përmirësimi i sistemit, orareve dhe cilësisë së autobusëve;
4. Përmirësimi i projektimit të rrugëve me parashikimin e trotuareve të plota dhe shiritave/korsive për biçikletat sipas standardeve europiane të rrugëve;

Kriteret Mjedisore që Kufizojnë Zhvillimin Komunal

Më poshtë paraqiten disa kriteret mjedisore që duhet të kufizojnë zhvillimin komunal, të grupuara në katër kategori kryesore, përkatësisht (1) kriteret e forta mjedisore-shëndetësore, (2) kriteret e trashëgimisë kulturore, (3) kriteret peizazhike dhe (4) kriteret inxhinierike dhe të infrastrukturës.

Kriteret e Forta Mjedisore-Shëndetësore

Këto kategori kriteresh përcaktojnë zonat e përjashtuara nga zhvillimi komunal. Kriteret e forta përfshijnë (I) zona me vlera të veçanta mjedisore (psh. zonat e mbrojtura të natyrës), (II) zona të

rezikshme për zhvillim, dhe (III) zona të ndotura të njohura si “hot-spote” mjedisore (psh. mbetje kimike, materie e rezikshme ej).

(I) Zonat me vlera të veçanta mjedisore zona të tilla nuk ka.

(II) Zonat e rezikshme për zhvillim përfshijnë:

- Shtretërit e lumenjve dhe pjesët buferike rreth tyre
- Basenet nëntokësore ujëmbajtëse;
- Zonat me pjerrësi më të madhe së 15 apo 20%.

Nuk lejohen ndërtimet në (apo pranë) shtretërve të lumenjve pasi ndërtimet mund të jenë në zonën e përmytjeve (qofte dhe shume të rralla), mund të shkaktojnë erozion të brigjeve, si dhe të cenojnë regjimin hidrologjik të sistemit ujor.

Në mënyrë të ngjashme, nuk lejohen ndërtimet në zonat me pjerrësi të madhe pasi në mjedis argjilor këto ndërtime mund të shkaktojnë (ose përkeqësojnë) situatë erodive të kodrave dhe janë një rrezik publik i përhershëm. Në këtë fazë të Planit Zhvillimor Komunal është vështirë të përcaktohen me detaje këto zona, por gjatë hartimit të këtij plani është punuar një planë me pjerrtësi dhe gjatë zhvillimeve të ardhshme mundë të super punohet me informata tjera dhe të shfrytëzohet si bazë për plane rregulluese dhe projekte tjera.

(III) Zona të ndotura të njohura si “hot-spote” mjedisore (psh. mbetje kimike) përfshijnë:

- Deponia e egra përgjatë lumenjve dhe kanalizimet që derdhen drejt për drejt në lumenj;
- Thertore dhe objektet tjera të veprimtarisë ekonomike;
- Ndërmarrja e riparimit të automjeteve;
- Deponitë e veturave “varrezat e veturave”.
- “Varrezat e kafshëve”

Këto zona duhet të jenë objekte të studimeve për vlerësimin e situatës mjedisore mbi bazën e të cilit do të mund të gjykohet mbi nivelin e ndotjes së ujit dhe tokës dhe masat eventuale që duhen ndërmarrë për rehabilitimin.

Kritere të Trashëgimisë Kulturore

Komuna e Hanit të Elezit ka objekte të trashëgimisë kulturore që duhen ruajtur për vlerat e tyre kulturore dhe potencialin turistik në të cilat nuk duhet të lejohet zhvillimi i pakontrolluar.

Vlerat e trashëgimisë kulturore duhen të konsiderohen rast pas rasti me qëllim rinovimin e objekteve në funksion të vlerës së tyre tradicionale, zhvillimin e qëndrueshëm në përputhje me funksionin e tyre kryesor.

Lista e monumenteve të kulturës do duhet rishikuar dhe lehtësuar ndjeshëm. Disa prej monumenteve të kulturës janë cenuar, tjetërsuar apo zhdukur. Disa prej monumenteve kanë qene shpallur për motive qartësisht politike dhe lista duhet avancuar.

Kritere Peizazhike

Turizmi – është i rëndësishëm për të komplementuar zhvillim e gjithmbarshëm komunal. Qyteza në veçanti do të strukturojë paketën mikse kulturo-natyrore dhe industriale ku natyrës ikonike të Sharrit, Karadakut dhe luginave të lumenjve iu gërshetohet historia industriale e Qytezës me pjesët e vjetra industriale dhe banimit të ndërtuar enkas dhe lokacionet e ndryshme kulturore duke përfshirë edhe ato të luftës së fundit. Natyrisht se lista e monumenteve kulturore është shumë më e gjerë me monumente dhe lokacione arkeologjike të shpërndara në tërë Komunën. Duke i pasur parasysht potencialet, mund të pritët që këto lista të zgjerohen edhe më tej në të ardhmen.

Nyje shumë e rëndësishme turistike mbetet në Sharr/ zona turistike Pustenic e cila do të jetë fokusi kryesor me natyrë të bukur dhe lokacionet me vlerë kulturo-historike. Përveç bizneseve shërbyese hoteliere dhe vilave private aty do të ofrohet rekreacion dhe lëvizje në natyrë, qëndrim dhe socializim, etj. Krejt këtij aranzhmani i shtohen edhe zonat turistike të Gorancës dhe Neçavcit (sipërfaqe me pisha), zona turistike e luginës së lumit Dimca si dhe pikat tjera turistike në Laç/ Pustenic, Krivenik dhe Dërmjak.

Vlerat unike natyrore do të plotësohen me vlerat krenare të trashëgimisë historike shumë të rëndësishme të luftës së UÇK-së. Gjithandej nëpër komunë e posaçërisht në Sharr janë Zonat, lokacionet, përmendoret dhe përkujtimoret e luftës për çlirim të grave dhe burrave të Komunës së Hanit të Elezit. Gjatë prezantimit të ofertës turistike, këto asete do të jenë vlerë shtese e tregimit për traditën e përpjekjes së pakufishme dhe të vazhdueshme për jetë të lirë dhe të sigurte të banorëve dhe për të mundësuar shijimin e kësaj natyre nga vizitorët.

Përmes transportit të organizuar, vizitave private dhe dhënies së informacionit, ky funksionalitet turistik organizohet nga Qyteza dhe pikës informuese në Pustenic. Shpërndarja dhe qasja në informacion digjital është pjesë e domosdoshme e këtij funksionaliteti.

Për zhvillimin e turizmit do të nevojiten një varg masash shtesë, të cilat duhet të mundësojnë shfrytëzimin e potencialeve lokale por pa i cenuar vlerat e tyre. Këtu fillimisht bëjnë pjesë studimet e nevojshme për profilet e mundshme të turizmit në Han të Elezit dhe vizitorët potencial, të pasuara me aktivitete për promovimin e vlerave turistike lokale. Po ashtu, është e nevojshme që të ngritën kapacitetet profesionale për ofrimin e shërbimeve turistike, duke u bazuar në përvojat e mira ndërkombëtare për turizëm të qëndrueshëm. Ndërkaq, infrastruktura fizike që do ti mbështesë aktivitetet turistike duhet të zhvillohet me kujdes dhe në harmoni me vlerat natyrore dhe kulturore, duke shmangur çfarëdo cenimi të tyre.

Sipërfaqet turistike në Pustenic dhe Neçavc do të definoohen më tej me HZK ku përmes nënzonimit do të përcaktohen nënzonat ku lejohen zhvillimet banuese/ rekreative (vila) apo hotelieri shërbyese, tregtare, etj. Në të gjitha sipërfaqet tjera rekreative turistike dhe jashtë atyre nënzoneve të tri të lartpërmendur, nuk do të lejohet kurrfarë zhvillimi që do ti dëmtonte vlerat natyrore të atyre sipërfaqeve.

Kritere Inxhinierike dhe të Infrastrukturës

Infrastruktura teknike përfshinë shtrirjen e rrugëve publike, ndërtesave, instalimeve nëntokësore dhe mbitokësore për furnizimin e energjisë elektrike dhe termike, rrjetit të ujësjellësit dhe kanalizimit, telekomunikacionit dhe instalimeve të tjera të ngjashme. Kapacitetet e këtyre sistemeve dhe cilësia e shërbimit do të përmbushin nevojat e banimit, si dhe do ta mbështesin zhvillimin ekonomik.

**NDIKIMET E MUNDSHME
MJEDISORE DHE MASAT
PËR ZBUTJEN E TYRE**

Plani Zhvillimor Komunal i Hanit të Elezit dhe Zgjidhjet e Parashikuara për Problemet e Mjedisit

PZHK-ja është rezultat i evidentimit, vlerësimit, dhe prioritizimit të nevojave strategjike zhvillimore socio-ekonomike dhe mjedisore të Komunës së Hanit të Elezit dhe komunitetit të saj nga ana e Grupit hartues të Planit Zhvillimor komunal. PZHK ka si qëllim transpozimin dhe sendërtimin e Vizionit, të këtyre objektivave dhe prioriteteve strategjike në një sistem planifikimi zhvillimor komunal. Në një proces të tillë të rëndësishëm, ky itinerar do të mbështetet nga hartimi i planeve tjera të vendbanimeve dhe zonave ndërtimore të niveleve më të ulëta dhe kodeve me instrumente të veçanta zhvillimi hapësitor, sipas gjithë komponentëve të vet: ekonomikë, socialë, mjedisorë dhe organizativ. Këta instrumente përbëjnë një ndërthurje të programeve të veprimit me nismat investuese, me qëllim orientimin e zhvillimit komunal në zonën e përfshirë në studim.

Plani merr në konsideratë dhe përgjithësisht është në përputhje me planet e ndryshme të nivelit më të lartë, si dhe në linjë edhe me shtyllat kryesore të zhvillimit të Planeve Sektoriale. Planet dhe projektet Sektoriale që hartohen edhe si rezultat i këtij plani duhet të bëjnë ose të parashikojë të përfshijë vlerësime të kostove dhe të identifikojë ose përfshijë identifikimin e masave të nevojshme që duhen ndërmarrë për implementimin e këtyre propozimeve. Propozimet për zhvillimin e zonave, rrugëve etj, përfshihen si në propozimet për përdorimin e tokës, ashtu edhe për ndarjen në faza, pasi duhet që të ruhen apo të gjenden sipërfaqe toke për zhvillimin e zonave, ndërtimin e rrugëve etj, për sa kohë që mundësia e aksesit shihet si mekanizmi kryesor që drejton zhvillimin.

Çështje tjetër që PZHK trajton janë zonat me vlera mjedisore dhe ambientale si dhe zonat me vlera të trashëgimisë kulturore si dhe janë marrë masa adekuate për mbrojtjen e këtyre zonave me rëndësi të veçantë. Si rezultat, PZHK do të shërbejë edhe si një proces i cili mundëson adresimin e shumë prej problemeve mjedisore sociale, ekonomike dhe organizative të cilat kërkojnë zgjidhje të duhur. Kryesisht duhen investime në infrastrukturë dhe përmirësim i menaxhimit komunal me qëllim që tu jepet përgjigje shumë prej problemeve mjedisore të hapësirës komunale të marrë në studim, ndërsa procesi i planifikimit të zhvillimit të zonave dhe shfrytëzimit të tokës duhet zbatuar sipas këtij plani, me qëllim që të parandalohet shtrirja e mëtejshme nëpër zonat bujqësore dhe zonat me vlera tjera nëntokësore dhe sipërfaqësore.

Kjo nevojë për planifikim dhe menaxhim në nivel vendbanimesh të shumta bashkërendimi dhe veprimi në mes tyre është identifikuar si çështje e rëndësishme edhe në raportet e PZHK-së, sipas së cilës gjithashtu propozohen masa për mbrojtjen e zonave ekzistuese të gjelbra dhe ujërave brenda dhe rreth territorit komunal dhe ka përgatitur planin e masave për zhvillimin e tyre të qëndrueshëm. Këtu përfshihen zonat e ujërave sipërfaqësore, përgjatë lumenjve, dhe nëpër vendbanime.

Trajtimi i Çështjeve Mjedisore në Hartimin e Planit Zhvillimor Komunal

Gjatë hartimit të Planit zhvillimor komunal në çdo fazë të zhvillimit të tij është vënë në konsideratë edhe vlerësimin mjedisor. Megjithëse nuk është qëllim kryesor për PZHK-në, të dalurat e fazës së parë të studimit të PZHK-së (faza e profilit komunal) përmbajnë të dhëna dhe komente të konsiderueshme mbi gjendjen dhe problemet e mjedisit në Hanë të Elezit. Gjatë fazave të zhvillimit të PZHK-së merren në konsideratë çështje mjedisore apo të ofrimit të shërbimeve dhe diskutojnë gjendjen dhe shkakun e problemeve mjedisore në komunë.

Zhvillimet e planifikuar të cilat kanë ndikim në mjedis janë marrë në konsideratë duke i ruajtur të gjitha komponentët mjedisore në aspektin strategjik të zhvillimit të komunës. Gjatë planifikimit gjithmonë janë ruajtur korridoret e qarkullimit të shtazëve dhe bimëve nga një ekosistem në tjetrin, janë ruajtur ekosistemet të cilat kanë një rëndësi të veçantë për komunën dhe për rajonin, janë marrë në konsideratë ruajtja e zonave të mbrojtura me vlera ambientale dhe kulturore.

Analiza e Vlerësimit Strategjik Mjedisor të PZHK-së

Gjatë analizës është vlerësuar se masat të cilat janë marrë për mbrojtje të mjedisit gjatë planifikimit nuk do të kenë efekte negative ekonomike apo shëndetësore dhe mjedisore. Për këtë arsye, është e vështirë që të matet saktësisht nga pikëpamja sasiore shkalla e ndikimit që do të ketë plani zhvillimor komunal mbi mjedisin apo shëndetin. Megjithatë, prirjet e këtij ndikimi, të cilat janë edhe objekt i VSM, janë të parashikueshme. Për të siguruar vlerësimin e plotë të ndikimit të mundshëm mjedisor të planit, fillimisht është e nevojshme të përcaktohen të gjithë faktorët të cilët mund të ndikohen nga ky plan. Tabela e mëposhtme shërben si një listë e kontrollit të kriterëve mjedisore sipas të cilave është bërë vlerësimi i këtij plani. Kjo listë tregon nëse PZHK-ja e ka marrë në konsideratë problemin, e po të jetë kështu, nëse i ka dhënë përgjigje. Kolona e fundit shpjegon nëpërmjet shenjave si më poshtë:

- *= Ka përgjigje të plotë për problemin;
- += Ka nevojë për masa të mëtejme;
- - = Nuk është trajtuar, duhet të trajtohet me PZHK.

Tabela 12. Konsiderata Mjedisore dhe Shëndetësore të PZHK-së

Tabela nr. 5. Konsiderata Mjedisore dhe Shëndetësore të PZHK-së			
Kriteri përkatës	A është marrë parasysh në PZHK ?	Si është trajtuar problemi në PZHK ?	Treguesi
1. Përfshirja e konsideratave mjedisore	Po	Përfshihen në seksionet e mëposhtme.	*
2. Përfshirja e konsideratave shëndetësore	Po	Përkruhen në seksionet e mëposhtme.	*
3. Marrja parasysh e objektivave ndërkombëtarë, kombëtarë dhe lokale për mjedisin dhe shëndetin gjatë formulimit të PZHK-së	Po	Përkruhen në seksionet e mëposhtme.	*
4. Përfshirja në sintezë e Konsideratave Mjedisore	Po	Janë përfshirë në PZHK.	*
5. Konsideratat mjedisore në Opsione	Po	Kjo është bërë si pjesë e diskutimeve profesionale gjatë studimit të skenarëve zhvillimorë.	*
6. Koncepti i Planifikimit të PZHK-së			
a. Mbështetje për zhvillimin policentrik me infrastrukturë të zhvilluar të Hanit të Elezit	Po	Propozimi ndjek në mënyrë pragmatike prirjet ekzistuese dhe ato strategjike të zhvillimit komunal dhe socialo ekonomik të Hanit të Elezit. Problemi është që kjo rritje të bëhet mbi bazën e kriterëve të forta mjedisore, dhe të mos shtrihet në tokat bujqësore, pyjet përreth, hapësirat ujore dhe me potencial vërshimi si dhe jo në afërsi të zonave të mbrojtura.	*
b. Afirmon rolin e Hanit të Elezit në nivel të Kosovës, dhe në nivel ndërkombëtar krahas ofrimit të mundësive turistike që ofron komuna	Po	Orienton Komunën e Hanit të Elezit si qendër dhe si pikë fokale për të gjitha anët e vendit në kuptimin e zhvillimit të turizmit dhe fuqizimit të trashëgimisë me vlerat e	

		trashëgimisë natyrore dhe kulturore.	*
d. Përforcimi i kapacitetit të Komunës për të rritur rolin e migrimit dhe për t'u siguruar banorëve të rinjë mundësi punësimi.	Po	Kjo propozohet të bëhet nëpërmjet zgjerimit në hapësirë në vendbanimet që kanë trendë rritje dhe ofrimit të kushteve edhe në vendbanimet tjera.	*
e. Integrimi i zonave rurale në komunë dhe ulja e shkallës së përjashtimit ekonomik dhe social të banorëve të tyre.	Po	Është marr në konsideratë që në fazën e nismës së hartimit të PZHK-së.	*
f. Fuqizimi dhe zgjerimi i vendbanimeve brenda kufijve ndërtimor të planifikuar	Po	Ky koncept ka si qëllim të ndihmojë zhvillimin dhe rigjenerimin e vendbanimeve në sistemin policentrik. Ai përfshin propozime mjedisore në formën e ruajtjes së zonave të gjelbra edhe përtej kufijve ndërtimor të vendbanimeve	+
g. Harmonizimi dhe baraspeshimi i zhvillimeve nëpër nënqendra komunale.	Po	Ky propozim ka si qëllim zhvillimin e nën qendrave të tjera për të ulur stresin në një zonë qendrore. Si i tillë, ai propozon ndërtimin e një serie funksionesh nëpër këto nënqendra.	*
h. Fuqizimi i zonave ekonomike ekzistuese, si dhe zonave të reja ekonomike përgjatë akseve rrugore në përgjigje të potencialeve dhe nevojave të reja ekonomike.	Po	Ky koncept ka si qëllim të mbështesë por dhe orientojë dhe përkufizoj zhvillimet aktuale. Koncepti mbështet në faktet që gjendja tashmë e krijuar është e patjetërsueshme, kështu duhet sanuar duke orientuar zhvillimet dhe përkufizuar zonat.	*
i. Të gjitha potencialet ekonomike janë vë në shërbim të zhvillimit të komunës, duke vu theksin në mundësit zhvillimore në zonat ekonomike për bizneset e vogla, të mesme dhe të mëdha.	Po	Vizioni i ri ka për objektiv të gjejë mundësi që zonat e njohura ekonomike dhe turistike në komunë të mund të shfrytëzohen racionalisht dhe të ofrohen si një paket turistike shumë atraktive.	*
j. Ruajtja e shtretërve dhe rrjetit të lumenjve në tërësi (me theks të veçantë lumi Lepenc dhe dege e tij).	Po	Ky koncept dhe kjo ndërhyrje ka për objektiv mbrojtjen e disa zonave ujore brenda hapësirës së Hanit të Elezit, dimensionimi i zonës sipas kriterëve mjedisore, dhe zgjidhja e një problemi të fortë mjedisor të zonës	*
k. Ruajtja ujërave nëntokësore të cilat ndodhen në Hani i Elezit	Po	Problematika është trajtuar në pjesën e analizave të gjendjes ekzistuese, është trajtuar edhe në masat të cilat janë vë si rezultat i ofrimit të shërbimeve komunale.	*
m. Përmirësimi i shërbimeve publike dhe aksesit ndaj transportit në zonat rurale	Po	Po, por duhet arritur një ekuilibër mes aksesit të përmirësuar dhe inkurajimit të zhvillimit të mëtejshëm të ndërtimeve rurale në zonat ku kjo gjë mund të mos jetë e dëshirueshme.	*
7. Ndikimet në klimë			
a. Përshtatja me ndryshimet klimatike globale.	Jo	Ka trajtim të ndryshimeve klimatike globale. Ndërsa ende nuk ka strategji nacionale të aprovuar për masat që duhet	-

		marr për tu përshtatur me ndryshimet klimatike globale. Nuk është objekt parësor i parashikuar nga TeR, por në studimin mjedisor janë integruar objektivat dhe instrumentat e zbatimi të cilat shkojnë në këtë drejtim si ai i uljes së CO ₂ të komunës.	
b. Marrja parasysh e ndryshimeve lokale.	Po	Përfshihet si tregues mjedisor, por nuk trajtohet në mënyrë parësore.	+
8. Demografia			
a. Problemet me zhvillimin demografik	Po	Njeh faktin se kjo është ende e vështirë për t'u parashikuar saktë. Megjithatë, mund të ketë nevojë për më shumë fleksibilitet, për t'i lënë hapësirë ndryshimeve të mundshme.	+
b. Skenarët e zhvillimit demografik	Po	Merr parasysh faktin që popullsia mund të rritet jo edhe aq shumë deri në vitin 2031. PZHK-ja i mban larg presionit demografik zonat me ndjeshmëri mjedisore.	*
9. Zhvillimi dhe shfrytëzimi i Tokës			
a. Planifikimi komunal dhe Drejtimi i Zhvillimit	Po	Njeh nevojën për pranimin e zhvillimit aktual, përveç zonave ku mund të shkaktohen probleme mjedisore	*
b. Kapacitetet mjedisore në zonat dhe vendbanimet e propozuara për zhvillim	Po	Vlerësohet se vetëm në pjesët e ndryshme ku kemi eksploatim të rërës dhe degradim të lumenjve dhe disa deponi të vjetra të mbeturinave, i rrezikojnë kapacitetin e saj mjedisor dhe ekologjik. Ndërsa në vendbanime nuk ka një cenim ekologjik, duke qenë brenda kapaciteteve mjedisore. Zona e propozuara për zhvillim industrial apo ekonomik shtrihet në tokën jobujqësore dhe propozohet studimi i VSM/VNM-së së veçantë për aspektet tjera mjedisore, ndërsa në vendbanimet brenda konceptit policentrik vërehen tendencat e shtrirjes në kategorinë “tokë bujqësore” të konvertuara vonë në zona informale, por edhe këtu tentohet të ruhet sa ma shumë tokë bujqësore dhe kompaktësim sa ma i madh i zonës ndërtimore.	*
c. Zhvillimi i parqeve dhe hapësirave të reja rekreative	Po	Njeh problemin e mungesës së tokës për këtë qëllim vetëm brenda vendbanimeve dhe propozon mbrojtjen e zonave të gjelbra dhe parqeve duke krijuar një kurorë të gjelbër të përbërë nga disa zona dhe sisteme kodrinore malore të mbrojtura. Megjithatë, për të gjithë këta elemente, përfshirë dhe zonat që gjenden brenda vendbanimeve (zemrat e gjelbërta) dhe në zonat jashtë tyre janë të	+

		përcaktuara kufijte. Duhet marrë vendimet përkatëse për shpalljen zona të interesit komunal, dhe duhet aprovuar Planet e Menaxhimit lidhur me zhvillimet brenda këtyre kufijve.	
d. Zhvillimi i parqeve të reja brenda vendbanimeve policentrike	Po	Edhe pse pjesërisht e thamë më lartë se njohim problemin e mungesës së tokës brenda zonës së vendbanimeve policentrike. Në disa vendbanime janë paraparë edhe disa zona të blerta të ashtuquajtura si “zemrat e gjelbërta” në të cilat mundë të zhvillohen parqe dhe hapësira për zhvillim të bujqësisë intensive. PZHK propozon një varg masash për rritjen e sipërfaqes së gjelbër. Masat duhet të konkretizohen me veprime për çdo kategori zonashë në vendbanime.	*
e. Mbrojtja e pyjeve, peizazheve dhe zonave të mbrojtura natyrore	Po	Njihen problemet dhe bëhen propozimet adekuate për pyjet dhe hapësirat e gjelbra. Duhet çuar përpara statusi i tyre dhe duhet hartuar dhe aprovuar Plane menaxhuese përkatëse, ndërsa parqet ekzistuese duhet trajtuar në mënyrën adekuate në tërë territorin e komunës.	*
f. Zhvillimi i zonave të reja komunale	Po	Nxitet ky zhvillim veçanërisht në fushën e hapësirave dhe terreneve sportive, për të lehtësuar presionin në disa vendbanime. Me zhvillime të reja janë tashmë të gjitha vendbanimet me elemente të domosdoshme urbane.	*
g. Zhvillimet industriale	Po	PZHK përputhet me parimet strategjike ku aktivitetet ekonomike që shkaktojnë ndotje nuk do të lejohen dhe do të dekurajohen. Ka një problem me trajtimin e zhvillimeve aktuale për këtë lloj industrie!	+
i. Shërbimet dhe lehtësirat Publike (shkolla, stadiume sportive)	Po	Propozon norma dhe nevojën për standarde në tërë territorin e komunës.	*
h. Pyjet, malet dhe parqet/zonat e mbrojtura	Po	Trajtohen si zona të mbrojtura për pyje dhe parqe. Dekurajohet me forcë ndërtimi në këto zona përpos kur është definuar me këtë plan. Duhet të trajtohen zonat prioritare edhe nga pikëpamja e peizazheve pra e pikave panoramike me rëndësi peizazhike dhe turistike për komunën.	+
k. Forma e vendbanimeve dhe dendësia	Po	Propozime konkrete në kodin e zoonimit për lartësinë e ndërtimeve. Ato bazohen në ruajtjen e formës së vendbanimeve, mbushjen e zonave me densitet të ulët, dhe identifikimin e zonave ku do të lejohet zhvillimi i ndërtimeve në lartësi.	*
l. Mbrojtja e detajuar e Zonave të Gjelbra			

m. Lumenjtë	Po	Të ndalohet degradimi i mëtutjeshëm i lumenjve nga eksploatimi i rërës dhe zhavorrit, të kthehen në korridore të gjelbër, por ndërkohë duhen përcaktuar kufijtë e shtretërve të lumenjve dhe të hartohet Plan Menaxhimi dhe Monitorimi mjedisor	+
n. Parqet dhe zonat e mbrojtura			
a) Kombëtare	Po	Në komunën e Hanit të Elezit parqe të tilla nuk ka.	*
b) Të reja	Po	Sugjerohet një seri Parqesh dhe zonave të rëndësisë komunale, por mbetet problemi i Planeve të Menaxhimit të tyre pasi që kufijtë janë caktuar me PZHK.	*
o. Brezi i gjelbër	Po	Në zonat përgjatë rrugëve regjionale, zonat industriale dhe zhvillimet tjera.	*
p. Pjesa e brendshme e vendbanimeve	Po	Jepen standardet për zonat lokale. Njihet problemi i mungesës së hapësirës për rritjen e sipërfaqeve të gjelbra apo për zona komunitare si sheshe, kënde lojërash, etj. dhe bëhen propozime në lidhje me instrumentet planifikues në planet e detajuara vendore.	*
10. Rreziqet natyrore apo humane			
a. Rreziqet natyrore në tërësi	Po	Trajtohen në përgjithësi, por ka nevojë për vëmendje më të madhe.	+
b. Rrëshqitjet e tokës	Po	Trajtohen në mënyrë specifike, sepse jepen standardet kufizuese për pjerrësitë e mëdha sidomos në pjesën e rrëshqitjeve të dheut.	+
c. Përmbytjet	Po	Tregohen masat e duhura që duhet të ndermirrën për parandalimin e dëmeve që prodhojnë vërshimet	*
d. Tërmetet	Po	Në kodet e ndërtimit, por nuk gjen zbatim retrospektiv tek ndërtesat ekzistuese. Nuk ka detyrime për ndërtime me dalje emergjence në rast tërmeti.	+
c. Të ardhurat e ulëta	Po	Njih problemin se strehimi në ndërtesa të reja të ligjshme është i mundshëm vetëm për grupet me të ardhura të larta. Rekomandon nevojën që të ndërmerren politika sociale të strehimit.	*
d. Cilësia	Po	Kërkohet miratimi dhe respektimi rigoroz i kodeve të ndërtimit.	*
e. Shkalla sizmike	Po	Rekomandon kritere projektimi në përputhje me nivelin 8 në shkallën MSK-6421, pasi ky është një rrezik i njohur. Do të ishte mirë të sugjeroheshin projekte sipas Shkallës Evropiane Makrosizmike (EMS) për të respektuar standardet Evropiane.	+

Masat e Nevojshme në PZHK për Mbrojtjen e Mjedisit

Në tabelën e mësipërme janë analizuar dhe janë dhënë disa rekomandime të mëtejshme. Kriteret që janë shënuar me shenjën * nuk diskutohen më tej, pasi nuk konsiderohen si problematikë. Tabela e mësipërme përmban një përmbledhje të gjitha problemeve mjedisore dhe shkallën në të cilën plani u jep përgjigje secilit prej tyre.

Konceptet Urbane të Përdorimit të Tokës, përfshirë Zhvillimin e Qendrave

Gjatë gjitha fazave të planifikimit vërehet se i është kushtuar rendësi e veçantë ruajtjes së tokës pasi që zgjerimi i ndërtimeve pa kontrollë dhe pa kritere sidomos përgjatë rrugëve është problem i përmasave mjaft serioze.

Me PZHK paraqitet destinimi i propozuar të tokës për vitin 2031. Këtu prezantohen edhe kufijtë e rinj ndërtimor edhe zhvillime tjera. Kjo do të sjellë humbjen e mëtejshme të tokës bujqësore, por njëkohësisht do të sigurojë ruajtjen e pjesës së konsiderueshme të tokës me pjellshmëri, tokës së pasur me resurse dhe pyjeve. Kemi të prezantuar edhe zonat e shënuara me ngjyrë e cila potencialisht mund të paraqesin pikat e nxehta mjedisore.

Konfliktet e mundshme për hapësira mund të adresohen vetëm nëpërmjet zbatimit më të mirë të këtyre planeve. Masa e parë duhet të jetë arritja e një marrëveshje për mbrojtjen e këtyre zonave, e cila duhet të ndiqet nga plane rregulluese dhe tjera për komunën, të cilat do të vireshin më pas në zbatim. Kjo është një sfidë e madhe për qeverinë komunale, gjë që pranohet edhe në Planin Zhvillimit Komunal të Hanit të Elezit. Janë organizuar takimet e para me komunitetin për të filluar këtë proces. Zhvillimi i Hanit të Elezit besohet se do të vazhdojë, e në fakt sa më shumë sukses ekonomik të prodhojë Komuna e Hanit të Elezit, aq më shumë do të përshpejtohet rritja e saj. Kjo do të ishte e dëshirueshme dhe është në të mirë të Kosovës, duke supozuar se realizohen investimet në infrastrukturën mjedisore dhe menaxhimi efektiv komunal. Komuna e Hanit të Elezit ka mundësi të akomodojë një numër shumë më të madh popullsie me zgjerimin e kufijve ndërtimorë dhe turistëve me zgjerimin e kapaciteteve receptive turistike pasi që përfitimi më i madh vjen nga kjo degë e ekonomisë sidomos për vendet që janë në zhvillim. Burimet ujore janë të mjaftueshme. Kapaciteti mjedisor mbajtës i Hanit të Elezit nuk përbën problem, ndërkohë që problem përbëjnë menaxhimi dhe planifikimi urbano-efektiv dhe nevoja për financime të mëdha në infrastrukturën mjedisore. Planit i njeh këto probleme dhe përpiket në mënyrë realiste të punojë brenda këtyre kufizimeve.

Ndikimi në klimë

Për faktin se komuna e Hanit të Elezit ka një industri të zhvilluar sidomos në përfitimin e cimentos, prandaj duhet që në mënyrë permanente të kushoj vemendje ndotjes së mjedisit. Me aktivitetin aktual dhe atë që do të ketë në perspektivë Hani i Elezit do të ndikoj pak në klimën globale. Është e rëndësishme që të bëhen studime për të vlerësuar rritjen e temperaturës dhe faktorëve tjerë klimatik. Megjithatë mos marrja e masave me PZHK e cili nuk ndihmon në ruajtjen e zonave të gjelbra dhe që lejon zhvillimin e pakontrolluar në mënyrë të pashmangshme do të shkaktojë një ndikim në mezoklimë, jo vetëm në rritjen e temperaturave, por edhe stuhi më të rralla, por më të fuqishme, të cilat do të shkaktojnë përmbytje.

Mbrojtja e Pyjeve, Zonave të Gjelbra Ekzistuese dhe Zhvillimi i Zonave të Reja

Zoonimi i propozuar nga PZHK-ja krijon mundësinë për struktura të gjelbra, kryesisht për përdorim të ndryshëm, Pyllëzim, ripyllëzim etj. Duhet hartuar udhëzues për:

- Projekte pyllëzimi konform planit;
- Projekte ripyllëzimi dhe mirë mbajtje konform planit;

- Numrin e këtyre strukturave që do të lejohet dhe ku do të lejohet (apo nuk do të lejohet) ngritja e tyre;
- Përdorimin e tyre, të themi për grupe/festa të mëdha, gjë që do të kishte ndikime negative;
- Arkitekturën e tyre për të siguruar harmoninë vizuale me mjedisin rrethues;
- Shërbimet e infrastrukturës për ofrimin e energjisë, ujit dhe menaxhimit të mbeturinave, me qëllim shmangien e ndikimeve vizuale dhe ndotjet e mundshme.

Duhet përgatitur propozimet lidhur me mënyrën se si do të trajtohen zhvillimet në zonat e lartpërmendura. Plani Zhvillimor Komunal ku hyjnë edhe lumenjtë që shtrihen në komunën e Hanit të Elezit shërbejnë pikërisht për këtë qëllim.

Cilësia e Ajrit

PZHK-ja mundet të adresojë problemet e cilësisë së ajrit vetëm në mënyrë të pjesshme. Ndërtimi i rrugëve cilësore do të ulë trafikun nëpër vendbanime të mëdha, duke sjellë përmirësim të cilësisë së ajrit, ndërkohë që rritja e parashikuar për trafikun në vitin 2022 do të bëjë që cilësia në përgjithësi e ajrit të përkeqësohet, veçanërisht për Pb, SO_x, NO_x, të cilat aktualisht janë brenda normave të BE-së dhe Kosovës. Zbatimi i standardeve më strikte, për “Sharr Cem”, për çlirimet në ajër nga automjetet, përmirësimi dhe kontrolli i cilësisë së karburanteve menaxhimi më i mirë i trafikut, përfshirë përdorimin e rritur të biçikletave, si dhe furnizimi i plotë me energji (për të ulur përdorimin e gjeneratorëve) ka shumë gjasa të ngadalësojnë përkeqësimin e mëtejshëm të cilësisë së ajrit për një periudhë afat-shkurtër deri në afat-mesme. PM10 mund të reduktohet nëpërmjet përdorimit të teknikave më të mira të ndërtimit dhe shtrimit të më shumë rrugëve. Duhet bërë vlerësimi i ndikimit të cilësisë së keqe të ajrit mbi shëndetin dhe ekonominë nëpërmjet llogaritjes së shkallës së sëmundjeshmërisë me qëllim vlerësimin sasior të dëmit në shëndet dhe kostos ekonomike që sjell ndotja e ajrit për Komunën. PZHK-ja nuk e ka adresuar problemin e zhurmave. Megjithatë, disa nga masat e parashikuara në Plan si shtimi i numrit tampon zonave, diversifikimi i transportit publik, futja e korësive të biçikletave, furnizimi pa ndërprerje me energji elektrike dhe shmangia e përdorimit të gjeneratorëve, krahas masave administrative komunës së Hanit të Elezit për pakësimin e zhurmave në një kategori të mjediseve publike që aktualisht janë problematike, do të ndikojë në uljen e nivelit të zhurmave, krahasuar me vlerat aktuale.

Menaxhimi i Mbetjeve të Ngurta

Duhet bërë identifikim i vendit për ngritjen e një deponie të përhershme. Plani ka bërë parashikime për ndërtimin e transdeponive. Kjo zgjidhje kërkon edhe ndërtimin e stacioneve të transferimit. Duhet, pra, një plan i) për identifikimin e një vendi për ngritjen e deponie të përhershme, ii) pastrimin e fushës aktuale të grumbullimit të mbeturinave; iii) për menaxhimin më të mirë të mbetjeve të ngurta në komuna iv) për trajtimin e mbetjeve të rrezikshme, të ndërtimit dhe atyre klinike; dhe v) rekomandimin e rregullimeve institucionale dhe financiare për të arritur këtë.

Propozimet për Rrugë

PZHK-ja propozon një sistem rrugësh lokale dhe ndryshim ose zgjerim të traseve të disa rrugëve. Meqë komuna e Hanit të Elezit është një territor transit në mes të qendrave nacionale dhe ndërkombëtare pasi që është komunë kufitare vjen në shprehje edhe infrastruktura tjetër e cila diktohet nga niveli nacional dhe e cila ka impaktet më të larta mjedisore. Me probleme të përafërta përballen edhe rrugë të tjera të propozuara, të cilat kalojnë nëpër zona të gjelbra në të cilat janë masat adekuate për ruajtjen e tyre.

Efektet kumulative

VSM-ja nuk do të kufizohet vetëm në analizën e elementeve individuale të planit, por duhet të bëjë gjithashtu edhe një vlerësim të përgjithshëm në vazhden e të gjitha aktiviteteve dhe politikave të cilat përfshihen në Planin Zhvillimor Komunal të Hanit të Elezit.

Komponentët mjedisore	Elementet e PZHK-së					Vlerësimi i efekteve kumulative
	Rrugët e planifikuara	Autoudha në afërsi të komunës së Hanit të Elezit	Zonat e planifikuara të ndërtimeve	Zonat ekonomike dhe industrial	Pyllëzimi	
Emetimi i gazrave serrë	0	-	+	0	+	Pa ndonjë efekt domethënës
Burimet natyrore	+	0	-	+	+	Pozitive
Toka	+	0	+	-	+	Pozitive
Uji	0	0	-	0	+	Pozitive
Ajri	0	-	+	0	+	Pozitive
Biodiversiteti	+	-	0	-	+	Pa ndonjë efekt domethënës

Tabela 13. Matrica e përmbledhjeve të efekteve kumulative të të gjitha elementeve të PZHK-së në komponentët mjedisore

Në këtë Raport ndikimet mjedisore kumulative përcaktohen si një kombinim i ndikimeve të zbatimit të veprimeve të Planit në aspekte të ndryshme të mjedisit. Gjatë implementimit të zhvillimeve të planifikuara të Planit, impaktet mjedisore kumulative variojnë sipas aspekteve individuale të mjedisit. Kur vlerësohen impaktet mbi token, ajrin dhe faktorët klimatike, biodiversitetit impaktet kumulative të zbatimit të veprimeve të Planit shprehen si shuma e impakteve të të gjitha masave, si të tilla në vlerësimin e impakteve kumulative mbi:

- ajrin, shkarkimet e ndotësve që pasojnë zbatimin e masave që kombinohen; dhe
- burimet natyrore si burimet ujore, minerale dhe resurseve tjera të cilat kombinohen;
- token, zona toke bujqësore dhe e pyjeve e fragmentuar për shkak të integritetit të strukturave të infrastrukturës së re që kombinohen si efekte;
- faktorët klimatik, shkarkimet e gazeve serrë që pasojnë zbatimin e masave që kombinohen.

Nga aspekti i impakteve mbi ajrin dhe faktorët klimatik, impaktet kumulative si shumë e impakteve të gjithë veprimeve të PZHK-së janë të rëndësishme për realizimin e objektivave mjedisore:

- shkarkimet e limiteve të ndotësve
- menaxhimin e mbetjeve inerte dhe
- sasia vjetore më e lartë e shkarkimit të gazeve serre.

Në vlerësimin e impakteve mbi ujin, natyrën, trashëgiminë kulturore dhe peizazhin, efekteve kumulative zakonisht nuk mund të shprehën si një shumë e impakteve të gjithë veprimeve për të arritur synimet e PZHK-së. Kur vlerësohen efektet kumulative në aspektet e përmendura me sipër, karakteristikat e një impakti individual që kontribuon në efektet kumulative janë shumë të rëndësishme. Këto janë përgjithësisht karakteristika në të cilat impaktet ndryshojnë njëri nga tjetri sipas vendit (impakt direkt dhe në distance) dhe kohës (afat-shkurtër, afat-mesëm dhe afat-gjatë, përkohësisht dhe permanent) të efekteve.

Nëse vlerësohen efektet mbi shëndetin njerëzor, efekti kumulativ të PZHK-së shprehen si efekte të kombinuara kumulative dhe zakonisht referohen për:

- zvogëlimin e ekspozimit në nivelet e tejkaluara të bezdisjes akustike;
- zvogëlimin e ekspozimit në nivelet e tejkaluara të ajrit të ndotur në mjedis; dhe
- masat e marra në PZHK që lehtësojnë veprimtari çlodhëse dhe rekreative në një mjedis.

Kur vlerësohen impaktet mbi popullatën dhe asetet materiale, impaktet kumulative të zbatimit të PZHK-së shprehen si një kombinim i impakteve të ndryshme që ndikojnë në hapësirën e tyre të jetesës dhe në jetën e tyre. Masat për të arritur synimet e PZHK-së janë pozitive nga aspekti i impakteve mbi popullsinë dhe asetet materiale, nëse efektet kumulative të tyre kontribuojnë në arritjen e kohezionit social, sigurinë dhe qëndrueshmërinë. Në vlerësimin e efekteve kumulative në Biodiversitet të llojeve organike në zhvillimet e planifikuara shprehën si efekte të kombinuara duke rritur impaktin në biodiversitet, mirëpo me masat që janë marr me PZHK efekti do të jetë më i zbutur deri te efekti pozitiv për biodiversitetin.

Probleme të Mjedisit në Hani i Elezit dhe Përgjigjia që Jepet përmes PZHK-së

Tabela e mëposhtme bënë një përmbledhje të problemeve mjedisore që u identifikuan në Kapitullin 6 dhe të shkallës në të cilën PZHK-ja i u përgjigjet atyre, duke sugjeruar njëkohësisht edhe masa të tjera për mbrojtjen e mjedisit.

Tabela 14. Përmbledhje e Problemeve Mjedisore dhe përgjigja sipas PZHK-së

Problemi mjedisor	Shkaqet	Ndikimi në mjedis	Ndikimi në shëndet	Trajektorja me pa PZHK	Propozimet e PZHK-së 2023-2031	Ndërhyrje të tjera të propozuara	Masa të tjera të nevojshme
1. Cilësi e ajrit.	Aktiviteti ndërtimor i pakontrolluar; Rrugë të pashtuara; Rritja e shpejtë e numrit të automjeteve; Karburante të cilësisë jo të mirë; Fabrika e Cimentos Gjeneratorë me naftë; Ngrohjet individuale.	Të gjitha shkaqet e përmendura e ulin cilësinë e ajrit edhe pse kjo komunë është e mbuluar mjaft me vegjetacion.	Nuk ka të dhëna që provojnë këtë lidhje për sëmundjet, apo ndonjë sëmundje tjetër që vjen si rezultat i cilësisë së ajrit.	Do të vazhdojë të përkeqësohet me rritjen e numrit të automjeteve. Mundet vetëm të ngadalësohet. Mund të balancohet vetëm nëpërmjet reduktimit të aktiviteteve ndërtimore. Mund të riparohet vetëm në rast se ndërmerren masat e duhura	Propozimet për kontroll të cilësisë së ajrit, pyllëzim, propozimet për shirita gjelbërues Propozimet për transportin publik dhe ciklizmit ka si qëllim ngadalësimin e rritjes së numrit të makinave private dhe reduktimin e ndotjes së ajrit të disa zonave të komunës. Rrugët e reja të cilat duhet të lehtësojë trafikun nëpër vendbanime. Kontrollimi rigoroz i emisioneve e dalura nga furra e Sharrcemit.	Duhet të bëhen studime mbi pyllëzimin; Duhet të bëhen studime mbi transportin; Përdorimi i karburanteve më të pastra (përmbajtje e sqfurit të bjerë); Përmirësimet e rrugëve nga Komuna e Hanit të Elezit në bashkëpunim me Ministrinë e Infrastrukturës. Bashkëpunimi me Sharrcemin	Studim për të përcaktuar ndikimin dhe koston e cilësisë së dëmshme të ajrit në shëndetin publik dhe në ekonominë në tërësi; Përmirësimi i teknikave të ndërtimit për të pakësuar ndotjen; Shtrimi i rrugëve, përmirësimi i trafikut edhe futja e korsive të biçikletave; Edukim më i mirë i publikut mbi shëndetin dhe cilësinë e ajrit; Përmirësimi i furnizimit me energji-zbutja e kërkesës nëpërmjet burimeve alternative të energjisë dhe përdorimit të gjeneratorëve; Vendosja e kritereve strikte për pyllëzimin; Vendosja e kritereve strikte për cilësinë e zonave të gjelbra (cilësia e mbulesës së tokës, dhe e mbulesës bimore).

2. Cilësi jo e mirë e ujit të lumenjve	Mungesa e trajtimit të ujërave të ndotura fekale dhe mbetjeve industriale që shkaktohet nga mungesa e sistemit të grumbullimit dhe trajtimit adekuat të ujërave të ndotura.	Ndikim në shëndetin e popullatës njerëzore, humbje e florës dhe faunës në ekosisteme ujore (mikrozoobentosit dhe makrozoobentosit); Ndotja e rezervave të ujërave nëntokësorë.	Ndikon në sëmundjet infektive, sëmundjet tjera të cilat lidhen me përdorim të ujit dhe përmes zinxhirit ushqimor.	Do të përkeqësohet më tej dhe mund t'i kthejë lumenjtë në kanale të hapura fekale.	Skenari i zhvillimit të PZHK në përputhje me studimin e Planit hapësinor të Kosovës. Vendi i identifikuar për impiantin për trajtim të ujërave të ndotura në përputhje me Planit hapësinor të Kosovës pjesa e trajtimit të ujërave të ndotura. Trajtimi i përkohshëm dhe sipas zonave i ujërave të ndotura.	Përgatitja e Projekteve Sektoriale për Trajtimin e ujërave të zeza të Hanit të Elezit	Zëvendësimi i tubacioneve të vjetra dhe të vogla që do të shoqërohet edhe me minimizimin e rrjedhjeve. Maksimizimi i lidhjeve. Rregullimi i lidhjeve të paligjshme. Reduktimi i përdorimit të gropave septike dhe lidhja me sistemin e kanalizimeve për ujërat e ndotura, lidhja me kolektorin kryesor të fshatrave dhe ndërtimi i impiantit të planifikuar.
3. Cilësi dhe sasi jo e kënaqshme e ujit të pijshëm	Humbje në sistem të furnizimit, tubat jo të cilësisë së duhur dhe mungesa e kontrollit të ujërave	Ndotja e ujërave nëntokësore Konsum i ujit në shishe dhe gjenerimi i mbetjeve plastike.	Shpërthim i sëmundjeve gastro-enterike, por lidhja e qartë nuk është provuar nga të dhënat shëndetësore.	Do të përkeqësohet me rritjen e përmasave të disa vendbanimeve dhe të kërkesave. Është i nevojshëm zhvillimi i burimeve të reja. Një ndikim i kthyeshtëm nëse merren masat e duhura.	Skenari i zhvillimit i PZHK përputhet me studimet e mëhershme për cilësinë dhe sasinë; Në PZHK janë parashikuar edhe përfshirja e infrastrukturës për shkak të interferencave që ka.	Duhet përgatiten projektet Sektoriale përkatës dhe trajtohet mundësia e financimit.	Zvogëlimi i humbjeve në rrjet. Shmangia e intersektimeve me linjat e ujërave të zeza. Reduktimi i lidhjeve të paligjshme. Përgatitja e projekteve për të shkuar drejt furnizimit të vazhdueshëm me ujë; Mbrojtja e burimeve mbi sipërfaqe, eliminimi i shfrytëzuesve individual të burimeve ujore.

<p>4. Mbledhja dhe grumbullimi i mbeturinave</p>	<p>Mungesa e një sistemi reduktim-ripërdorim-riciklim për mbetjet e ngurta në nivel të Komunës së Hani të Elezit; Grumbullimi i mbetjeve në komunë nuk është plotësisht i rregulluar pasi shumë prej tyre hidhen në lumenj dhe zona të tjera. Nëse vazhdohet me këto ritme, Hani i Elezit do të ketë disa deponi ilegal brenda viteve të ardhshme. Mbetjet ndërtimore, dhe ato të tjera përzihen me mbetjet komunale.</p>	<p>Komuna gjeneron sasi të konsiderueshme të mbetjesh të ngurta. Në disa vendbanime të Hani të Elezit pamjet e mbeturinave mbeten të shëmtuara. Në komuna, sidomos në shtretërit e lumenjve dhe përroskave(mundësia e mbejeve te asbestit ne lumin lepenç). Këto mbeturina mund të jene burim sëmundjesh veçanërisht në stinën e nxehtë. Poashtu kjo ndotje ndikon edhe në ndotjen e gjithë zinxhirit ushqimor në Hani i Elezit</p>	<p>Djegia e mbeturinave shton ndotjen e ajrit. Personat që jetojnë pranë këtyre deponive dhe herë pas here kontrollojnë mbetjet janë të ekspozuar ndaj rreziqeve serioze për shëndetin. Rrezik potencial për shëndetin nga hedhja e mbetjeve të rrezikshme në zona afër dhe në disa raste edhe brenda vendbanimeve të komunës së Hani i Elezit.</p>	<p>Sasia e mbetjeve do të rritet njëherazi me zhvillimet e reja; Duhet përmirësuar mbledhja e mbeturinave në komuna. Rreziku se mund të ketë rritje të hedhjes së paligjshme të mbeturinave; Disa pika grumbullimi të përkohshëm ende nuk janë organizuar.</p>	<p>PZHK sugjeron adoptimin e një sistemi të integruar të administrimit të mbetjeve të ngurta, bazuar në itinerarin reduktim-ripërdorim-riciklim-rikuperim. PZHK propozon zhvillim të transdeponive në të cilat mbeturinat do të grumbullohen dhe selektohen dhe do të bëhen të gatshme për deponim për ato që deponohen kurse tjerat do të riciklohen.</p>	<p>Duhet përgatitet Projekti Sektorial përkatës me mundësi financimi; Për pikat e grumbullimit të përkohshëm të mbetjeve. Ky projekt sektorial do të eksplorojë opsione të ndryshme të trajtimit dhe menaxhimit me deponi të përkohshme dhe transportit drejtë deponisë regjionale.</p>	<p>Grumbullim më i mirë në vendbanime dhe nivel komunal. Vënie në jetë e strategjive për reduktimin e mbetjeve dhe për riciklimin. Ndarje më e mirë e materialeve të rrezikshme. Për të shmangur hedhjet e paligjshme, organizimi mund të bëhet nga komuna për një numër të mjaftueshëm kamionësh, dhe të menaxhohet me transport nga deponia e përkohshme drejt asaj regjionale njëjtë të menaxhohet me pagesë për tone për hedhjen e mbeturinave në Deponin e regjionale duke krijuar sistem pagesash nga ata që hudhin mbeturina. Zbatimi i projekteve për pika grumbullimi në sistemin e stacioneve të transferit .</p>
---	---	--	---	--	--	---	---

5. Rehabilitimi /Inkapsulim i pikave te nxehta të ndotjes	Ndotja e tokës nga aktivitete e ndryshme ekonomike dhe bujqësore	Ndotja e tokës dhe ajrit nga përbërje të dëmshme për shëndetin e njeriut dhe biodiversitet	Në vartësi të lendeve ndotëse, mund të shkaktojnë një game të gjerë sëmundjesh	Mund përkeqësohet edhe më tepër aktivitetet njerëzore dhe ekonomike kanë bere qe në shumë vende të ketë deponi të egra të cilat nëse nuk eliminohen dhe rehabilitohen do te kenë pasoja për shëndetin publik.	Propozohet të studiohen të gjitha hapësirat, zonat me rrethinë ku janë zhvilluar industritë të vogla ose edhe sot ku pjesërisht funksionojnë në territorin e komunës së Hanit të Elezit që kane përdorur ose gjeneruar kimikate të rrezikshme për shëndetin, para, gjatë edhe pas viteve 90-ta dhe mbi bazën e shkalles se rrezikut të behën ndërhyrja teknike	Te mblidhet informacione më të thelluara për ketë gjendje, për nivelin dhe llojin e ndotjes, për ndikimet në tokë, ujë ajër ekzistencën e lidhjeve të territoreve te ndotura me kërcënimet për shëndetin, llojin e kërcënimit të bëhen analiza ne terren dhe laborator	Plani i menaxhimit dhe rehabilitimit të pikave të nxehta bazuar edhe në studim, analizë dhe VNM të detajuar; Masat adekuate për shëndetin e njerëzve; Masat tjera për konsolidim të tokës, mbrojtje të ujit dhe cilësisë së ajrit dhe Biodiversitetit dhe ekosistemeve tjera.
--	--	--	--	---	--	--	---

<p>6. Shtrirja e ndërtimeve</p>	<p>Nevojat për banim; Zhvillim i pakontrolluar dhe i paplanifikuar brenda dhe rreth vendbanimeve sidomos nëpër terrene me tokë të pëlleshme bujqësore dhe ato kodrinore.</p>	<p>Humbje e tokës së pëlleshme dhe gjelbërimit e pemëve të ndryshme, humbje e shtresës së sipërme të tokës, rrjedhje dhe mundësi për rrëshqitje/ përmytje. Humbje e vlerave estetike. Humbje e vlerave peizazhistike të territorit komunal.</p>	<p>Jo i drejtpërdrejtë dhe i menjëhershëm; Por shtrirja pa përcjellë me infrastrukturë normal që shkakton edhe pasoja në shëndet; Edhe rrëshqitjet e mundshme të tokës dhe përmytjet mund të shkaktojnë dëme serioze për jetën dhe pronën. Edhe humbja e gjelbërimit ka ndikimin e vetë në shëndetin e njeriut</p>	<p>Do të vazhdojë të zhvillohet me këto trende shkon në drejtim të përkeqësimit dhe do të jetë e pakthyeshme?</p>	<p>Planifikohet kufiri ndërtimor për të gjitha vendbanimet; Standardet dhe normat e planifikimit të përdorura në PZHK bëhen automatikisht të vlefshme; Për të gjitha vendbanimet në Komunë. Parqe, zona të gjelbra dhe tampon zona për rreth disa vendbanimeve</p>	<p>PZHK ka propozuar për zonat jashtë kufijve të propozuar ndërtimor rreth vendbanimeve statusin e zonave ku nuk lejohet ndërtimi; PZHK ka propozuar për zonat jashtë kufijve të ndërtimit të marrin statusin e parkut, zonës së gjelbër dhe tampon zonës</p>	<p>Të përgatitet ekipi dhe një plan i Menaxhimit të ndërtimeve; Të përgatiten projekte për gjelbërim, parqe dhe tampon zona. Moratoriumi për ndërtimet duhet të shtrihet edhe në gjitha zonat jashtë kufijve të propozuar ndërtimor. Është e nevojshme të hartohen plane rregulluese edhe për vendbanimet në konceptin e zhvillimit policentrik.</p>
--	--	---	--	---	--	---	--

7. Degradimi i pyjeve,	Prerja e pakontrolluar dhe ilegale e pyjeve; Djegiet e pyjeve; Zhvillim i pakontrolluar dhe i paplanifikuar i disa vendbanimeve.	Ndotja e ajrit; Ndotje e ujit, mungesë e kënaqësisë si për rezidentët ashtu edhe për vizitorët. Erozioni në shkallë të lart dhe prishjen e balancit natyror.	Ndotja e ajrit edhe e ujit kanë ndikim dhe pasoja në shëndet;	Do të vazhdojë me degradimin e mëtejshëm i pyjeve; Të ketë ndotje; Humbje të habitateve dhe ekosistemeve të rëndësishme për komunën dhe për Kosovën	Revitalizimi i pyjeve ekzistuese; Propozohen mbulim me fidanë të reja sipërfaqet e zhveshura; Dhe parqe tjera të reja në disa vendbanime. Gjellbërim dhe tampon zona gjellbëruese.	Projekte konkrete pyllëzimi, revitalizimi, sanimi për pyjet e Hanit të Elezit në zonat e parapara me PZHK.	Ngritja e një mekanizmi bashkëpunues në nivel të komunës dhe ministrive për këto projekte; Kushtëzimi i projekteve të reja të infrastrukturës me gjellbërim dhe tampon zona; Aktivizim i gjykatave, policisë inspektorëve në mënyrë cilësore. Në ish vend depozitimet legale dhe ilegale masat rehabilituese dhe ri gjellbërim ose gjellbërim.
8. Humbje e trashëgimisë së ndërtuar	Zhvillimet me trende të ndryshme nëpër vendbanime nuk janë në harmoni me arkitekturën ekzistuese.	Humbja e disa nga karakteristikat unike të vendbanimeve, cenim i identitetit dhe e kujtesës historike.	Të dhëna të pa disponueshme por aspekti psikologjik dhe shpirtëror mendohet se do jetë prezent.	Do të vazhdojë dhe ndoshta do të përshpejtohet, duke qenë i pakthyeshem.	Identifikon zonat brenda studimit të cilat do të ruhen. Propozon masat për ruajtjen. E orienton presionin për ndërtime drejt vendbanimeve dhe zonave më pak të pasura me këtë lloj trashëgimie	Identifikimi i instrumenteve ekonomike dhe të valorizimit të territorit (psh, itinerare apo shtigje kulturore) që mund të bëhen mbështetje për komunitetet autoktone të Hanit të Elezit që banojnë në këto vendbanime dhe zona.	Përditësimi, zgjerimi dhe mbajtja/pasurimi i listës së monumenteve të kulturës, e cila është përgatitur nga Instituti i Monumenteve të Kulturës dhe institucione tjera qendrore dhe lokale për të mirëmbajtur zonat, ndërtesat që kanë vlerë të trashëgimisë së ndërtuar

9. Rrezik për tërmete, rrëshqitja e tokës, vërshimet dhe element tjerë rreziku	<p>Hani i Elezit bën pjesë në zonë sizmike aktive të nivelit mesatar; Ka erozion dhe shkarje dheu në Hani i Elezit edhe burime tjera rreziku.</p>	<p>Ndikimet mundë të jenë të mëdha në degradim të tokës dhe humbje të mëdha materiale.</p>	<p>Mund të rezultojë katastrofik</p>	<p>Komuna nuk ka një strategji të menaxhimit të risqeve natyrore ose tjera të shkaktuara</p>	<p>Në kodet e ndërtimit, por nuk specifikon nevojat e ndërsjellta.</p>	<p>Komuna duhet të ndërtojë brenda standardeve të larta anti-sizmike</p>	<p>Studim i terreneve për qëndrueshmëri sizmikenë rast se do të duhet të ndërtohet ndonjë pikë karburanti, duhet pasur parasysh raporti i vlerësimit të ndikimit në mjedis dhe raporti i vlerësimit të sigurimit teknik të karburantit, i cili duhet të ketë standarde shumë të larta.</p>
10. Rreziqe nga Zjarret.	<p>Shkatërrimi i pyjeve, rrezikimi i pasurisë dhe pronës së qytetarëve, ndotja e ajrit.</p>	<p>Shkatërrimi i pasurisë qytetare duke djegur pronën dhe pasuritë tjera të paluajtshme.</p>	<p>Rrezikimi i jetës së qytetarëve dhe pasurisë.</p>	<p>Rreziku do të mbetet i njëjtë.</p>	<p>Bënë identifikim të zonave me probabilitet të zjarrndezës dhe krijon kushte që zjarret të menaxhohen më lehtë.</p>	<p>Duhet ndërhyrje bonifikuese në ndërtesat me përmbajtje amianti.</p>	<p>Duhet behën studime të mëtejme mbi shkaqet e zjarrvënës, kohen dhe lokacionet më të atakuara.</p>
11. Rënie e biodiversitetit dhe humbje e florës dhe faunës.	<p>Rritja e disa vendbanimeve por edhe zhvillimet me karakter ndërtimi po shkaktojnë humbje në pyje dhe habitat. rritje e ndotjes, Zhvillimi i infrastrukturës ndikon drejtpërdrejt.</p>	<p>Nuk njihet plotësisht, por ka probleme të përgjithshme të humbjeve ekologjike. Rënie e efektit zbutës të florës për gjurmën e karbonit në disa zona të komunës</p>	<p>Humbje e zinxhirit ushqimor, Aspekti kulturor, shkencor dhe rekreativ. Ndikim negativ në gjendjen psikologjike të banorëve.</p>	<p>Do të vazhdojë të përkeqësohet.</p>	<p>Përkufizimi i ndërtimit është propozim i drejtpërdrejtë, dhe ulja e zhvillimit të çrregullt të vendbanimeve do të sjellë edhe uljen e humbjes në biodiversitet.</p>	<p>Projekte të asistuar nga BE, me qëllim fuqizimin e monitorimit të mjedisit në komunë duhet zhvilluar studime të situatës.</p>	<p>Nevoja për të pasur një studim bazë dhe inventarizim për Hani i Elezit me qëllim identifikimin e humbjeve në biodiversitet dhe mundësitë për përmirësimin e situatës..</p>

12. Zonat e ndikimit të aktiviteteve në Hani i Elezit	<p>Të gjitha problemet e lartpërmendura, por nuk ka informacion të detajuar mbi ndikimin.</p>	<p>Ndotje e lumenjve dhe tokës.</p>	<p>Nuk dihen në hollësi por nënkuptohen.</p>	<p>Ndotja e ajrit do të shtrihet në një zonë më të madhe me zgjerimin e vendbanimeve dhe përkeqësimin e ndotjes.</p>	<p>Jashtë studimit, por problemet janë të njohura, sidomos rritja vendbanimeve dhe zhvillimet tjera industrial dhe ndërtimore.</p>	<p>Projekte të asistuar nga MMPHI, BE etj për identifikimin e nivelit të ndikimit dhe zonës së veprimit lokal, komunal, kombëtar ose edhe ndërkombëtar</p>	<p>Nevoja për të pasur një studim bazë për Hanin e Elezit me qëllim identifikimin e ndikimit të aktiviteteve në zona dhe mundësitë për përmirësimin e situatës</p>
13. Ndotje akustike në Hani i Elezit	<p>Qarkullimi i dendur dhe kaotik rrugor vlen të ceket me theks rrugët regjionale mosrespektimi i rregullave të qarkullimit rrugor, numri i lartë i automjeteve private për shkak të mos efiçensës së transportit publik, ushtrimi i aktiviteteve argëtuese jashtë standardeve, cilësia e ulët e automjeteve,</p>	<p>Nivel i lartë i zhurmës në vendbanimet pran arterieve kryesore rrugore.</p>	<p>Efekte kronike dhe akute në sistemin e dëgjimit, dhe dëmtim i sistemit nervor.</p>	<p>Rritja e vazhdueshme ose mos disiplinim i problematikës.</p>	<p>Krijim i një rrjeti më të disiplinuar dhe më të mirë rrugor; Përmirësim i transportit publik; Krijimi i barrierave me bimësi aty ku është e mundur anës rrugëve si dhe pengesa tjera të përshtatshme.</p>	<p>Edukimi qytetar për mos shkaktimin e ndotjes akustike. Aplikimi në ndërtesat ekzistuese dhe te reja të materialeve izolues të zhurmave.</p>	<p>Masa të karakterit rregullator për standardet e mjeteve që lëvizin në komunë dhe penalitetet ndaj shkaktuesve të zhurmave në vendbanimet e Hanit të Elezit.</p>

MONITORIMI

MONITORIMI

Aspekti kryesorë për të mbajtur nën kontroll zbatimin e strategjive, planeve, programeve dhe projekteve është monitorimi. Në ligjin e “Vlerësimit Strategjik Mjedisor”, kërkohet monitorimi i pasojave të ndjeshme mjedisore ose shëndetësore të zbatimit të planit apo programit, në mënyrë që të identifikohen në fazë të hershme pasojat negative të paparashikuara dhe me qëllim marrjen e masave rregulluese.

E njëjta kërkesë është parashikuar në nenin 10 të Direktivës së BE-së për VSM-në. Sipas po kësaj direktive, me qëllim që të shmangen dublikimet në procesin e monitorimit, mund të përdoret sistemi aktual i monitorimit, nëse konsiderohet i përshtatshëm.

Institucioni përgjegjës për monitorimin e mjedisit në vendin tonë është MMPHI nëpërmjet AMMK-së Agjencisë Mbrojtjes së Mjedisit të Kosovës, e cila zbaton monitorimin në bashkëpunim me institucionet përkatëse të ministrive të tjera dhe institucioneve në nivel qendror dhe lokal .

Me qëllim që PZHK-të të zbatohen me efektivitet dhe të realizohen objektivat dhe synimet që janë përcaktuar në Plan, është e domosdoshme dhe siç e parashtruar edhe me sipër; është kërkesë ligjore, që të monitorohet zbatimi i Planit, për të shmangur që në fazat fillestare ndikimet eventuale negative në mjedis.

Për të qenë sa më racional dhe efektiv në monitorimin e mjedisit, do të referohemi atyre tregueseve që kanë rezultuar nga objektivat dhe synimet që janë përcaktuar për mbrojtjen e mjedisit dhe kapitullin mbi ndikimet dhe masat zbutëse të PZHK-së. Plani Monitorimit përmbledh shumë tregues që përfaqësojnë një numër të konsiderueshëm të elementeve të mjedisit.

Realizimi me sukses i kësaj ndërmarrje kërkon angazhimin e mjaftë institucioneve të cilët duhet të bashkërendojnë aktivitetet përkatës monitoruese nën drejtimin e Agjencisë së Mbrojtjes së Mjedisit të Kosovës.

Mbështetur në Ligjin për Mbrojtjen e Mjedisit, Ligjin për VSM dhe VNM Komuna e Hanit të Elezit ka për detyrë të kryej monitorimin e aktiviteteve që kryen në kuadrin e zbatimit të PZHK-së. Këtu përfshihen qoftë Planet, projektet e Infrastrukturës që po hartohen ndërkohe, edhe detajimi i PZHK-së në Plane Rregulluese për vendbanimet policentrike, lagje apo blloqe banimi.

Komuna e Hanit të Elezit sikur se gjitha komunat e Kosovës ka karakter administrativ dhe pa struktura të plota dhe të afta për të kryer veprimtari si monitorimi mjedisor dhe për rrjedhojë, nuk mund të mbulojë me kapacitetet dhe burimet e saj njerëzore dhe financiare gjithë këtë veprimtari. Megjithatë ajo, duke angazhuar Drejtorin e Urbanizmit, Planifikimit dhe Mjedisit dhe struktura të tjera në vartësi të saj mund të kryej një pjesë të programit të monitorimit si cilësinë e ndërtimeve, ecurinë e pyllëzimit dhe zhvillimit të pyjeve, zgjerimit të parqeve dhe sipërfaqeve të gjelbra, ecurinë nderimit të rrugëve të reja përfshirë ato për qarkullimin me biçikleta dhe të tjerë indikatorë që janë paraqitur në programin e monitorimit të PZHK-së.

Komuna e Hanit të Elezit rezultatet e monitorimit, sipas ligjit për VSM-n, duhet ti publikoj në mënyrë periodike çdo vit. Për elementet e tjerë të mjedisit duhet të procedohet sipas ligjeve që mbulojnë fushën VSM,VNM për monitorimin dhe rezultatet ti përcillen komunës së Hanit të Elezit dhe Agjencisë së Mbrojtjes së Mjedisit të Kosovës. Kjo e fundit ka detyrimin ligjor ti publikoj në kuadër të Raportit Vjetor për Gjendjen e Mjedisit në Republikën e Kosovës.

Tabela 15. Monitorimi

Receptoret mjedisor	Objektivat e Mbrojtjes së Mjedisit	Synimi	Indikatori	Raportimi	Institucioni pergjegjes
Shendeti banoreve	Promovimi për krijimin e një komune të qëndrueshme dhe të shëndetshme	<ol style="list-style-type: none"> 1. Cilësia e ajrit me parametra te BE-së. 2. Cilësia e dheut dhe produkteve bujqësore dhe ushqimore. 3. Cilësia e burimeve te ujit të pijshëm konform stand. të BE ujërat sipërfaqësore dhe nëntokësore destinuara për ujë të pijshëm 4. Cilësia e ujit të pijshëm konfrom standardit 5. Dendësia e popullsisë e qëndrueshme në vendbanimet me trend të rritjes së popullsisë 	<ol style="list-style-type: none"> 1. Cilësia e ajrit kundrejt standardit te BE 2. Cilësia e dheut dhe produkteve bujqësore dhe ushqimore kundrejt standardit te BE. 3. Cilësia e burimeve te ujit të pijshëm, kundrejt standardit te BE. 4. Cilësia e ujit te pijshëm ne përputhje me standardin 5. Dendësia mesatare për këto vendbanime. 	<ol style="list-style-type: none"> 1. Rap. Vjetor 2. Rap. Vjetor 3. Rap. Vjetor 4. Rap. Vjetor 5. Rap. Vjetor 	<ol style="list-style-type: none"> 1. Drejt. E Urbanizmit e Hanit të Elezit dhe Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës 2. Drejt. Shërbimeve Publike komuna e Hanit të Elezit
Biodiversiteti	Ruajtja e llojeve të cilat janë në rrezik të zhdukjes nga aktiviteti njerëzor	<ol style="list-style-type: none"> 1. ndalimi i gjuetisë së egër 2. marrja e masave për mbledhësit e bimëve mjekuese 3. Rehabilitimi i sipërfaqeve te pyjore në zonat pyjore dhe ato të gjelbra ne zonat e banimit 5. Krijimi i korridoreve të gjelbra dhe tampon zonave 	<ol style="list-style-type: none"> 1. Sipërfaqet e reja të krijuara, sip. m² 2. Sipërfaqe te reja, m² 3. Sipërfaqet te rehabilituara, m² 4. Sipërfaqet e kthyer ne zone te gjelbër, pjese e korridorit dhe tampon zona; m² 	<ol style="list-style-type: none"> 1. Raportim 1 here vit 2. Raportim 1 here ne vit. 3. Raportim 1 here ne vit 4. Raportim 1 here ne vit 5. Raportim 1 here ne vit 	<ol style="list-style-type: none"> 1. komuna e Hanit të Elezit dhe MMPHI 2. komuna e Hanit të Elezit dhe MMPHI 3. komuna e Hanit të Elezit dhe MMPHI 4. komuna e Hanit të Elezit dhe MMPHI & MBPZHR 5. komuna e Hanit të Elezit dhe MMPHI & MBPZHR
Ajri	Përmirësimi i cilësisë së ajrit	<ol style="list-style-type: none"> 1. Ulja e niveli te ndotjes se ajrit për: NOx; CO₂ ; O₃, PM10. 2. Rruge te asfaltuara rishtas 3. Ulja e nivelit te zhurmave ne zonat e ndjeshme ndaj zhurmave 4. Aplikimi në banesat e reja i 	<ol style="list-style-type: none"> 1. Arritja e vlerave te standardit për cilësinë e ajrit lidhur me treguesit mbi norme 2. Gjatësia e rrugëve të asfaltuara rishtas 3. Respekt i niveleve te lejuara te 	<ol style="list-style-type: none"> 1. Raportim 1 here ne 6 muaj 2. Raportim 1 here ne vit 3. Raportim 1 here ne 6 muaj 	<ol style="list-style-type: none"> 1. AMMK dhe komuna e Hanit të Elezit 2. komuna e Hanit të Elezit 3. komuna e Hanit të Elezit 4. komuna e Hanit të Elezit

		materialeve termizolues dhe mbrojte akustike	zhurmës gjatë ditës dhe natës 4. Ulja e niveli të zhurmave në mjediset e banimit	4. Raportim 1 here ne vit	
Faktoret klimatik	Kursimi i, energjisë dhe pakësimi i emisioneve te gazeve serre	1. Promovimi i objekteve me izolim adekuat. 2. Promovimi i paneleve diellor për gjenerim energjie në ndërtesat rezidenciale dhe sociale dhe energjia e krijuar nga era	1. Sipërfaqja e objekteve (m2) me izolim adekuat 2. Sipërfaqja (m ²)e paneleve te instaluar dhe sipërfaqja e ngrohur nga energjia e erës (m ²)	1. 1 here ne vit 2. 1 here ne vit	1. Komuna e Hanit të Elezit 2. Komuna e Hanit të Elezit
Uji	Cilësia e ujërave sip.në përputhje me kërkesat e legjislacionit të Kosovës dhe Direktivës të BE-së për ujin.	1. Shmangia e shkarkimeve te ujërave te ndotura ne Lumenj 2. Sigurimi i mos hedhjeve të mbeturinave në lumenj. me qellim ruajtën e niveleve minimal të ndotjes	1a. Vëllimi i ujërave qe shkarkohen ne Lumenj; 1b. Vëllimi i ujërave mbi normat e lejuara qe shkarkohen në Lumenj; m3. 2. Sipërfaqja e ndotjes (m ²) vëllimi i mbeturinave (kg ose m ³) ,lloji mbeturinave shkruhet emri i saktë i mbeturinave të forta të gjetura në shtrat të lumit	1. Dy here ne vit 2. Dy here ne vit	1. Komuna e Hanit të Elezit, AMMK. 2. Komuna e Hanit të Elezit dhe AMMK
Menagjimi i mbeturinave	3) Pakësimi i sasisë se mbetjeve dhe menaxhimi qëndrueshëm i tyre b) Shndërrimi i pikave te nxehta mjedisore ne sipërfaqe te gjelbra/parqe ose zona rezidenciale	a.1. Pakësimi në burim dhe riciklimi i mbetjeve a.2. Vendosja e sistemit me disa kontejnerë për ndarjen ne burim te mbetjeve urbane b.1. Rehabilitim/inkapsulimi i pikave te nxehta ne territoret te mbyllura	a.1. Sasia e mbetjeve urbane/person/vit dhe sasia(ton) e mbetjeve te ricikluara. a.2. Numri i rezidentëve që mbulohen nga shërbimi me kontejner b.1. m ² te rehabilituara ose inkapsuluara	a.1. 1 here ne vit a.2. 1 here ne vit b.1. 1 here ne vit	a.1. Komuna e Hanit të Elezit, kompania regjionale e mbeturinave dhe MMPHI gjegjësisht AMMK a.2 Komuna e Hanit të Elezit, kompania regjionale e mbeturinave dhe MMPHI gjegjësisht AMMK b.1. Komuna e Hanit të Elezit, kompania regjionale e mbeturinave dhe MMPHI gjegjësisht AMMK
Rruget dhe Transporti	Reduktimi i intensitetit te trafikut nëpërmjet promovimit te	1. Zgjerimi i rrjetit rrugor për trafikun publik 2. Zgjerimi i rrjetit te korsive për biçikleta	1. Km rruge shtese qe mbulohen nga trafiku urban. 2. Km korsive shtese për lëvizje me biçikleta. Numri i biçikletave në	1.1 here ne vit 2. 1 here ne vit 3. 1 here ne vit 4. 1 here ne vit	1. Komuna e Hanit të Elezit, dhe MMPHI 2. Komuna e Hanit të Elezit. 3. komuna e Hanit të Elezit, dhe

	transportit publik, qarkullimi me biçikleta ku mundet me ndodhë	3. Ndërtimi i rrugëve të reja me hapësira të përshtatshme trotuaresh (përfshirë korsitë e biçikletave). Zgjerimi i trotuaresh gjate rehabilitimit të rrugëve ekzistuese. 4. Rehabilitim/asfaltimi i rrugëve lokale	qarkullim. 3. Km rrugë të reja dhe të rehabilituara. m ² trotuare dhe korsitë biçikletash të shtuara. 4. Km rrugë lokale të rehabilituara ose/dhe asfaltuara		MMPHI 4. komuna e Hanit të Elezit.
Trashëgimia kulturore	Shtimi dhe mbrojtja e vlerave të kulturore, përfshirë ato arkeologjike dhe arkitekturore	Rehabilitimi, mirëmbajtja dhe ruajtja e objekteve të trashëgimisë kulturore	1. Numri i objekteve/ndërtesave me status mbrojtës 2. Numri i objekteve/ndërtesave të restauruara	1. 1 here në vit 2. 1 here në vit	1. Komuna e Hanit të Elezit Instituti për mbrojtjen e Monumenteve 2. Komuna e Hanit të Elezit Instituti për mbrojtjen e Monumenteve
Trashëgimia natyrore dhe zonat e mbrojtura	Mbrojtja e vlerave të trashëgimisë natyrore, llojeve të cilat janë në “Listën e Kuqe” të Evropës	Promovimin e vlerave natyrore rekreative, turistike dhe shkencore të këtyre zonave dhe rëndësisë së llojeve të cilat janë në “Listën e Kuqe”.	Gjetja e formave për sensibilizim dhe kërkime shkencore me të shumta.	1 here në vit	Komuna e Hanit të Elezit, MMPHI-ja dhe Instituti i Kosovës për Mbrojtje të Natyrës

<p>Peizazhi, pyjet dhe toka</p>	<ol style="list-style-type: none"> 1. Konservimi dhe shtimi i zonave dhe elementeve peizazhistik 2. Mbrojtja e mjedisit natyror ne hapësirat për rreth vendbanimeve 3. Ripërdorimi i tokave te ndotura 4. Mirmbajtje dhe zhvillim i pyjeve 5. Kultivim i pyjeve të reja 	<ol style="list-style-type: none"> 1. Shtimi i hapësirave të reja dhe nëmurit të pemëve e shkurreve. 2. Dhënie e statusi mbrojtje dhe hartimi i një plani menaxhimi mjedisor i këtyre hapësirave. 3. Rehabilitimi i tokave te ndotura(pikat e nxehta mjedisore) dhe vënia në eficiensë për zona të gjelbëra/parqe ose rezidenciale 4. Zhvillimi i pyjeve ekzistuese 5. Pyllëzimi i hapësirave të zhveshura 	<ol style="list-style-type: none"> 1. Sipërfaqet ne m2 dhe numri i pemëve të mbjella 2. Progresi i zbatimit te planit 3. Sipërfaqe toke e ndotur e rehabilituar (m2) dhe e vene ne përdorim sipas PZHK. 4. Sipërfaqe toke së zhvilluar pyjore (ha) 4. Sipërfaqe e toke së re pyjore (ha) 	<ol style="list-style-type: none"> 1. Një here ne vit 2. Një here ne vit 3. Një here ne vit 4. Një here ne vit 5. Një here ne vit 	<ol style="list-style-type: none"> 1. Komuna e Hanit të Elezit 2. Komuna e Hanit të Elezit 3. Komuna e Hanit të Elezit 4. Komuna e Hanit të Elezit dhe MBPZHR 5. Komuna e Hanit të Elezit dhe MBPZHR
-------------------------------------	--	--	---	--	---

PËRFUNDIME

Komuna e Hanit të Elezit ka probleme të mjaftueshme mjedisore, të cilat vijnë si rezultat i keq menaxhimit të resurseve natyrore dhe keq menaxhimit të hapësirave publike. Ndërkohë që popullata e komunës së Hanit të Elezit ka një traditë të kujdesit për mjedisin dhe hortikulturën me kultivimin e bimëve dekorative dhe të krijimit të parqeve dhe zonave të gjelbërta. Problem tjetër është prerja e pa kontrolluar e pyjeve që si rezultat pasojnë probleme tjera zinxhirore deri te ndikimi edhe në klimën rajonale. Andaj hartimi dhe zbatimi rigoroz i PZHK-së dhe sugjerimeve të cilat u dhanë në VSM në përgjithësi do të ketë ndikime pozitive në mjedis. Ai do të orientojë rritjen e mundshme dhe të parashikuar të popullsisë në disa vendbanime të komunës së Hanit të Elezit me qëllim dendësimin në zonat që janë të pastabilizuara ende dhe të zhvillojë zona të reja banimi dhe shërbimesh të qëndrueshme rreth këtyre vendbanimeve aktuale në komunën e Hanit të Elezit. Ai gjithashtu do të ruajë trashëgiminë e ndërtimit, krahas nxitjes së një peizazhi me pamje më të këndshme. VSM për PZHK do të sjellë përmirësime në mjedis, do të kontribuoj në mbrojtjen dhe zhvillimin e pyjeve në të gjitha zonat pyjore dhe parqeve brenda dhe rreth vendbanimeve, krahas aspektit të rëndësishëm të parandalimit të depërtimit (shtrirjes) në tokat e pëlleshme bujqësore përreth. Përfitimet kryesore të këtij plani lidhen kryesisht me përdorimin në mënyrë me efikasitet të tokës.

Janë marrë parasysh parimet e përgjithshme për planifikimin hapësinor të bazuar mbi eksperiencat ndërkombëtare, si nxitja e zhvillimit të qëndrueshëm, parandalimi i ndikimit të dëmshëm në mjedisin natyror, ruajtja e tipareve karakteristike natyrore, peizazhere, zhvillim ekologjikisht i shëndetshëm, informimi dhe përfshirja e komunitetit në vendimmarrje, etj.

Zbatimi praktik i parimeve të përgjithshme në rastin e PZHK-së nxjerr disa përparësi si psh. Zhvillimi kompakt dhe policentrik i vendbanimeve, densifikim përpara shtrirjes për ngadalësimin e shpërndarjes përtej vijave cilat kufizojnë ndërtimin, strukturimi dhe ristrukturimi i zhvillimit koherent, krijimi i rrugëve të reja brenda vendbanimeve ekzistuese, rehabilitimi i lagjeve ekzistuese, ruajtja e trashëgimisë natyrore dhe historike, ruajtja e shumëllojshmërisë së aktiviteteve dhe përdorimeve në vendbanime, dhe zgjerimi i zonës së ndërtimit atje ku kushtet janë të favorshme.

PZHK-ja përqipet të përmbushë disa objektiva strategjike të pranuar gjerësisht përfshi:

- Komuna e Hanit të Elezit si komunë e cila përballon nevojat për banim të banorëve të saj dhe turist nga jashtë vendit;
- Komuna e Hanit të Elezit komunë e shëndetshme me peizazhe dhe ekosisteme interesante;
- Komuna e Hanit të Elezit komunë policentrike (koncepti i diellit);
- Shtimi i sipërfaqeve të gjelbra duke synuar rritjen e potencialit ekologjik dhe zhvillimin, krijimin e pyjeve, korridoreve ekologjike dhe tampon zonave në Hanit të Elezit;
- Zgjerim të rrugëve por dhe nxitjes së ecjes këmbësore dhe me biçikleta;
- Përmirësimi i transportit publik (përmirësim i shërbimit të autobusëve);
- Zgjerim i vendbanimeve me trendë pozitive në drejtimin të tokave me plleshmëri më të dobët

Objektivat strategjike të mësipërme synojnë përmirësimin e cilësisë së jetës në Hanit të Elezit, rritjen e sigurisë, shtim të mundësive për mënyrë aktive të jetesës, shtim i sipërfaqeve të gjelbra, përmirësim i cilësisë së ajrit, etj. dhe duhen shoqëruar me veprime operacionale konkrete që çojnë në përmbushjen e objektivave strategjike të planit.

VSM sugjeron disa veprime operacionale konkrete për ruajtjen e vlerave mjedisore dhe vlerave tjera të trashëgimisë

Veprime operacionale në Hanit të Elezit:

Krijimi i projekteve për zbatim në zonat e mbrojtura sipas PZHK në komunën e Hanit të Elezit siç janë ato me vlera të veçanta natyrore për komunën. Pyllëzimi dhe ripyllëzimi i zonave të parapara me PZHK, krijimi i parqeve të reja nëpër dhe për rreth vendbanimeve; zgjatimi dhe përmirësimi i kushteve ekologjike në korridorin përgjatë lumenjve; krijimi i lulishteve dhe kopshteve në qytetin e Hanit të Elezit; kthimi i zonave të ndotura në sipërfaqe të gjelbra; gjelbërimi me pemë dhe shkurre dekorative përgjatë rrugëve dhe trotuareve; ngritja e barrierave të dendura me gjelbërim si perde që ndajnë rrugët nga zonat e banimit dhe zonat tjera, përgjatë rrugëve me trafik të dendur me qëllim të shumëfishtë (rritje gjelbërimi, përmirësim cilësisë së ajrit përmes filtrimit të pluhurave, si edhe rritje e sigurisë rrugore); trajnim i grupeve të ndryshme të cilat merren me mbrojtje dhe sensibilizim të vlerave mjedisore. Veprimet në infrastrukturë: përmirësim i gjendjes së rrugëve ekzistuese dhe zgjerim sipas mundësisë; krijim i rrjetit të plotë rrugor në vendbanimet e mëdha me përmbajtje edhe për biçiklistët dhe këmbësoret; përmirësim i sistemit, orareve dhe cilësisë së autobusëve; përmirësimi i projektimit të rrugëve me parashikimin e trotuareve të plota dhe shiritave/korësive për biçikletat sipas standardeve europiane të rrugëve;

Plani do të jetë një mekanizëm që ofron zgjidhje për zhvillimin e komunës. PZHK-ja duhet të fuqizojë komunën të luajë rol me aktiv mes palëve për të ofruar mundësi për të mos mbetur peng i mosmarrëveshjeve mes palëve.

VSM gjithashtu i vendos disa kufizime zhvillimit që parashikohet nga PZHK-ja. Kriteret mjedisore që kufizojnë zhvillimin komunal janë (1) kriteret e forta mjedisore-shëndetësore, (2) kriteret të trashëgimisë kulturore, (3) kriteret peizazhike dhe (4) kriteret inxhinierike dhe të infrastrukturës.

Kriteret e forta mjedisore-shëndetësore përcaktojnë zonat e përjashtuara nga zhvillimi komunal. Kriteret e forta përfshijnë (i) zona me vlera të veçanta mjedisore (psh. parqet), (ii) zona të rrezikshme për zhvillim (pjerrtësi të mëdha, shtrat lumi, etj.) dhe (iii) zona të ndotura të njohura si “hot-spote” mjedisore (psh. zona të ndotura me mbetje kimike, akumulatore, mbetje të asbestit etj.). Nuk lejohet gjurmimi në zonat “hot spot” mjedisore pasi zhvillimi i zonës mund të cenojë integritetin e shtresave të ujërave nëntokësore dhe ndotja me kimikate të rrezikshme mund të kalojë në shtresat nëntokësore dhe mund të shkaktojë sëmundje kancerogjene deri në largësi të mëdha prej zonës në fjalë. Në zonat e ndotura rekomandohet inkapsulimi i tyre duke i kthyer në zone të gjelbra me vlerë rekreative.

Parashikohen një seri masash zbutëse ndaj ndikimeve të mundshme mjedisore gjatë zbatimit të PZHK-së. Masat zbutëse synojnë që të përmirësojnë gjendjen ekzistuese aty ku standardet mjedisore janë të cenuara dhe të sigurojnë që zhvillimet komunale në zonat e tjera dhe ato që do të integrohen rishtazi në Planin Zhvillimor të bëhen në përputhje me standardet mjedisore.

Monitorim i zbatimit të PZHK-së dhe parametrave mjedisore të tij do të jetë kyç i suksesit për garantimin e qëndrueshmërisë së zbatimit të planit. Parashikohet të monitorohen treguesit e mbrojtjes së mjedisit me qëllim që realizimi i objektivave të bëhet i matshëm për çdo element mjedisor.

Me hartimin dhe hyrjen në fuqi të PZHK-së arrihet një hap cilësor në planifikimin e qëndrueshëm të territorit dhe burimeve natyrore, por puna nuk përfundon këtu. Hartimi i Planeve Rregulluese dhe projekteve tjera do duhet të sigurojë përfshirjen e faktorëve mjedisorë gjatë detajimit të planeve në nivel më të ulët gjatë zbatimit të PZHK-së. Përveç pikave të renditura më sipër, ka nevojë që hartimi i Planeve Rregulluese të shërbejë për të përcaktuar dhe siguruar kufijtë e zonave të gjelbra, si edhe për të identifikuar dhe zhvilluar hapësira të vogla çlodhëse dhe rekreative sportive në vendbanime.

Rekomandimet që dalin nga VSM-ja janë:

- Studime mbi gjendjen e biodiversiteti dhe i habitateve natyrore në komunën e Hanit të Elezit;
- Definimi i korridoreve ekologjike gjatë realizimit të rrugëve të planifikuara si dhe atyre të ndërtuara siç është rasti me propozimin e urës kaluese të shtazëve në autostradë;
- Hartim i projekteve për rehabilitim të zonave me potenciale rrezatimi,
- Hartim i projekteve për rehabilitim të zonave erozive dhe të vërshimeve por edhe planifikimi i mundësive, masave dhe projekteve për trajtimin e Erozionit dhe vërshimeve në aspektin e zonave dhe shkallëve të erozionit;
- Definimi i zonave ekonomike në aspektin e tipit të industrisë apo afarizmit dhe krijimit të bazave për hartimin e Planit Rregullues të Hollësishme të zonave duke ofruar bazat për trajtim të zonave ekonomike me masa fizike, natyrore dhe teknologjike që të jetë miqësor edhe në aspektin mjedisor;
- Të bëhen projekte duke u bazuar edhe në PZHK vendet dhe mundësit, projektet dhe zhvillime për pyllëzim dhe ripyllëzim si masë të rëndësishme mjedisore;
- Projekte për rehabilitim të zonave, vijave ose mundësisht edhe pikave të zeza të ndotura nga mbeturinat dhe planifikohen mundësi trajtimi edhe se është përmend riciklimi si një mundësi por ka edhe mundësi tjera, definimi i hapësirave për deponi transite dhe sistemit të grumbullimit dhe menaxhimit të mbeturinave dhe proceset tjera;
- Definimi dhe trajtimi si zona konform standardeve dhe ligjeve në fuqi për ujërat nëntokësor dhe sipërfaqësor;
- Konservimi i veçorive natyrore (Monumentet e Natyrës) si objekte natyrore dhe si zona;
- Definimi i peizazheve, parqeve me vlera ose ndikime mjedisore dhe parashikimi i masave;
- Projekti për ngrohjen kolektive të qytetit të Hanit të Elezit por edhe vendbanimeve;
- Projekte për caktimin e zonave të zhurmës;
- Definimi dhe trajtimi i zonave të pasura me florë dhe faunë.

LITERATURA

1. Agjencia Kosovare e Mbrojtjes së Mjedisit. Raport i Gjendjes së Monitorimit të Mjedisit për vitin 2021;
2. Komuna e Hanit të Elezit. 2023 Hartat e prezantuar në PZHK;
3. Emetimi i gazeve serrë në Kosovë 2008 – 2013;
4. Raporti për gjendjen e natyrës 2015-2017;
5. Raport mbi menaxhimin e mbeturinave komunale në Kosovë 2020;
6. Raporti i Mbuleshmerisë së Sipërfaqes së Tokës, CLC 2018;
7. Gjendja e Mjedisit në Kosovë 2017;
8. Ernest A. LoWe (1997-2001) Eco-industrial Park Handbook for Asian Developing Countries;
9. Agenda 21, UN-Habitat (2009). Planning for Sustainable Cities, UN-Habitat. Nairobi, Kenya.
10. Environment, Health and Safety Resource Centre Limited, 2014, Environmental Impact
11. Assessment Study for the Proposed Eastern Industrial Park Njiru area, Nairobi County
12. Parlamenti Evropian/Direktiva e Këshillit SEA. [WWW dokument] URL: Aktet Ligjore: <http://eurlex.europa.eu/LexUriServ/LexUriServ.do?uri=CELEX:32001L0042:EN:NOT>;
13. Dalal-Clayton, D., Sadler, B. (2005). Vlerësimi Strategjik Mjedisor: libër i të dhënave dhe udhëzues rreth përvojës ndërkombëtare. Earthscan, SHBA
14. Konventa e UNECE Mbi Qasjen në Informacione, Pjesëmarrjen Publike në Vendim-marrje dhe Qasjen në Drejtësi në Çështjet Mjedisore (Konventa Aarhus), 1998. [wwwdokument] URL: <http://live.unece.org/fileadmin/DAM/env/pp/documents/cep43e.pdf>
15. Ligji i Kosovës mbi Planifikimin Hapësinor. [WWW dokument] URL: http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/2003_14_en.pdf
16. Ligji i Kosovës mbi Vlerësimin Strategjik Mjedisor. [WWW dokument] URL: <http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/2010-230-eng.pdf>
17. Qendra Rajonale Mjedisore për Evropën Qendrore dhe Lindore, REC. (2000). Analiza Strategjike Mjedisore e Kosovës. Zyra e REC në Kosovë, Prishtinë. URL: <http://archive.rec.org/REC/Publications/CountryReports/Kosovo.PDF>
18. Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (2011). Strategjia mbi Menaxhimin e Mbeturinave 2011-2020). Prishtinë, 2011;
19. The Regional Environmental Center for Central and Eastern Europe, REC. (2000). Strategic Environmental Analysis of Kosovo. REC field office in Kosovo, Pristina. <http://archive.rec.org/REC/Publications/CountryReports/Kosovo.PDF>
20. The UNECE Convention on Environmental Impact Assessment in a Transboundary Context (EspooConvention),1991.WWWdokument]RL:http://www.unece.org/env/eia/about/eia_text.html
21. Ministria e Mjedisit dhe e Planifikimit Hapësinor . Strategjia për Mjedisin 2013-2022). Prishtinë, 2013;
22. American Planning Association (Steiner Frederick and Butler Kent eds.). 2010. Standartet e planifikimit dhe projektimit urban, Ufo University Press.
23. Strategjia dhe Plani i Veprimit për Biodiverzitetin; 2011 – 2020;
24. Millennium Development Goals Global Targets-Local Approaches;